



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 564 Akti

Nr. 666 Vendimi
Tiranë, më 25.5.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

| | |
|----------------------|-----------|
| Xhensila Pine | Kryesuese |
| Olsi Komici | Relator |
| Firdes Shuli | Anëtare |

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Willem Brouwer, në datën 23.5.2023, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Miranda Bushi**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, z. Willem Brouwer, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit të rivlerësimit Miranda Bushi, e cila kërkoi konfirmimin e saj në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

- 1.** Subjekti i rivlerësimit Miranda Bushi ushtron detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
- 2.** Fillimisht subjekti i rivlerësimit Miranda Bushi ka ushtruar detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, në periudhën dhjetor 1992 – shtator 1997. Më pas, në periudhën shtator 1997 – 2004 ka shkuar në emigracion në shtetin italian. Në periudhën shkurt 2004 – janar 2008 ka ushtruar detyrën e kancelares në Gjykatën e Apelit të Krimeve të Rënda Tiranë. Në periudhën janar 2008 – qershor 2012 ka ushtruar detyrën e drejtores së kabinetit në Prokurorinë e Përgjithshme. Më pas, nga qershori 2012 është rimëruar prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku vijon edhe sot detyrën.
- 3.** Subjekti i rivlerësimit u shortua me shortin e datës 15.6.2020 dhe do t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Xhensila Pine (kryesuese), Firdes Shuli (anëtare) dhe Olsi Komici (relator), ndërsa si vëzhgues ndërkombëtar u caktua z. Willem Brouwer.
- 4.** Me vendimin e datës 2.7.2020, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e subjektit të rivlerësimit Miranda Bushi për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; rivlerësimi i aftësive profesionale. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në rrugë elektronike¹, ku iu komunikua përbërja e trupit gjykues dhe iu kërkua deklarimi i konfliktit të interesit, nëse do të kishte me ndonjë nga anëtarët e trupës.
- 5.** Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.
- 6.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (aktualisht Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar); Grupi i Punës në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (në vijim KLP). Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.
- 7.** Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të

¹ Subjekti u njoftua në datën 2.7.2020 me anë të postës elektronike, me *email*.

gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

8. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Miranda Bushi, si dhe njoftimin e saj për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

9. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 20.4.2023² mbi rezultatet e hetimit, si dhe mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht të zhvilluar nga Komisioni, duke i lënë afat deri në datën 4.5.2023.

10. Subjekti i rivlerësimit, në datën 24.4.2023, njoftoi Komisionin se kërkonte edhe dy javë kohë shtesë në mënyrë që të sigurote dokumentacionin provues brenda dhe jashtë Shqipërisë. Kjo kërkesë e subjektit u miratua nga Komisioni, i cili, në datën 28.4.2023, e njoftoi duke i dhënë një afat të ri për të dërguar prapësimet dhe provat përkatëse deri më 18.5.2023. Subjekti i rivlerësimit brenda afatit të ri të caktuar nga Komisioni depozitoi prapësimet dhe provat përkatëse.

11. Subjekti i rivlerësimit, në datën 22.5.2023, u ftua në seancën dëgjimore, e cila do të zhvillohej më 23.5.2023, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), kati 0, Tiranë.

12. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 23.5.2023, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Willem Brouwer. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe e shoqëruar nga përfaqësuesja ligjore e caktuar prej saj, avokatja A. S., duke parashtruar shpjegimet dhe në përfundim subjekti kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

13. Znj. Miranda Bushi ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

14. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (në vijim Kushtetuta), si dhe në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", sipas të cilit anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të

² Komunikimet ndërmjet Komisionit dhe subjektit të rivlerësimit janë bërë në rrugë elektronike, me *email*.

drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

15. Për subjektin e rivlerësimit Miranda Bushi, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

16. Pavarësisht se në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLP-ja janë organet kompetente shtetërore të ngarkuara me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këto tri kriteret, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

17. ILDKPKI-ja³, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Miranda Bushi, i cili është subjekt deklarues pranë këtij institucioni që prej vitit 2008, me nr. indeksi ***, duke konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje pasurie;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

18. Pas analizimit të raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, si dhe informacionet e marra nga subjekte të së drejtës publike, bazuar në nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njoftohen rezultatet e hetimit mbi asetet e deklaruara nga subjekti në deklaratën e pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, si vijon:

❖ Mbi pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *Vetting*, përshkrimi dhe burimi i krijimit të tyre

1. Apartament banimi me sip. 68.6 m², i ndodhur në *, Vlorë,** blerë me kontratën e shitjes datë 16.7.2009⁴, në vlerën 35,000 euro, në bashkëpronësi me bashkëshortin. Burimi i krijimit: të ardhura të akumuluar ndërsa vite (subjekti deklaroi – *referojuni faqes së të ardhurave*)⁵.

³ Raporti nr. *** prot., datë 15.11.2018, i ILDKPKI-së.

⁴ Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 16.7.2009, e apartamentit me sip. 68.6 m², i ndodhur në ***, Vlorë depozituar nga subjekti bashkë me deklaratën *vetting*.

⁵ Subjekti i rivlerësimit, tek faqja 6 e deklaratës *Vetting*, në rubrikën e të ardhurave, ka deklaruar: “1) Të ardhura nga puna si prokurorë në prokurorinë e Matit (B.), për periudhën 1992 – shtator 1998, në shumën neto 1,194,781 lekë; 2) si kancelare e Gjykatës

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

1.1 Rezulton se kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2009 (në vijim DIPP), kur ka qenë me detyrë drejtoreshë kabinetit në Prokurorinë e Përgjithshme, apartamenti i blerë në vlerën 35,000 euro (nuk është deklaruar burimi i krijimit, pasi formulari i DIPP-së së vitit 2009 nuk përcaktonte burimin e krijimit).

1.2 Bashkë me deklaratën *Vetting* subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes së apartamentit me sipërfaqe totale 68.6 m², datë 16.7.2009⁶, me shitës shoqërinë “****” sh.p.k., me blerës O. H. dhe Miranda Bushi, blerë me çmimin 35,000 euro, me adresë shk. ***, kati ***, ap. ***, ***, Vlorë, me nr. pasurie ***, z. k. ***. Në kontratë është përcaktuar se likuidimi i çmimit është bërë ndërmjet palëve jashtë zyrës noteriale.

1.3 Agjencia Shtetërore e Kadastrës Vlorë⁷ (në vijim ASHK) ka konfirmuar regjistrimin e këtij apartamenti me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, në emër të shtetasve Miranda Bushi dhe O. H., ku ndodhet bashkëngjitur kontrata e shitblerjes datë 16.7.2009, si dhe dokumentacioni i shoqërisë “****” sh.p.k.

1.4 Komisioni ka analizuar çmimin e blerjes së apartamentit, duke e krahasuar me çmimin referues të EKB-së, të përcaktuar në udhëzimin e vitit 2009, i cili ka marrë për bazë çmimet e vitit 2008⁸. Sipas udhëzimit, nga të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve për vitin 2009, për qytetin e ***, përcaktohet çmimi 49,000 lekë/m². Komisioni ka përllogaritur sipërfaqen 68.6 m² x 49,000 lekë/m² = 3,361,400 lekë, e konvertuar në 26,004 euro⁹, ndërsa vlera e kontratës së shitjes është 35,000 euro. Rezulton se subjekti e ka blerë këtë apartament me çmim më të lartë krahasuar me çmimin referues të EKB-së dhe nuk ka dyshime për aplikim çmimi preferencial.

1.5 Komisioni ka hetuar për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “****” sh.p.k. dhe nga hetimi¹⁰ nuk rezultoi një situatë e tillë.

së Apelit të Krimeve të Rënda, shkurt 2004 – janar 2008, në shumën 5,057,044 lekë; 3) si drejtoreshë kabinetit në Prokurorinë e Përgjithshme, 16 janar 2008 – qershor 2012, në shumën 6,367,464 lekë; 4) si prokuror në Prokurorinë e Tiranës, qershor 2012 – 31.12.2016, në shumën 5,158,650 lekë. Bashkëshorti i subjektit, z. O. H., në rubrikën e të ardhurave, në faqen 12 të deklaratës *Vetting*, ka deklaruar: (1) të ardhura nga puna për periudhat 1.1.1992 – 15.5.1993 dhe 1.1.1994 – 31.12.1996 mësues në gjimnazin e B., në shumën 252,318 lekë; (2) si specialist matematike pranë zyrës arsimore Mat, për periudhën 1.1.1997 – 15.8.1997, në shumën 72,919 lekë; (3) nga puna në emigracion në Itali në vitet 1997 – 2004 (nuk është përcaktuar shumën); (4) si mësues në shkollat e mesme “****” dhe “****”, shtator 2004 – shtator 2005, në shumën 612,197 lekë; (5) si përgjegjës i departamentit të matematikës në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit pranë universitetit “****”, Durrës, tetor 2006 – 31.12.2016, në shumën 8,558,892 lekë; (6) si pedagog me kohë të pjesshme në universitetin “****” në vitet 2008, 2009, në shumën 314,000 lekë; (7) si pedagog me kohë të pjesshme në universitetin “****” në vitet 2008 – 2010, në shumën 333,600 lekë; (8) si pedagog me kohë të pjesshme në Universitetin Politeknik të Tiranës në vitet 2012 – 2016, në shumën 262,709 lekë; (9) interesa nga depozitat në dollarë ndër vite në shumën 3,835 USD; (10) të ardhura nga biznesi i vogël bar-restorant për periudhën 2002 – 2004, në shumën 2,400,000 lekë; (11) të ardhura nga kredia bankare në BKT, marrë në vitin 2007 në shumën 16,000 euro.

⁶ Kontratë shitjeje nr. ***, datë 16.7.2009.

⁷ Përgjigje nr. *** prot., datë 20.9.2022, e ASHK Vlorë drejtuar Komisionit.

⁸ Udhëzim nr. 1, datë 20.8.2008, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja për vitin 2008”.

⁹ Shuma 3,361,400 lekë e konvertuar në monedhën euro, llogaritur me kursin ditor të Bankës së Shqipërisë për datën 16.7.2009 (data e lidhjes së kontratës së shitjes, 1 euro = 129.26 lekë), vlera në lekë përkon me vlerën 26,004 euro.

¹⁰ Përgjigje nr. *** prot., datë 21.9.2022, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. *** prot., datë 19.9.2022, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat, të cilat konfirmojnë se nuk rezultoi që ndaj shoqërisë “****” sh.p.k. dhe z. A. B. të jenë depozituar kallëzime apo procedime penale në ngarkim të tyre.

1.6 Analizë e burimit të krijimit të shumës 35,000 euro, që janë të “ardhura të akumuluarra ndër vite”

1.6.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të ardhurat e akumuluarra ndër vite, duke referuar në faqet përkatëse të deklaratës së pasurisë të ardhura të realizuara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nga bashkëshorti i saj O. H., të referuara në pikën 1.

1.6.2 Në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës të vitit 2008 (në vijim DPF) si drejtoreshë kabinetit në Prokurorinë e Përgjithshme për të ardhurat e akumuluarra ndër vite, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *gjendje cash në banesë në shumën 100,000 euro*, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj shume.

1.6.3 Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti i rivlerësimit deklaroi: “*Gjendja cash, datë 31.12.2008 (100,000 euro pakësuar për blerjen e makinës, mobilimin dhe depozitën/ shtuar për 10,000 euro të ardhura vjetore nga pagat + vëllai), sipas deklaratimit. Gjendje rreth 33,000 euro, mbetur në banesë*”. Ndërsa në DIPP-në e vitit 2009, subjekti deklaroi: “*Pakësuar gjendja cash në euro, e deklaruar në vitin 2008, përdorur për blerje apartamenti në ***. - 33,000 euro. Gjendja: 0 euro*”. Po në të njëjtën deklaratë, subjekti deklaroi: “*Depozitë në Credins Bank, me afat 6 muaj. Gjendje 31.12.2008 = 52,000 USD. Gjendje 31.12.2009 = 46,996 USD. Pakësuar 6,000 USD, përdorur për blerje apartamenti*”.

1.6.4 Nga llogaritja matematikore e Komisionit konfirmohet deklarimi i subjektit për këtë gjendje *cash* në datën 31.12.2008, në shumën 33,000 euro¹¹.

1.6.5 Fillimisht Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kursimeve *cash* të deklaruara në datën 16.1.2008, në shumën 100,000 euro, nga të cilat 33,000 euro, të deklaruara më 31.12.2008, janë përdorur si burim i blerjes së këtij apartamenti në shumën 35,000 euro, në datën 16.7 2009.

Tabela nr. 1 – Analiza financiare për periudhën 1992 – 16.1.2008

| Nr. | Përshkrimi | Vlera |
|-----|--|-----------|
| 1 | Të ardhura nga puna si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Mat (dhjetor 1992 – shtator 1998) | 1,194,781 |
| 2 | Të ardhura nga puna si kancelarë në Gjykatën e Apelit të Krimeve të Rënda (shkurt 2004 – janar 2008) | 5,057,044 |
| 3 | Të ardhura nga biznesi | 1,000,000 |
| 4 | Të ardhura nga lokali i lënë në përdorim H. B., 2005 – 16.1.2008 | 0 |
| 5 | Të ardhura nga paga si mësues Mat, 1992 – 1997 | 325,237 |
| 6 | Të ardhura nga emigracioni O. H., 1997 – 2004 | 221,344 |
| 7 | Të ardhura nga emigracioni M. B., 1998 – 2003 | 0 |
| 8 | Të ardhura nga paga si mësues Tiranë, shtator 2004 – tetor 2006 | 612,197 |
| 9 | Të ardhura nga paga e bashkëshortes, universiteti “***”, tetor 2006 – 31.16.1.2008 | 654,726 |
| 10 | Të ardhura nga kredia | 1,934,560 |

¹¹ Gjendja *cash*, datë 31.12.2008 = 100,000 euro (gjendja *cash*, datë 16.1.2008) – 8,000 euro (blerja e makinës) – 30,000 euro (mobilim viti 2008) – 52,388 USD ose 38,684 euro (depozitë e hapur më 9.12.2008 në Credins Bank) + 10,000 euro (shtuar për 10,000 euro të ardhura vjetore nga pagat + vëllai) = 33,316 euro.

| | | |
|---|--|---------------------|
| | Totali i të ardhurave | 10,999,889 |
| 1 | Shpenzime jetike AL | 3,549,967 |
| 2 | Shpenzime jetike Itali, 1997 – 2004 | 9,905,335 |
| 3 | Shpenzime udhëtimi | 160,170 |
| 4 | Shpenzime kredie | 24,871 |
| | Totali i shpenzimeve | 13,640,342 |
| 1 | Apartament banimi 118 m ² , *** | 7,926,320 |
| 2 | Njësi shërbimi 390 m ² , blerë në 2001 | 7,300,000 |
| 3 | Likuiditete në bankë, 16.1.2008 | 98,950 |
| 4 | Gjendje <i>cash</i> më 16.1.2008, në shumën 100,000 euro | 12,091,000 |
| | Totali i pasurive | 27,416,270 |
| | Rezultati financiar për kursimet <i>cash</i> 1992 – 16.1.2008 | - 30,056,723 |

1.6.6 Nga analiza financiare e mësipërme duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur mundësi që me të ardhura të ligjshme të krijojnë pasuritë, të paguajnë shpenzimet dhe të kursejnë deri në datën 16.1.2008 shumën 100,000 euro.

1.6.7 Në krijimin e shumës 33,000 euro, në datën 31.12.2008, përveç pjesës së mbetur të kursimeve *cash* në shumën 100,000 euro, pas përdorimit të saj për blerjen e automjetit, mobilimin e shtëpisë dhe hapjen e depozitës në dollarë, subjekti i rivlerësimit deklaroi se gjatë vitit 2008 ka krijuar kurse në shumën 10,000 euro, me të ardhurat vjetore nga pagat dhe vëllai (duke nënkuptuar pagesën për lënien në përdorim të lokalit). Pra, shuma 33,000 euro, e deklaruar në DIPP-në e vitit 2008, përbëhet nga 23,000 euro kurse *cash* ndër vite dhe 10,000 euro kurse *cash* të vitit 2008.

1.6.8 Komisioni ka analizuar mundësitë e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, bashkëshortit të saj, për krijimin e kursimeve *cash* në shumën 10,000 euro, për periudhën 16.1.2008 – 31.12.2008, sipas tabelës nr. 2.

Tabela nr. 2 – Analiza financiare për mundësinë e krijimit të kursimeve *cash* në shumën 10,000 euro, për periudhën 16.1.2008 – 31.12.2008¹²

| Nr. | Përshkrimi | Vlera |
|-----|--|------------------|
| 1 | Të ardhura nga puna si drejtoreshë kabinetit PP (16.1.2008 – 31.12.2008) | 1,367,165 |
| 2 | Të ardhura nga lokali i lënë në përdorim H. B. | 0 |
| 3 | Të ardhura nga paga e bashkëshortes, universiteti “***”, 2008 | 668,727 |
| 4 | Të ardhura nga paga e bashkëshortes, universiteti “***”, 2008 | 86,400 |
| 5 | Të ardhura nga paga e bashkëshortes, universiteti “***”, në Union Bank, 2008 | 55,800 |
| | Totali i të ardhurave | 2,178,092 |
| 1 | Shpenzime jetike 2008 | 522,525 |
| 2 | Shpenzime udhëtimi 2008 | 17,861 |

¹² Në analizimin e mundësisë për shtesë të kursimeve *cash* në shumën 10,000 euro, gjatë vitit 2008, nuk janë përfshirë shpenzimet (mobilimi) dhe pasuritë (blerja e automjetit dhe depozita në dollarë) të krijuara me gjendjen *cash* 100,000 euro para datës 16.1.2008.

| | | |
|---|--|------------------|
| 3 | Shpenzime <i>leasing</i> 2008 | 279,316 |
| | Totali i shpenzimeve | 819,702 |
| 1 | Ndryshim likuiditeti në bankë | 207,229 |
| | Totali i shpenzimeve | 207,229 |
| | Rezultati financiar në vitin 2008 | 1,151,161 |

1.6.9 Komisioni analizoi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj për krijimin e kursimeve *cash* në shumën 10,000 euro, me të ardhura të ligjshme gjatë vitit 2008. Nga kjo analizë rezultoi se ata kishin mundësi që me të ardhura të ligjshme të krijojnë një shtesë të kursimeve *cash* në vitin 2008, në shumën 1,151,161 lekë ose 9,345 euro (konvertuar me kursin e këmbimit 123.1825), nga 10,000 euro të deklaruar.

1.7 Analizë e depozitës në Credins Bank, ku 6,000 USD janë deklaruar si burim blerjeje apartamenti

1.7.1 Credins Bank¹³ konfirmon depozitën në emër të bashkëshortit të subjektit O. H., me gjendje 52,338.94 USD, në datën 31.12.2008. Sipas deklarimit periodik, kjo depozitë është krijuar me kursimet *cash* 100,000 euro, të deklaruar në datën 16.1.2008. Në lidhje me pakësimin e depozitës në Credins Bank, në shumën 6,000 USD, të deklaruar nga subjekti si burim për blerjen e apartamentit, konfirmohet nga veprimet bankare tërheqja e kësaj shume në datën 10.6.2009.

1.7.2 Në pikën 1.6.5 të vendimit është analizuar mundësia financiare e subjektit dhe bashkëshortit të saj për të krijuar me të ardhura të ligjshme kursimet *cash* në shumën 100,000 euro, nga ku rezultuan me pamundësi financiare prej -30,056,723 lekësh për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasuritë (përfshirë edhe gjendjen *cash*) deri në datën 16.1.2008. Në kushtet kur nuk provohet burimi i ligjshëm i shumës 100,000 euro, të deklaruar si kursime *cash* në datën 16.1.2008, ku një pjesë e kësaj shume sipas deklarimit të subjektit është përdorur për hapjen e depozitës 52,338.94 USD në datën 9.12.2008, nuk provohet as burimi i ligjshëm i depozitës së krijuar nga gjendja *cash*.

1.8 Analizë të ardhurave të përfituara nga emigracioni në Itali për periudhën 1997 – 2004

1.8.1 Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar të ardhura nga emigracioni në Itali për periudhën 1997 – 2004, por nuk ka përcaktuar vlerën monetare të tyre.

1.8.2 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* dokumentacionin: (i) leje qëndrimi për të huaj në emër të shtetasit O. H., për periudhën 11.11.1998 – 6.11.2002, lëshuar nga Ministria e Brendshme Italiane; (ii) kartë identiteti në emër të shtetasit O. H., lëshuar në datën 21.2.2000, me afat 5-vjeçar; (iii) librezë pune në emër të shtetasit O. H., ku identifikohen periudhat e punësimit 17.11.1999 – 5.1.2000, 30.10.2000 – 23.11.2000 dhe 2.11.2001 – 15.12.2001; (iv) certifikatë e rezidencës në emër të shtetasit O. H., lëshuar në datën 19.10.2002, në P.; (v) listëpagesë për muajin nëntor 1999, me pagë neto 193 euro; (vi) listëpagesë për muajin dhjetor 1999, me pagë neto 455 euro; (vii) listëpagesë për muajin janar 2000, me pagë neto 105 euro; (viii) listëpagesë për muajin nëntor 2001, me pagë neto 946 euro.

¹³ Përgjigje e Credins bank nr. *** prot., datë 17.3.2021 drejtuar Komisionit.

1.8.3 Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting*, ka dhënë sqarime lidhur me emigracionin në Itali, ku shpjegon se në korrik 1997 kanë shkuar familjarisht në Itali me vizë të rregullt. Bashkëshorti i saj ka punuar vazhdimisht në vende të ndryshme, por pa dokumente, deri në vitin 2004 sepse punëdhënësit e tij në Itali nuk e punësonin me dokumente, përveç dy muajve që duheshin për të marrë leje qëndrimi. Subjekti ka sqaruar se ka punuar në Itali në periudhën 1998 – 2003, por nuk disponon dokumentacion. Të ardhurat e fituara kanë shërbyer për blerjen e aseteve të deklaruara, si dhe për përballimin e shpenzimeve familjare ndër vite në Shqipëri.

1.8.4 Në DPDFD-në e vitit 2008 (kur subjekti ka qenë me detyrë drejtoreshë kabinetit në Prokurorinë e Përgjithshme), në rubrikën “Angazhime dhe veprimtari private”, ka deklaruar: *“Të ardhura nga puna në emigracion gjatë viteve 1998 – 2003, në shumën 40,000 euro; të ardhura nga puna e bashkëshortit në emigracion gjatë viteve 1997 – 2004, në shumën 150,000 euro”*.

1.8.5 Subjekti, e pyetur në ILDKPKI në vitin 2009¹⁴, që të vërtetojë me dokumentacion ligjor të ardhurat e realizuara prej saj në emigracion në Itali, në shumën 40,000 euro, për periudhën 1998 – 2003 dhe për të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti i saj O. H., në shumën 150,000 euro, për periudhën 1997 – 2004, ka deklaruar se *nuk disponon dokumentacion justifikues për të ardhurat e realizuara prej saj dhe bashkëshortit nga emigracioni në Itali*.

1.8.6 Me pyetësin nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime për mosdeklarimin në deklaratën *Vetting* të vlerës monetare të të ardhurave të realizuara në emigracion prej saj dhe bashkëshortit O. H., e cila ka shpjeguar se është lapsus (harresë) dhe deklarimi i vërtetë është ashtu siç është deklaruar në DPDFD-në e vitit 2008: *“Të ardhura të deklaruara nga unë në shumën 40,000 euro dhe nga bashkëshorti 150,000 euro”*.

1.8.7 Me pyetësin nr. 3, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë informacionin mbi shpenzimet jetike për vitet e qëndrimit me familjen në Itali për periudhën 1997 – 2004. Subjekti ka shpjeguar se për shpenzimet jetike të familjes për periudhën 1997 – 2004 në Itali, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, nuk mund të japë informacion të saktë, por deklaroi se shpenzimet jetike të kësaj periudhe kanë qenë minimale, për shkak të jetesës modeste, si dhe të qëllimit që kishin për të kursyer sa më shumë dhe për t’u kthyer në Shqipëri.

1.8.8 Komisioni, për efekt të analizës financiare, ka përllogaritur shpenzimet jetike në Itali referuar të dhënave të marra nga faqja zyrtare e INSTAT-it¹⁵ italian, sipas periudhave të qëndrimit të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit¹⁶.

Subjekti ka provuar me dokumentacion ligjor vetëm shumën prej 1,699 euro, si e ardhur nga emigracioni, shumë kjo e përfshirë që në fillim në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

1.8.9 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, në lidhje me shumën 35,000 euro, me të cilën është blerë apartamenti në ***, ka konstatuar se:

¹⁴ Dokumentacion i përcjellë nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2021.

¹⁵ *Follow the path: Poverta’ -> Poverta’ serie interrotte 1997-2013 -> Soglia di poverta relativa*

¹⁶ Për periudhën 2000 – 2004 nuk janë llogaritur shpenzime jetike në Itali për vajzën, pasi në këtë periudhë, sipas deklaramit të subjektit, ajo ka ndjekur studimet në Shqipëri në shkollën 9-vjeçare “****”, B..

- a) Nga shuma 33,000 euro (gjendje *cash*) si burim i blerjes së apartamentit, subjekti provon me të ardhura të ligjshme vetëm shumën 9,345 euro.
- b) Nuk provohet ligjshmëria e krijimit të shumës 6,000 USD, e deklaruar nga subjekti si burim krijimi për blerjen e apartamentit.
- c) Subjekti i rivlerësimit rezulton me pamundësi burimesh të ligjshme financiare në shumën 25,655 euro, për blerjen e apartamentit (nga shuma 35,000 euro vetëm 9,345 euro janë kursime të ligjshme të krijuara gjatë vitit 2008).

Për konstatimet e mësipërme, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.9 Subjekti, në prapësime, në lidhje me burimin e shumës 33,000 euro, ndër të tjera, ka shpjeguar se fillimisht Komisioni ka kryer analizën financiare për të verifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kursimeve *cash* të deklaruara në datën 16.1.2008, në shumën 100,000 euro, nga të cilat 33,000 euro të deklaruara në datën 31.12.2008 janë përdorur si burim i blerjes së apartamentit në shumën 35,000 euro, në datën 16.7.2009 dhe ka konstatuar diferencë. Por, ndryshe nga Komisioni, në tabelën e paraqitur nga subjekti¹⁷, ajo shpjegon se nga tabela rezulton se bashkë me bashkëshortin kanë krijuar me të ardhura të ligjshme shumën 100,000 euro, të deklaruara përpara fillimit të detyrës.

1.9.1 Sipas subjektit, Komisioni ka kryer analizën financiare për mundësinë e krijimit të kursimeve *cash* në shumën 10,000 euro, për periudhën 16.1.2008 – 31.12.2008, analizë nga e cila ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur mundësi të krijojnë gjatë vitit 2008 kursimet në vlerën 10,000 euro. Në analizën e Komisionit nuk përfshihen të ardhurat e përfituara nga vëllai i subjektit, z. H. B., të cilat, sipas subjektit, siç u argumentua më sipër, janë krijuar me të ardhura të ligjshme. Fakti që analiza financiare rezulton pozitive, edhe pa u përfshirë të ardhurat nga lokali, duhet të vlerësohet nga Komisioni si një e dhënë nga e cila rezulton vërtetësia e deklarimeve të saj (pra në DIPP janë deklaruar të ardhurat, ashtu siç ato kanë rezultuar dhe jo në varësi të situatës financiare).

1.9.2 Subjekti, më tej, ka shpjeguar se në analizën e kryer prej saj janë përfshirë:

- i) Të ardhurat nga emigracioni në shumën 190,000 euro¹⁸.
- ii) Të ardhurat e përfituara nga lokali në shumën 2,400,000 lekë, deri në datën 16.1.2008 (1,000,000 + 1,400,000 lekë).
- iii) Janë reduktuar shpenzimet jetike deri në vitin 1998, në masën 30% e të ardhurave, sipas vendimit të KPA-së të vitit 2021. Shpenzimet jetike në Shqipëri të vitit 2007 janë përlllogaritur si mesatare aritmetike e viteve 2005 dhe 2006 (shpenzimet jetike në Shqipëri nga subjekti janë llogaritur 2,161,651 lekë).
- iv) Janë reduktuar shpenzimet jetike në Itali, të vitit 2004, pasi bashkëshorti është kthyer në shkurt të vitit 2004 (shpenzimet jetike në Itali nga subjekti janë llogaritur 8,282,408 lekë).

¹⁷ Shihni tabelën e analizës financiare të subjektit në prapësime.

¹⁸ Të ardhura nga emigracioni O. H., 1997 – 2004, në shumën 20,823,000 lekë dhe të ardhura nga emigracioni Miranda Bushi, 1998 – 2003, në shumën 5,592,800 lekë.

- v) Janë reduktuar shpenzimet e udhëtimit në *** dhe ***, përkatësisht në vitet 2005 dhe 2006, sipas shpjegimit të poshtëshënuar në këtë observacion.
- vi) Përveç sa më sipër, subjekti shpjegon se shpenzimet (qira banese, drita, ujë, etj.) kanë qenë zero gjatë gjithë kohës, pasi kanë qenë të mbuluara/paguara nga vëllai i bashkëshortit, z. L. H. (deklarata e tij noteriale, bashkëlidhur), si dhe nga puna në paneteri e subjektit, ku shpenzimet bazike për ushqim ishin nga paneteria. Të gjitha këto zvogëlojnë në vlerë të konsiderueshme shpenzimet jetike në total të qëndrimit të tyre në Itali.

1.9.3 Sipas pretendimit të subjektit, nga analiza financiare e sipërcituar rezultojnë se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë pasur mundësi që me të ardhura të ligjshme të krijojnë pasuritë, paguajnë shpenzimet dhe të kursejnë deri në datën 16.1.2008, shumën 100,000 euro (ku mundësia për kursime *cash* për periudhën 1992 – 16.1.2008 është në vlerën +666,218 lekë nga -30,056,723 lekë¹⁹, që ishte analiza e Komisionit).

1.9.4 Në lidhje me pakësimin e depozitës në Credins Bank, në shumën 6,000 USD, të deklaruar si burim për blerjen e apartamentit, është analizuar mundësia financiare e familjes së subjektit për të krijuar me të ardhura të ligjshme kursimet *cash* në shumën 100,000 euro, nga ku rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë pasur mundësi të krijojnë me të ardhura nga burime të ligjshme shumën *cash* të deklaruar. Në këto kushte, provohet burimi i ligjshëm i shumës 100,000 euro, të deklaruar si kursime *cash* në datën 16.1.2008, ku një pjesë e saj është përdorur për krijimin e depozitës prej 52,388.94 USD në datën 9.12.2008, pra provohet edhe burimi i ligjshëm i depozitës së krijuar nga gjendja *cash*.

1.10 Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për përfshirje në analizë financiare të të ardhurave nga emigracioni në Itali²⁰

1.10.1 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera në prapësime²¹, ka shpjeguar se kur kanë shkuar në Itali kanë jetuar me qira dhe gjithmonë shpenzimet për qiranë janë paguar nga vëllai i bashkëshortit, z. L. H., pasi kishte të ardhura të konsoliduara.

1.10.2 Subjekti ka vijuar të punojë në një dyqan buke/pastiçeri, e përgjistruar në organet tatimore. Shpenzimet në Itali kanë qenë minimale, pasi produktet bazë të jetesës siguroheshin falas nga dyqani i bukës. Gjithashtu, edhe vajza K. H. ka frekuentuar kopsht dhe shkollë, të financuar nga kisha e cila mbulonte çdo shpenzim si, ushqim, veshje etj. Bashkëshorti O. H. ka punuar në aktivitetin e shitblerjeve të produkteve kozmetike, duke krijuar të ardhura të konsiderueshme dhe kur ishte i lirë ka punuar në ndërtim në vende të ndryshme. Subjekti shpjegon se gjatë kësaj kohe është munduar të kontaktojë me personat me të cilët subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë punuar në Itali, por për efekt të kohës së gjatë që ka kaluar (rreth 20 vjet) ka qenë e pamundur për të kontaktuar me ta, përveç shtetasit G. C., administrator i shoqërisë “****” srl, ku bashkëshorti ka punuar në periudha të ndryshme kohore. Subjekti ka depozituar edhe një deklaratë të z. C., për vërtetimin e këtij fakti.

¹⁹ Ndërkohë që Komisioni, me rezultatet e hetimit i ka dërguar subjektin rezultatin financiar -37,060,845 lekë.

²⁰ Subjekti ka qëndruar në periudhën 1998 – 2003, ndërsa bashkëshorti O. H. në periudhën 1997 – 2004.

²¹ Për detaje, shihni prapësimet e subjektit në dosje.

1.10.3 Subjekti ka shpjeguar se për shkak të jetës modeste dhe me shpenzime të reduktuara, gjendja ekonomike u përmirësua ndjeshëm dhe në fillim të vitit 2001 vendosi që me të ardhurat e krijuara të blinin lokalitetin “****” në *** dhe më pas pasuritë e tjera.

1.10.4 Subjekti ka depozituar të njëjtin dokumentacion (mbi punësimin në shtetin italian) të depozituar më parë, të përmendur në pikën 1.8.2 të vendimit, nga ku rezulton se me to provohen të realizuara vetëm të ardhura në shumën 1,699 euro ose 221,344 lekë.

1.10.5 Subjekti ka shpjeguar se pjesa më e madhe e të ardhurave të fituara janë dërguar në Shqipëri me transfertë bankare ose *cash* gjatë viteve kur ajo dhe bashkëshorti i saj vinin në Shqipëri dhe janë ruajtur nga babai i saj N. B.. Në kërkim të dokumentacionit, subjekti ka mundur të sigurojë dy mandate derdhjeje në lireta të shtetasit N. B. pranë Bankës Italo-Shqiptare (në vijim BIA), aktualisht Intesa Sanpaolo Bank (në vijim ISP). Kësaj banke i është kërkuar informacion për vërtetësinë e tyre, e cila konfirmon se shtetasi N. B. ka disponuar dy llogari në lireta tek BIA Bank. Gjithashtu, me një përgjigje tjetër, kjo bankë konfirmon se shtetasi O. H. ka pasur llogari në lireta në ish-BIA Bank, me nr. **, por nuk ka detaje të tjera. Nga dokumentacioni i siguruar rezulton se vetëm në 9 muajt e parë në emigracion subjekti me bashkëshortin kanë mundur të kursejnë një shumë prej 27,750,000 liritash, që bazuar në kursin e këmbimit të kohës përllogariten rreth 15,000 euro kursime, fakt që vërteton trendin dhe shpeshhtësinë e të ardhurave të realizuara gjatë periudhës në emigracion se në vitet në vazhdim ka qenë më i lartë. Edhe sikur ky trend të merret i mirëqenë, rezulton se kursimet në emigracion nga bashkëshorti përkojnë me shumën e deklaruar të të ardhurave nga subjekti përpara detyrës në vitin 2008.

1.10.6 Sipas subjektit, për të ardhurat nga emigracioni Komisioni duhet të marrë në konsideratë disa rrethana, bazuar në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Këto të ardhura janë realizuar shumë kohë përpara miratimit dhe hyrjes në fuqi të paketës së reformës në drejtësi, duke përfshirë edhe ligjin nr. 84/2016. Për më tepër, këto të ardhura janë krijuar shumë kohë para fillimit të detyrës.

1.10.7 Subjekti vijon të shpjegojë se në deklaratën *Vetting* është deklaruar fakti i realizimit të këtyre të ardhurave, por jo shuma e tyre. Mosdeklarimi i shumës është harresë/lapsus, por kjo vlerë është e njëjtë me atë të deklaruar në DPFD-në e vitit 2008 si të ardhura të realizuara nga subjekti në shumën 40,000 euro dhe nga bashkëshorti në shumën 150,000 euro. DIPP-ja e vitit 2008 është më e afërt në aspektin kohor me realizimin e të ardhurave në emigracion dhe, për këtë arsye, Komisioni duhet të vlerësojë DIPP-në e vitit 2008 si provë, sipas përcaktimeve të nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016, qëndrim i mbajtur nga Kolegji me vendimin nr. 14/2021.

1.10.8 Subjekti, gjatë gjithë periudhës së deklarimit, ka shpjeguar realizimin e të ardhurave, si dhe faktin se këto të ardhura nuk justifikohen me dokumentacion të plotë ligjor, pasi janë krijuar nga marrëdhënie pune të paformalizuara. Nën dritën e këtyre fakteve dhe bazuar në analizën dhe arsyetimin logjik, pasqyrimin ndër vite të vlerave monetare të konsiderueshme në disponim të familjes, si dhe në konsideratë të faktit se deklaratimet e subjektit janë konsistente dhe në to nuk gjenden pasaktësi, arrihet në përfundimin se pasuritë e deklaruara përpara fillimit të detyrës janë krijuar kryesisht me të ardhura të ligjshme, të përfituara në emigracion, si dhe gjatë hetimit janë paraqitur prova dhe deklarime të mjaftueshme, nga të cilat subjekti vlerëson se ka përmbushur detyrimin kushtetues, duke dhënë shpjegime bindëse mbi ligjshmërinë e të ardhurave dhe pasurive,

të cilat qartësisht janë krijuar përpara fillimit të detyrës në vitin 2012. Është e vërtetë se subjekti ka ushtruar detyrën e prokurores në vitet 1992 – 1998, por, përveç kursimit të një vlere të vogël likuiditeti, gjatë kësaj periudhe nuk është krijuar asnjë pasuri tjetër.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

Në parantezë të analizës, Komisioni vlerëson se duhet mbajtur në konsideratë fakti se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e prokurorit në periudhën 1992 – 1997 dhe në vitin 2012 e në vazhdim.

1.11 Në lidhje me të ardhurat e realizuara nga emigracioni në Itali në vitet 1997 – 2004, Komisioni, pasi ka analizuar shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, arsyeton se:

1.11.1 Për mosdeklarimin e shumës së të ardhurave nga emigracioni për periudhën 1997 – 2004, në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë, në kundërshtim me shkronjën “a”, pika 5, neni 33 i ligjit nr. 84/2016.

1.11.2 Subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ ka provuar me dokumentacion ligjor vetëm shumën 1,699 euro²², si e ardhur nga emigracioni, shumë kjo e përfshirë që në fillim në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

1.11.3 Subjekti i rivlerësimit, kur i është kërkuar në ILDKPKI në vitin 2009 për të depozituar dokumentacion ligjor për të ardhurat e realizuara prej saj në periudhën 1998 – 2003, në shumën 40,000 euro dhe bashkëshortit të saj në periudhën 1997 – 2004, në shumën 150,000 euro, ka deklaruar se nuk disponon dokumentacion justifikues të realizimit të këtyre të ardhurave. Po kështu, në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se bashkëshorti ka punuar vazhdimisht pa dokumente, si dhe subjekti, kur ka punuar në paneteri, nuk ka disponuar dokumentacion. Edhe së fundmi në prapësimet e saj, subjekti ka deklaruar se nuk disponon dokumentacion mbi punësimin e saj dhe të bashkëshortit të saj.

Nisur nga këto rrethana, Komisioni vëren se pretendimi i subjektit, që ndodhet në kushtet e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nuk qëndron, për faktin se kërkesat e nenit 32 janë të lidhura me pamundësinë objektive të subjektit të rivlerësimit për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të këtyre të ardhurave në rastin konkret²³, ndërkohë që subjekti ka deklaruar qartë se nuk disponon dokumentacion justifikues për këto të ardhura, pasi të dy ata (subjekti me bashkëshortin) kanë punuar të pargjistruar në organet tatimore, për më tepër që vetë subjekti ka paraqitur dokumentacion zyrtar mbi të ardhurat për vitet 1999, 2000 dhe 2001.

1.11.4 Subjekti i rivlerësimit, pas rezultateve të hetimit, ka depozituar si provë një deklaratë noteriale të datës 30.9.2022²⁴, ku shtetasi L. H. deklaron se nga fillimi i biznesit të tij, në datën

²² Listëpagesa për muajin nëntor 1999, me pagë neto 193 euro; listëpagesa për muajin dhjetor 1999, me pagë neto 455 euro; listëpagesa për muajin janar 2000, me pagë neto 105 euro; listëpagesa për muajin nëntor 2001, me pagë neto 946 euro.

²³ Neni 32 “Deklarimi i pasurisë”, pika 2: “Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor”.

²⁴ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.9.2022.

11.3.2003, deri në shkurt 2004, meqenëse vëllai i tij O. H. i ka dhënë ndihmë në biznesin e tij, ai i ka dhënë nga fitimi i deklaruar një pagë mujore prej 3,000 euro. Ky dokument nuk u mor në konsideratë nga Komisioni, pasi është dokument deklarativ dhe i pashoqëruar me dokumentacion ligjor, që të provojë punësimin e shtetasit O. H. në këtë biznes, si dhe nuk provon që të jenë paguar tatime/sigurime. Gjithashtu, në lidhje me deklaratën noteriale, Komisioni mban në konsideratë qëndrimet e mbajtura nga Kolegji²⁵ në çështje të ndryshme, sipas të cilave deklaratata noteriale, megjithëse nuk është e pavlefshme, në kuptim të legjislacionit për noterinë, fuqia e saj provuese në këtë proces nuk është bindëse, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe se nuk mbështetet nga dokumentacion provues për burimin e krijimit të pasurisë në momentin e krijimit të saj.

1.11.5 Në lidhje me pretendimin se të ardhurat e realizuara në Itali mbaheshin nga i ati i subjektit N. B., një pjesë e të cilave janë depozituar prej tij në ish-Bankën Italo Shqiptare në vitin 1998 (në shumën 27,750,000 lireta, të konvertuara në euro në afërsisht 15,000 euro), mandate të konfirmuara edhe nga Intesa Sanpaolo Bank (ish-BIA Bank), Komisioni nuk i mori ato në konsideratë, pasi këto mandate nuk provojnë që këto shuma në monedhën lireta të jenë nga të ardhurat e realizuara nga subjekti i rivlerësimit apo edhe bashkëshorti i saj.

1.11.6 Po kështu, edhe në lidhje me deklaratën noteriale të datës 15.5.2023²⁶, ku shtetasi N. B. deklaroi se depozitat në ish-BIA Bank në vitin 1998 janë krijuar nga të ardhurat e realizuara nga puna në emigracion e vajzës Miranda Bushi dhe bashkëshortit të saj, Komisioni nuk e mori në konsideratë, me të njëjtin arsyetim si më lart, të dhënë edhe për deklaratën noteriale të shtetasit L. H..

1.11.7 Subjekti, gjithashtu, ka depozituar një deklaratë të datës 10.5.2023, të shtetasit italian G. C., i cili ka deklaruar se shtetasi O. H. ka punuar në shoqërinë “****” srl, M., me detyrën e konsulentit, për periudhën 1.8.1997 – 15.11.1999, me pagesë prej 2,500,000 liretash neto tatim në burim dhe për periudhën 15.1.2000 – 30.10.2000, me pagesë prej 2,700,000 liretash neto tatim në burim. Komisioni nuk e mori në konsideratë këtë deklaratë, pasi ajo ka karakter deklarativ, është bërë gjatë procesit të hetimit administrativ, e konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit dhe nuk mbështetet në dokumentacion provues të realizimit të këtyre të ardhurave, ku të jenë paguar edhe detyrimet tatimore.

1.11.8 Në një komunikim me postë elektronike të datës 30.9.2022, të bashkëshortit O. H., i cili i drejtohet një shtetasi italian R. L., ku i kërkon informacion për periudhën 1997 – 2004, për sa i përket aktivitetit të punës së tij dhe me *email*-in e datës 1.5.2023, shtetasi O. H. i drejtohet përsëri shtetasit R. L., por nga ky i fundit nuk ka asnjë përgjigje.

1.11.9 Komisioni, gjithashtu, mban në konsideratë edhe qëndrimin që Kolegji²⁷ ka mbajtur në çështje të ndryshme, ku për të ardhurat e realizuara në emigracion, për të cilat nuk provohet të jenë

²⁵ Vendim nr. 6/2018, datë 12.9.2018, i subjektit B. N.; nr. 11/2019, datë 22.5.2019, i subjektit E. I.; nr. 34/2019, datë 2.12.2019, i subjektit E. P.; nr. ***, datë 23.11.2020, i subjektit D. S.

²⁶ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.5.2023.

²⁷ Vendim i Kolegjit nr. 12, datë 17.12.2018, i subjektit B. D.; vendim i Kolegjit nr. 15, datë 18.5.2022, i subjektit N. D.

paguar tatimet dhe sigurimet shoqërore, ato nuk plotësojnë kriterin e të ardhurave të ligjshme, në përputhje me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 86/2014. Gjithashtu, nuk provohet edhe mënyra se si këto të ardhura janë sjellë në Shqipëri nga subjekti dhe bashkëshorti i saj.

1.12 Në lidhje me pretendimin për reduktim të shpenzimeve jetike në Itali, të vitit 2004

Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se shpenzimet jetike në Itali duhen përfshirë në analizën financiare në shumën 8,282,408 lekë dhe jo në shumën 9,905,335 lekë, të llogaritura nga Komisioni, me pretendimin se:

- shpenzimet jetike në Itali janë përlllogaritur gjithë vitin 2004, ndërkohë që bashkëshorti i saj është kthyer në shkurt të vitit 2004;
- shpenzimet jetike kanë qenë minimale, pasi shpenzimet e qirasë janë paguar nga vëllai i bashkëshortit, z. L. H.;
- subjekti i rivlerësimit, meqenëse ka punuar në një furrë buke, ka mundur të sigurojë ushqimet jetike të rëndësishme ditore, duke kursyer kështu edhe në këtë drejtim.

1.12.1 Komisioni vëren se fillimisht janë llogaritur shpenzime jetike në Itali për gjithë vitin 2004, bazuar në deklarinimin e subjektit në deklaratën *Vetting* për të ardhurat e realizuara nga lokali për periudhën 2002 – fund 2004, duke llogaritur shpenzimet jetike në shumën 6,624 euro (janar – dhjetor 2004). Pas prapësimeve të subjektit, Komisioni ka llogaritur shpenzimet jetike në Itali për bashkëshortin O. H., vetëm për 2 muajt e parë të vitit 2004, në vlerën 1,104 euro ose 139,918 lekë dhe për muajt e tjerë, mars – dhjetor 2004, i ka përfshirë si shpenzime jetike në Shqipëri, ku nga vlera 2,522,800 lekë rillogariten në 2,601,020 lekë.

1.12.2 Në lidhje me pagimin e qirasë së banesave nga ana e vëllait të bashkëshortit të subjektit, z. L. H., subjekti ka depozituar një deklaratë noteriale të datës 30.9.2022²⁸, ku ky shtetas ka deklaruar se vëllai i tij O. H. bashkë me familjen kanë jetuar në banesat që ai merrte me qira në Itali dhe nuk kanë pasur shpenzime banimi, por vetëm jetese. Komisioni vëren se deklarata noteriale, ashtu siç u shpjegua edhe në rastet e tjera më lart, nuk merret në konsideratë nga Komisioni, pasi megjithëse nuk është e pavlefshme, në kuptim të legjislacionit për noterinë, fuqia e saj provuese në këtë proces nuk është bindëse, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe se nuk mbështetet nga dokumentacioni provues për burimin e krijimit të pasurisë në momentin e krijimit të saj. Gjithashtu, mbetet jo i besueshëm deklarimi i subjektit gjatë hetimit, lidhur me faktin se vëllai i bashkëshortit punon në Itali, i paguan subjektit dhe bashkëshortit të saj qiranë për shumë vite me radhë, që subjekti dhe bashkëshorti të kursejnë dhe të blejnë pasuri në Shqipëri, ndërkohë që nuk ka depozituar dokumentacion ligjor të mjaftueshëm që të vërtetojë mundësinë financiare të vëllait të bashkëshortit në lidhje me pagesën edhe të shpenzimeve të qirasë për familjen e subjektit.

1.12.3 Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka llogaritur në analizë financiare si shpenzime jetike në Itali shumën 8,282,408 lekë, nga 9,905,335 lekë të llogaritura nga Komisioni para dërgimit të rezultateve të hetimit, pa shpjeguar në mënyrë analitike dhe ligjore se si është bërë kjo përlllogaritje,

²⁸ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.9.2022.

gjë e cila i është kërkuar nga Komisioni edhe me pyetësin nr. 3, ku i kërkoi shpjegime për shpenzimet jetike në Itali për periudhën 1997 – 2004, meqenëse nga subjekti u deklaruan minimale, ndërkohë që ajo nuk dha shpjegime për këto shpenzime. Në kontradiktë me këtë deklaram të subjektit në pyetësin nr. 3, subjekti kërkon që reduktimi i shpenzimeve jetike në Itali të llogaritet nga shuma 9,905,335 lekë e Komisionit, në shumën 8,282,408 lekë të pretenduar nga subjekti. Komisioni vendosi të mos e marrë në konsideratë pretendimin e subjektit për përfshirjen e shpenzimeve jetike në Itali në shumën 8,282,408 lekë, por vendosi që në analizë financiare, pas rilogaritjes, shpenzimet jetike të mbeten në vlerën 8,788,345 lekë, ashtu siç janë llogaritur nga Komisioni në bazë të INSTAT-it italian, sikurse parashtruar në pikën 1.8.8.

1.13 Në lidhje me pretendimet e tjera të subjektit për përfshirje në analizën financiare të:

- a) Të ardhurave të përfituara nga lokali në shumën 2,400,000 lekë deri në datën 16.1.2008 (1,000,000 + 1,400,000), të cilat janë analizuar në mënyrë të detajuar në pikën 10 të vendimit, Komisioni vendosi t'i marrë në konsideratë dhe t'i përfshijë në analizën financiare.
- b) Reduktimin e shpenzimeve jetike deri në vitin 1998, në masën 30% e të ardhurave, sipas vendimit të Kolegjit të vitit 2021, të cilat janë analizuar dhe përfshirë në analizën financiare në pikën 13.
- c) Reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit në *** dhe në ***, përkatësisht në vitet 2005 dhe 2006, këto janë analizuar dhe përfshirë në analizën financiare në pikën 13.

Komisioni, në përfundim, vlerëson se për të ardhurat e realizuara nga emigracioni në Itali për periudhën 1997 – 2004, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurive:

- Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshorti O. H., nuk kanë deklaruar vlerën e tyre në deklaratën *Vetting*, duke qenë në kushtet e një deklarimi të pasaktë, në kundërshtim me shkronjën “a”, pika 5, neni 33 i ligjit nr. 84/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e apartamentit në ***, duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, neni 33, pika 5, shkronja “b” dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
- Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të/bashkëshorti rezultojnë me pamundësi burimesh të ligjshme financiare në shumën 25,655 euro, për blerjen e apartamentit në *** (nga shuma 35,000 euro vetëm 9,345 euro janë kursime të ligjshme të krijuara gjatë vitit 2008).

2. Llogari rrjedhëse e pagës në Credins Bank, me gjendje në datën 31.12.2016, në shumën 848.52 lekë, me pjesë takuese 100%.

Kjo llogari është konfirmuar nga Credins Bank²⁹ si llogari page në emër të subjektit të rivlerësimit, me gjendje në datën 31.12.2016, në shumën 848.52 lekë.

Nuk konstatohen problematika në lidhje deklarin e kësaj llogarie bankare.

3. Llogari në Intesa Sanpaolo Bank, në emër të djalit K. H., me gjendje 321 USD

²⁹ Përgjigje e Credins Bank nr. *** prot., datë 17.3.2021, drejtuar Komisionit.

Kjo llogari është konfirmuar nga Intesa Sanpaolo Bank³⁰ si llogari në emër të djalit të subjektit të rivlerësimit, me gjendje në datën 31.12.2016, në shumën 321.18 USD.

Nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë llogari bankare.

PERSONI I LIDHUR ME SUBJEKTIN, BASHKËSHORTI O. H.

4. Apartament banimi me sip. 118 m²³¹, me adresë rruga “**”, blloku “****”, blerë në shumën 62,540 euro, regjistruar në emrin e z. O. H.. Burimi i krijimit: (a) të ardhura nga puna gjatë viteve 1997 – 2004, në emigracion, Itali; (b) kredi bankare në BKT në shumën 16,000 euro, e cila është shlyer plotësisht.**

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

4.1 Në DDPD-në e vitit 2008, subjekti e ka deklaruar këtë pasuri të përfituar me kontratë sipërmarrjeje nga shoqëria “****” sh.p.k., blerë në vlerën 62,540 euro, në emër të bashkëshortit, me burim: (a) të ardhurat nga puna në vitet 1998 – 2004, në emigracion, Itali; (b) kredi bankare.

4.2 Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti bashkë me deklaratën *Vetting*, ka rezultuar se ky apartament është përfituar me kontratën e sipërmarrjes datë 1.7.2004³², me sipërmarrës shoqërinë “****” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori G. K. dhe porositës O. H., për apartamentin 2 + 1, me sip. 118 m², ndodhur në godinën nr. ***, rruga “****”, kati ***, shk. ***, me çmim 62,540 euro. Në nenin 4 të kontratës parashikohet se me lidhjen e kontratës do të paguhet 35% e vlerës së apartamentit, në shumën 21,889 euro; me përfundimin e karabinasë do të paguhet 40% e vlerës, në shumën 25,016 euro; me fillimin e rifiniturës do të paguhet 20% e vlerës, në shumën 12,508 euro; me dorëzimin e çelësave në dorë do të paguhet 5% e vlerës së apartamentit, në shumën 3,127 euro. Në nenin 5 është përcaktuar se likuidimet e mundshme palët kanë rënë dakord që të kryhen pranë zyrave të shoqërisë ose pranë bankës së kursimeve në numër llogarie në lekë ose në dollarë dhe në ProCredit Bank në euro, me urdhër xhirimi ose *cash*.

4.2.1 Me dokumentin e datës 25.9.2006, drejtori i financës A. K., drejtuar drejtorisë së kantierit të ndërtimit (të shoqërisë “****” sh.p.k.) ka deklaruar: “*Klienti O. H. ka likuiduar të gjitha detyrimet 100%, sipas kontratës së sipërmarrjes. T’i kryhen të gjitha punimet dhe t’i bëhet dorëzimi i apartamentit*”.

4.2.2 Pas kontratës së sipërmarrjes të lidhur me datë 1.7.2004, shtetasi O. H., në datën 16.5.2013³³, ka lidhur kontratën e shitblerjes me shoqërinë “****” sh.p.k. përfaqësuar nga administratori G. K., për apartamentin me sipërfaqe totale 106.9 m², në rrugën “****”, në shumën 5,079,900 lekë (e shkruar edhe me fjalë). Kjo vlerë është likuiduar nga ana e blerësit në favor të shitësit jashtë kësaj zyre noteriale, sipas kontratës së sipërmarrjes. Me regjistrimin e kësaj kontrate në ZVRPP-në Tiranë, nga kjo e fundit është lëshuar certifikata e pronësisë datë 22.5.2013, të apartamentit me

³⁰ Shkresë e ISP Bank nr. *** prot., datë 23.2.2021, drejtuar Komisionit.

³¹ Z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***.

³² Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 1.7.2004.

³³ Kontratë shitjeje nr. ***, datë 16.5.2013, depozituar nga subjekti bashkë me deklaratën *Vetting*.

sip. 106.9 m², i ndodhur në rrugën “****”, z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, në emër të shtetasit O. H..

4.2.3 Subjekti bashkë me deklaratën *Vetting* ka depozituar edhe deklaratën noteriale të datës 27.1.2017³⁴, me deklarues G. K., administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., i cili deklaroi se: “*Në datën 16.5.2013 kam nënshkruar kontratën e shitjes së kësaj pasurie, me nr. ***, me palën blerëse O. H.. [...] në këtë kontratë nga shoqëria jonë, gabimisht është shënuar si çmim shitjeje shuma 5,079,900 lekë, ndërkohë që shuma reale në këtë kontratë duhet të ishte 62,540 euro, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 1.7.2004, pasi kjo vlerë është paguar nga pala porositëse O. H. Marr përsipër të gjitha detyrimet që më takojnë pranë ZVRPP-së Tiranë, që të bëhet i mundur korrigjimi i gabimit të bërë nga ana jonë, pasqyrimi i vlerës reale 62,450 euro të blerjes së apartamentit të përshkruar më lart*”.

Ky deklaram është konfirmuar edhe nga bashkëshorti i subjektit, z. O. H., në cilësinë e blerësit, në po të njëjtën deklaratë noteriale.

4.3 Për sa më lart, Komisioni, për efekt të analizës financiare, ka marrë për bazë çmimin e blerjes së apartamentit me sip. 106.9 m², të dakordësuar mes palëve në kontratën e sipërmarrjes dhe e ka analizuar atë duke e krahasuar me çmimin referues të EKB-së, sipas udhëzimit përkatës të vitit 2004³⁵, i cili përcakton të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve për vitin 2004 për qytetin e Tiranës, çmimin 68,571 lekë/m². Duke llogaritur 106.9 m² x 68,571 lekë/m² = vlera është 8,091,378 lekë, e konvertuar në monedhën euro³⁶ përkon me shumën 65,928 euro, ndërsa vlera e kontratës së sipërmarrjes është 62,540 euro. Konstatohet se nuk ka diferencë të theksuar të çmimit të blerjes së apartamentit krahasuar me çmimin referues të EKB-së (diferenca është 3,388 euro).

4.4 Komisioni ka verifikuar edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi ndërmjet subjektit të rivlerësimit, shoqërisë “****” sh.p.k. dhe administratorit të saj, dhe nga hetimi³⁷ nuk rezultoi një situatë e tillë.

4.5 FSHU-ja³⁸ konfirmon abonentin me emrin O. H., me nr. kontrate ***, në adresën rruga “****”. Gjithashtu, subjekti, me anë të pyetësorit nr. 2, ka depozituar kopjen e kontratës së energjisë elektrike të lidhur me KESH sh.a.

4.6 ASHK Drejtoria Vendore Tirana Jug³⁹ konfirmon të regjistruar në pronësi të shtetasit O. H. apartament me sip. 106.9 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me adresë rruga “****”, shk. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë. Nga dokumentacioni i përcjellë nga ASHK-ja, rezultoi e depozituar kontrata e shitjes e datës 16.5.2013, e cila pasqyron çmimin e shitjes 5,079,900 lekë.

³⁴ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 27.1.2017.

³⁵ Udhëzim nr. 1, datë 4.3.2004 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja për vitin 2004”.

³⁶ Shuma 8,091,378 lekë, e konvertuar në monedhën euro, të llogaritur me kursin ditor të Bankës së Shqipërisë për datën 1.7.2004 (data e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, 1 euro = 122.73 lekë), vlera në lekë përkon me 65,928 euro.

³⁷ Përgjigje nr. *** prot., datë 21.9.2022, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila konfirmon se nuk rezultoi që ndaj shoqërisë “****” sh.p.k. të jenë depozituar kallëzime apo procedime penale në ngarkim të saj, ndërsa për shtetasin G. K. ka pasur dy procedime penale të regjistruara, por që nuk janë hetuar nga subjekti i rivlerësimit. Përgjigje nr. *** prot., datë 19.9.2022, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat, e cila konfirmon se nuk rezultoi që ndaj shoqërisë “****” sh.p.k. dhe z. G. K. të jenë depozituar kallëzime apo procedime penale në ngarkim të tyre.

³⁸ FSHU-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 15.2.2021, drejtuar Komisionit

³⁹ ASHK Tirana Jug, me shkresën nr. *** prot., datë 12.10.2022, drejtuar Komisionit.

Gjithashtu, rezulton mandatpagesa e datës 21.5.2013, lëshuar nga Credins Bank, paguar nga O. H./L. N. shuma 103,843 lekë, me përshkrimin “Taksë shitjeje ***, rep. ***, kol. ****”.

4.7 Komisioni ka administruar përgjigjen e shoqërisë “****” sh.p.k., e datës 6.10.2022, e cila informon se kontratën e sipërmarrjes dhe aktet e tjera që lidhen me këtë kontratë nuk i kanë të ruajtura, pasi kanë kaluar afatet e caktuara me ligj, ndërsa kontratën e shitjes e disponon vetë klienti dhe është depozituar në hipotekë.

4.8 Në lidhje me mospërputhjen në çmimin e blerjes së apartamentit me sip. 106.9 m², pasi kontrata e sipërmarrjes e datës 1.7.2004 pasqyron çmimin 62,540 euro, ndërsa kontrata e shitblerjes e datës 16.5.2013 pasqyron çmimin 5,079,900 lekë, subjekti e ka justifikuar këtë “si gabim”, duke bashkëlidhur deklaratën noteriale nr. ***, datë 27.1.2017, të ndërtuesit “****”, ku ai deklaroi se vlera e përcaktuar në kontratën e shitjes është gabim i shoqërisë dhe se e vërteta është që detyrimet janë shlyer në përputhje me kontratën e sipërmarrjes, në vlerën 62,540 euro. Subjekti ka shpjeguar se taksë e kalimit të pronësisë prej 103,693 lekësh është paguar nga bashkëshorti, duke menduar që kjo është shuma që i korrespondon vlerës së apartamentit të paguar sipas kontratës së sipërmarrjes. Në deklaratën noteriale ndërtuesi merr përsipër detyrimet që i takojnë ZVRPP-së, me qëllim korrigjimin e këtij gabimi.

4.9 Komisioni ka konstatuar se ka deklarime kontradiktore të bashkëshortit të subjektit, z. O. H., në lidhje me mospërputhjen e çmimit të apartamentit me 62,540 euro, sipas kontratës së sipërmarrjes dhe 5,079,900 lekë sipas kontratës së shitjes. Bashkëshorti O. H. deklaroi se me datë 27.1.2017, pas 4 vitesh është vënë në dijeni të faktit se çmimi i pasqyruar në kontratën e shitjes është vendosur gabim, në një kohë që vetë ai ka qenë palë e kësaj kontrate dhe e ka nënshkruar me atë çmim në vitin 2013.

4.10 Komisioni ka analizuar burimin e krijimit të apartamentit me sip. 118 m²

a) Burimi I – të ardhurat nga puna gjatë viteve 1997 – 2004, në emigracion, Itali

4.10.1 Komisioni i ka analizuar të ardhurat e përfituara nga emigracioni në Itali në vitet 1997 – 2004, në pikat 1.8-1.12 të vendimit, ku në përfundim rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshorti O. H., nuk kanë provuar me dokumentacion ligjor të ardhurat e realizuara në emigracion, në përputhje me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 86/2014, për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme dhe, si rrjedhojë, nuk mund të kenë shërbyer si burim i ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie.

b) Burimi II – kredi bankare në BKT, në shumën 16,000 euro

4.10.2 Kredia bankare është deklaruar nga subjekti në DPDFD-në e vitit 2008 si kredi për blerje apartamenti në BKT, me datë 23.4.2007, në shumën 16,000 euro, me afat 10-vjeçar.

4.10.3 Së bashku me deklaratën *Vetting* subjekti ka depozituar kontratën e kredisë bankare, datë 23.4.2007⁴⁰, me kredihënës BKT dhe kredimarrës O. H., dorëzanëse Miranda Bushi, për marrjen

⁴⁰ Kontratë kredie bankare nr. ***, datë 23.4.2007.

e kredisë në shumën 16,000 euro, me anë të së cilës do të përdoret për rregullim apartamenti, sipas kushteve të kontratës dhe kredia do të akordohet për një afat 120 muaj.

4.10.4 Subjekti ka depozituar edhe kontratën e hipotekimit datë 23.4.2007⁴¹, me hipotekues O. H. dhe Miranda Bushi, me kreditor BKT, ku objekt kontrate është vënë pasuria e paluajtshme truall me sip. 1214 m² dhe ndërtesë shërbimi një dhe dykatëshe, me oborr me sipërfaqe ndërtese 390 m², e ndodhur në adresën lagjja “****”, Mat, ***.

4.10.5 Komisioni ka konstatuar se ka mospërputhje në lidhje me destinacionin e përdorimit të kredisë, pasi në DPFD-në e vitit 2008 dhe në atë *Vetting* subjekti ka deklaruar se kredia është përdorur si burim për blerjen e apartamentit në rrugën “****”, ndërsa në kontratën e kredisë bankare rezulton se kredia është marrë për rregullim apartamenti. Në lidhje me këtë mospërputhje, subjekti ka shpjeguar se kredia në BKT është marrë për blerje shtëpie dhe punimet në banesë janë kryer të gjitha nga shoqëria ndërtuese.

4.10.6 Rezulton se nga dokumentacioni bankar⁴², kredia është disbursuar në datën 27.4.2007 dhe është tërhequr *cash* në shumën 15,503 euro, në po të njëjtën ditë, si dhe duket se kredia e marrë në BKT, në datën 27.4.2007, është përdorur për blerjen e apartamentit.

4.10.7 Nga hetimi administrativ i kësaj pasurie, Komisioni ka konstatuar se:

- i) Ka dyshime për veprime fiktive të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj në pasqyrimin e një çmimi shitjeje më të ulët në kontratën e shitjes (në vlerën 5,079,900 lekë të vitit 2013), në krahasim me çmimin e pasqyruar në kontratën e sipërmarrjes (në vlerën 62,540 euro të vitit 2004), me qëllim pagimin e tatimit me vlerë më të ulët.
- ii) Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë provuar me dokumentacion ligjor të ardhurat nga emigracioni për periudhën 1997 – 2004.
- iii) Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë mungesë burimesh financiare të ligjshme për të krijuar këtë pasuri (62,540 euro – 16,000 euro kredi) në shumën 46,540 euro.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

4.10.8 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj në lidhje me mospërputhjen e çmimit të apartamentit, i ndryshëm në kontratën e sipërmarrjes që pasqyron çmimin 62,540 euro dhe në atë të shitjes që pasqyron çmimin 5,079,900 euro, ka shpjeguar ndër të tjera se është një “gabim material”, duke i qëndruar të njëjtave shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit.

4.10.9 Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se taksa e kalimit të pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, paguhet nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme para kryerjes së regjistrimit, në

⁴¹ Kontratë hipotekimi nr. ****, datë 23.4.2007.

⁴² Përgjigje e BKT-së nr. **** prot., datë 19.2.2021, drejtuar Komisionit.

përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe se ky nuk ka qenë një detyrim që duhej paguar nga ana e bashkëshortit.

4.10.10 Subjekti, në lidhje me burimin e krijimit të apartamentit, që janë të ardhurat nga puna gjatë viteve 1997 – 2004, në emigracion, Itali, të cilat janë analizuar më sipër dhe bazuar në analizën e kryer, ka kërkuar që ato të konsiderohen të ligjshme.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

4.11 Në lidhje me mospërputhjen e çmimit të blerjes së apartamentit, që pasqyrohet në vlerën 62,540 euro, i ndryshëm nga ai në kontratën e shitblerjes që pasqyrohet në vlerën 5,079,900 euro, Komisioni, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se në rastin konkret detyrimin për pagesën e taksës së kalimit të pronësisë e ka subjekti ndërtues/investitori dhe jo porositësi/blerësi, e konsideron këtë mospërputhje si një pasaktësi me një peshë minimale, e cila nuk vlerësohet se arrin deri në atë nivel saqë ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, bazuar në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

4.11.1 Sa më sipër, Komisioni ka pasqyruar në analizën financiare vlerën reale të blerjes së apartamentit me sip. 106.9 m², prej 62,540 euro.

4.11.2 Në lidhje me burimin e krijimit të këtij apartamenti, që janë të ardhurat nga emigracioni, të ardhura që pretendohen nga subjekti si të ligjshme, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë provuar me dokumentacion ligjor këto të ardhura, me qëllim për t'u konsideruar si të ligjshme dhe për t'i përfshirë ato në analizën financiare.

Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni arrin në përfundimin se:

- Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e apartamentit në Tiranë, duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
- Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj rezultojnë me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 46,540 euro (62,540 euro – 16,000 euro kredi), për krijimin e kësaj pasurie.

5. Lokal tregtie me sipërfaqe ndërtimi 390 m² dhe sipërfaqe totale trualli⁴³ 1214 m², i ndodhur në ***, në emër të shtetasit O. H.. Ky objekt është blerë në ankand nga asetet e firmës piramidale “***”, sipas kontratës nr. ***, datë 19.9.2001. Vlera: 7,300,000 lekë. Burimi i krijimit: (a) të ardhurat nga puna e bashkëshortit dhe subjektit gjatë viteve 1986 – 1997; (b) të ardhurat gjatë viteve në emigracion në Itali.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

5.1 Në kohën e plotësimit të DPDFD-së së vitit 2008, kur subjekti ka qenë me detyrë drejtoreshë kabinetit në Prokurorinë e Përgjithshme, ka deklaruar pasurinë si më sipër, të blerë nga bashkëshorti në vlerën 7,500,000 lekë, por nuk është deklaruar burimi i krijimit të kësaj shume. Në po këtë

⁴³ Z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***.

deklaratë, bashkëshorti i subjektit e ka deklaruar këtë pasuri me pjesë takuese 100%, me burim krijimi të ardhura nga emigracioni në Itali për periudhën 1997 – 2003.

5.2 Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti bashkë me deklaratën *Vetting*, ka rezultuar se objekti bar-restorant “****” është përfituar me kontratën e shitblerjes datë 19.9.2001⁴⁴, të lidhur ndërmjet shoqërisë “****” (në administrim) dhe blerës O. H., i ndërtuar në truallin me sip. 1200 m², sipërfaqe ndërtimore 634 m², me adresë lagjja “****”, *** me çmimin 7,300,000 lekë, likuiduar totalisht sipas mandateve bashkëlidhur kësaj kontrate⁴⁵.

5.3 Me regjistrimin e kësaj kontrate në ZVRPP, është lëshuar edhe certifikata për vërtetim pronësie, datë 15.5.2007, për pasurinë e llojit truall me sipërfaqe totale 1214 m², nga të cilat ndërtesë me sipërfaqe 390 m², në z. k. ****, nr. pasurie ****, vol. ****, f. ****, me adresë lagjja “****”, Mat, ****, në pronësi të shtetasit O. H..

5.4 ASHK Mat⁴⁶ konfirmon të regjistruar në emër të shtetasit O. H. pasurinë me të dhënat si më sipër. Gjithashtu është depozituar dokumentacioni përkatës, i cili është i njëjtë me atë të depozituar nga subjekti me deklaratën *Vetting*, referuar si më lart.

5.5 FSHU-ja⁴⁷ konfirmon kontratën në emër të shtetasit O. H. në instancën ***.

Po kështu, Ujësjellës Kanalizime Mat (në vijim UKM)⁴⁸ konfirmon kontratë të lidhur me shtetasin O. M. H., në adresën lagjja “****”, e kategorisë “privat”, hapur me datë 1.4.2016.

5.6 Komisioni ka konstatuar se ka mospërputhje të çmimit të blerjes së pasurisë, pasi në DPDFD-në e vitit 2008 është deklaruar vlera 7,500,000 lekë, ndërsa në deklaratën *Vetting* është deklaruar vlera 7,300,000 lekë. Subjekti i rivlerësimit, në pyetësorin nr. 2, ka shpjeguar se në DPDFD-në e vitit 2008 ka deklaruar vlerën e blerjes, rreth 7,500,000 lekë. Në momentin e deklaratës *Vetting*, subjekti ka mundur të sigurojë dokumentin përkatës (kontratën e shitblerjes) dhe ka konstatuar se vlera e saktë e blerjes së kësaj pasurie është 7,300,000 lekë.

5.6.1 Komisioni ka konstatuar gjithashtu se ka mospërputhje deklarimi të burimit të krijimit të shumës 7,300,000 lekë, pasi në DPDFD-në e vitit 2008 bashkëshorti O. H. deklaroi si burim të ardhura nga emigracioni në Itali për periudhën 1997 – 2003, ndërkohë në deklaratën *Vetting* ai ka deklaruar si burim të ardhurat nga puna e tij dhe e bashkëshortes gjatë viteve 1986 – 1997, si dhe të ardhurat nga emigracioni Itali. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në DPDFD-në e vitit 2008 janë deklaruar të ardhurat nga emigracioni në Itali, për faktin se shumica e të ardhurave për këtë shumë ka qenë nga emigracioni. Në deklaratën *Vetting* subjekti është përpjekur të jetë më e detajuar dhe të përfshijë të gjitha burimet që mund të kenë ndikuar në blerjen e kësaj pasurie. Për shkak të mungesës së mbajtjes së evidencave apo llogarive, subjekti nuk mundet të përcaktojë

⁴⁴ Kontratë shitblerjeje pasurie e paluajtshme me nr. ****, datë 19.9.2001.

⁴⁵ Mandat nr. ****, datë 28.3.2001, për 1,500,000 lekë, tek Banka e Kursimeve B.; nr. ****, datë 5.4.2001, për 4,100,000 lekë, tek Banka e Kursimeve B.; nr. ****, nr. llogarie ****, datë 10.4.2001, për 1,400,000 lekë, Banka e Kursimeve Tiranë; nr. ****, nr. llogarie ****, datë 10.4.2001, për 300,000 lekë, Banka e Kursimeve Tiranë.

⁴⁶ Shkresë nr. **** prot., datë 10.10.2022 e ASHK Mat, drejtuar Komisionit.

⁴⁷ Përgjigje nr. **** prot., datë 15.2.2021, e FSHU-së, drejtuar Komisionit.

⁴⁸ Përgjigje nr. **** prot., datë 16.9.2022, e UKM-së drejtuar Komisionit.

saktësisht nga shuma totale sa janë nga emigracioni dhe sa janë nga të ardhurat për periudhën 1986 – 1997.

5.7 Analizë e burimit të krijimit të shumës 7,300,000 lekë

5.7.1 Të ardhurat nga puna e shtetasit O. H. dhe bashkëshortes gjatë viteve 1986 – 1997

Komisioni, referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, ka analizuar të ardhurat nga punësimi për periudhën 1986 – 1997. Sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 7.11.2016, të Zyrës Arsimore Mat, ka informacion për vendet e punësimit të bashkëshortit të subjektit për periudhat 28.8.1986 – 31.12.1991 dhe 16.5.1993 – 31.12.1993 (1.9.1988 – 31.8.1989 kryer studime pasuniversitare), por mungojnë të dhënat në lidhje me shumat e përfituara. Pavarësisht mungesës së informacionit, kursimet e mundshme të kësaj periudhe janë në një vlerë të pakonsiderueshme, për shkak të nivelit të ulët të pagave të asaj periudhe. Në kushtet e mungesës së një informacioni për të ardhurat për periudhat 28.8.1986 – 31.12.1991 dhe 16.5.1993 – 31.12.1993, nuk janë marrë në konsideratë në përlllogaritje as shpenzimet jetike për këtë periudhë.

Komisioni ka llogaritur të ardhurat e subjektit si prokurore në B. për periudhën dhjetor 1992 – 1997, në shumën 915,566 lekë, të ardhurat nga paga si mësues i shtetasit O. H. për periudhën 1992 – 1997, në shumën 325,237 lekë = në total 1,240,803 lekë. Janë llogaritur shpenzimet në shumën 818,930 lekë dhe mundësia për kursime e subjektit dhe bashkëshortit për periudhën 1992 – 1997 ka rezultuar të jetë në shumën 421,873 lekë.

5.7.2 Të ardhurat gjatë viteve në emigracion në Itali

Këto të ardhura janë trajtuar më lart në vendim, në pikat 1.8-1.12, ku në përfundim nuk u provuan nga subjekti i rivlerësimit me dokumentacion ligjor.

5.7.3 Referuar dokumentacionit të disponuar nga Komisioni, si dhe deklarimeve të subjektit, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1992 – prill 2001, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit për blerjen e njësisë së shërbimit në vitin 2001, si dhe kryerjen e shpenzimeve për këtë periudhë, paraqitur në tabelën si vijon:

Tabela nr. 3

| Nr. | Përshkrimi | Vlera |
|-----|--|--------------------|
| 1 | Të ardhura nga puna si prokurore në Prokurorinë Mat (12.1992 – 1997) | 915,566 |
| 2 | Të ardhura nga paga si mësues, Mat, 1992 – 1997 | 325,237 |
| 3 | Të ardhura nga emigracioni, 1998 – prill 2001 | 103,981 |
| | Totali i të ardhurave | 1,240,803 |
| 1 | Shpenzime jetike 1992 – 1997 | 818,930 |
| 2 | Shpenzime jetike Itali, 1998 – prill 2001 | 3,814,582 |
| | Totali i shpenzimeve | 4,633,513 |
| 1 | Njësi shërbimi 390 m ² , blerë më (mars – prill 2001) | 7,300,000 |
| | Totali i pasurive | 7,300,000 |
| | Mundësia për blerjen e njësisë 7,300,000 lekë | -10,692,709 |

5.8 Komisioni, gjatë hetimit administrativ të kësaj pasurie, ka konstatuar se:

- i) Ka mospërputhje deklarimi në lidhje me: (a) vlerën e blerjes së lokalit, deklaruar në deklaratën *Vetting* në vlerën 7,300,000 lekë, ndërsa në DPFD-në e vitit 2008 deklaruar në vlerën 7,500,000 lekë; (b) burimin e krijimit të kësaj pasurie, deklaruar në deklaratën *Vetting*, të ardhurat nga puna e bashkëshortit dhe subjektit gjatë viteve 1986 – 1997, si dhe të ardhurat gjatë viteve në emigracion në Itali, ndërsa në DPFD-në e vitit 2008 subjekti ka deklaruar vetëm të ardhura nga emigracioni.
- ii) Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e pasurisë bar-restorant “****”, në shumën 7,300,000 lekë.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

5.9 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij ka shpjeguar se mospërputhja në deklarimin e çmimit të blerjes është vetëm një lapsus, jo i qëllimshëm.

5.9.1 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, ato janë kryesisht të ardhurat nga emigracioni.

5.9.2 Nga analiza e pasqyruar në tabelën nr. 2 të prapësimeve (tabela e cila përfshin periudhën 16.1.2008 – 31.12.2008, ku subjekti ka rezultuar me balancë pozitive), rezulton se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie, së bashku me pasuritë e tjera të deklaruar në DIPP-në përpara fillimit të detyrës. Edhe nga të dhënat që rezultojnë nga provat bashkëlidhur prapësimeve, tregojnë se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë dërguar në Shqipëri kursimet e tyre përpara momentit të blerjes së kësaj pasurie.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

5.10 Komisioni vëren se mospërputhja në deklarim për çmimin e blerjes konsiderohet si pasaktësi në deklarim, me peshë minimale, pa ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore.

Për burimin e krijimit të kësaj pasurie, ku sipas analizës financiare përfshihet periudha 1992 – prill 2001, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë rezultuar me pamundësi financiare në shumën -10,692,709 lekë. Komisioni ka analizuar thellësisht, ashtu si edhe pasuritë e tjera, burimin e krijimit në analizën gjithëpërfshirëse të viteve 1992 – 2016.

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj ndodhen në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e lokalit në **, duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.**

6. Automjet tip “Golf 4”, me targë *, blerë në datën 18.11.2008⁴⁹, në vlerën 8,000 euro, me pjesë takuese 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat e akumuluar ndër vite.**

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

6.1 Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar *blerje automjeti tip “Golf 4”, me targë ***, me vlerë 8,000 euro, në emër të bashkëshortit. Burimi i krijimit: pakësuar cash-i.* Po në këtë DIPP subjekti ka deklaruar çregjistrimin e mjetit në organet përkatëse.

6.2 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor⁵⁰ (në vijim DPSHTRR) konfirmon të regjistruar në emër të shtetasit O. H. automjetin tip “Volkswagen Golf 4”, me targë ***, i vitit 1999 (aktualisht ky automjet është çregjistruar). Ky automjet është përfituar nga kontrata shitblerjes datë 18.11.2008, shitur nga shtetasi A. P., me çmimin 8,000 euro. Shitësi A. P. e kishte blerë këtë automjet në shtetin gjerman në datën 6.11.2008, me çmimin 3,400 euro. Nga dokumenti doganor i datës 12.11.2008, rezulton se shtetasi A. P. ka paguar edhe taksën doganore në vlerën 269,805 lekë. Në dokumentacionin e DPSHTRR-së rezulton edhe vërtetimi i datës 1.11.2018, që konfirmon se ky automjet është nxjerrë përfundimisht nga qarkullimi në datën 1.11.2018, me kërkesë të shtetasit O. H.

6.3 Komisioni ka verifikuar edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit A. P. dhe nga hetimi⁵¹ nuk rezultoi një situatë e tillë.

6.4 Analizë e burimit të krijimit të automjetit “me të ardhurat e krijuara ndër vite”

6.4.1 Referuar deklaramëve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, se si burim krijimi për blerjen e automjetit kanë shërbyer të ardhurat ndër vite dhe deklarimit në DPDFD-në e vitit 2008, se si burim ka shërbyer gjendja *cash* e deklaruar prej 100,000 euro, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1992 – 16.1.2008, për të evidentuar mundësinë financiare për krijimin e kursimeve të përdorura më pas për blerjen e automjetit në datën 18.11.2008 (përpara fillimit të deklarimit), si dhe kryerjen e shpenzimeve për këtë periudhë.

6.4.2 Sipas analizës financiare, trajtuar në pikën 1.6.5 të vendimit, konstatohet se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur të ardhura ligjshme për të krijuar kursime *cash* dhe, për rrjedhojë, as për të blerë mjetin në datën 18.11.2008, në vlerën 8,000 euro.

Për konstatimin e mësipërm, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

6.5 Subjekti i rivlerësimit në prapësime ka shpjeguar se si burim krijimi për blerjen e automjetit kanë shërbyer të ardhurat ndër vite, si dhe sipas deklarimit në DPDFD-në e vitit 2008 si burim ka

⁴⁹ Blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.11.2008, depozituar nga subjekti bashkë me deklaratën *Vetting*.

⁵⁰ Përgjigje e DPSHTRR nr. ***, datë 16.2.2021 e cila ka të bashkëngjitur përgjigjen e Drejtorisë Rajonale me nr. *** prot., datë 10.2.2021, drejtuar DPSHTRR-së.

⁵¹ Përgjigje nr. *** prot., datë 4.9.2022, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe përgjigje nr. *** prot., datë 19.9.2022, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat, të cilat konfirmojnë se nuk rezultoi që ndaj shtetasit A. P. të jenë depozituar kallëzime apo procedime penale në ngarkim të tij.

shërbyer gjendja *cash* e deklaruar prej 100,000 euro. Nga analiza financiare për periudhën 1992 – 16.1.2008, rezulton se subjekti ka krijuar me të ardhura të ligjshme likuiditetin *cash* në shumën 100,000 euro, pakësimi i të cilit është deklaruar në DIPP. Sipas analizës financiare, subjekti shpjegon se ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e këtij mjete në datën 18.11.2008, në vlerën 8,000 euro.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

6.6 Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjekti që ai ka pasur të ardhura të ligjshme, nuk qëndrojnë. Subjekti rezulton me pamundësi financiare, e cila është shpjeguar në analizën financiare gjithëpërfshirëse të viteve 1992 – 2016.

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj ndodhen në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e automjetit tip “Golf”, në shumën 8,000 euro, duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

7. Automjet tip “Audi Q3”, me targë *, blerë në vitin 2016**, me vlerë totale 38,300 euro, ku janë paguar 23,677 euro, pjesa tjetër detyrim⁵². Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: (a) të ardhurat e akumuluar ndër vite; (b) të ardhurat e dërguara nga vajza K. H., e punësuar në bankën amerikane “***”, Londër.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

7.1 Kjo pasuri është deklaruar si më sipër nga subjekti i rivlerësimit, në DIPP-në e vitit 2016. Së bashku me deklaratën *Vetting* subjekti ka depozituar dokumentacionin e përfitimit të këtij mjete, fillimisht me kontratën e qirasë financiare të datës 21.6.2016, me shoqërinë “***”⁵³, për çmimin 38,300 euro, me parapagim të 61,14% të çmimit të blerjes prej 23,416.62 euro dhe financim të 38.86% të çmimit të blerjes prej 14,883.83 euro, me këst mujor 300 euro, për 60 muaj.

7.2 Pas lidhjes së kontratës me shoqërinë “***”, është lidhur kontrata e shitblerjes datë 22.6.2016⁵⁴ me shoqërinë “***” sh.p.k. Subjekti ka depozituar dokumentin bankar të pagesës së vlerës 23,677 euro, në Raiffeisen Bank, nga shtetasi O. H.⁵⁵, bërë për llogari të shoqërisë “***” dhe mjete është marrë në dorëzim nga ky i fundit në datën 22.6.2016⁵⁶.

7.3 Komisioni ka konstatuar se ka një mospërputhje në lidhje me burimin e krijimit të shumës 22,515 euro (pjesë e shumës 23,677 euro), paguar nga bashkëshorti i subjektit. Rezulton se kur është depozituar *cash* në Raiffeisen Bank shuma 22,515 euro, është vënë përshkrimi “Të ardhura nga emigrimi në T. dhe tërheqje nga depozita në BKT”, ndërsa në deklaratën *Vetting* si burim i

⁵² Pjesa është bërë 61.14% me parapagim *cash* dhe 38.86% detyrim kundrejt shoqërisë “***” për 5 vjet, me këst mujor 300 euro. Këstet paguhen në Raiffeisen Bank.

⁵³ Kontratë qiraje financiare nr. ***, datë 21.6.2016, lidhur ndërmjet shoqërisë “***” sh.p.k., në cilësinë e qiradhënësit dhe shtetasit O. H., për mjetin tip “Audi Q3”, i vitit 2016, me çmim blerjeje 38,300 euro, me këst mujor 300 euro.

⁵⁴ Kontratë shitblerjeje datë 21.6.2016, lidhur ndërmjet shoqërisë “***” sh.p.k. dhe shtetasit O. H.. Objekti i qirasë financiare është automjeti tip “Audi Q3”, i vitit 2016, me çmimin 38,300 euro, i cili do të paguhet sipas faturës përkatëse.

⁵⁵ Dokument datë 21.6.2016, i Raiffeisen Bank, ku shtetasi O. H. ka paguar shumën 23,677 euro në llogari të shoqërisë “***” sh.p.k., për blerje automjeti.

⁵⁶ Akti i dorëzimit të mjetit, datë 22.6.2016, nga shoqëria “***” sh.p.k., në cilësinë e shitësit dhe shoqëria “***” sh.p.k. (O. H.), në cilësinë e blerësit, ku bëhet dorëzimi i automjetit tip “Audi Q3”, me targë ***.

automjetit është deklaruar “Të ardhurat e akumuluar ndër vite, si dhe të ardhurat e dërguara nga vajza”. Subjekti ka shpjeguar ndër të tjera se në deklaratën *Vetting* është deklaruar me hollësi burimi i krijimit, ndërsa në bankë bashkëshorti nuk e ka vlerësuar se duhet të detajonte pranë bankës të gjitha burimet e krijimit të shumës së depozituar *cash*.

7.4 Analiza e burimit të krijimit të shumës 38,300 euro

Të ardhurat e akumuluar ndër vite

7.4.1 Nga veprimet bankare në BKT⁵⁷ rezulton se në llogarinë në euro të shtetasit O. H., në datën 10.6.2016, është kredituar nëpërmjet konvertimit shuma 6,859.2 euro, e cila ka si burim depozitën 950,000 lekë, të krijuar nga bashkëshorti i subjektit në datën 28.12.2015, me burim të deklaruar *depozitë e krijuar nga cash-i i akumuluar ndër vite*.

7.4.2 Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar *pakësimin e gjendjes cash* të akumuluar ndër vite për vitin 2015 = 1,500,000 lekë, për shkak të kalimit në depozitë bankare në BKT, si dhe shpenzime të ndryshme familjare. Komisioni ka marrë në konsideratë edhe të ardhurat e krijuara gjatë vitit 2016, të cilat do të pasqyrohen në analizën për pagesën e kryer në datën 21.6.2016.

7.5 Të ardhurat e dërguara nga vajza K. H., e punësuar në bankën amerikane “*”, Londër**

7.5.1 Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Të ardhura nga puna e vajzës në bankën amerikane në Londër, në shumën 10,471 GBP, nga të cilat 7,471 GBP i ka transferuar në llogarinë e babait të saj O. H. në BKT, në datën 21.4.2016, ndërsa shumën 3,000 GBP e ka sjellë kur ka ardhur vetë me pushime*”.

7.5.2 Në llogarinë në euro në BKT⁵⁸, në emër të bashkëshortit të subjektit, rezulton se në datën 10.6.2016 është kaluar shuma 9,505.88 euro. Si burim i kësaj shume ka shërbyer transferta bankare e datës 21.4.2016, në vlerën 7,471.62 GBP, urdhëruar nga K. H..

7.5.3 Nga verifikimi i lëvizjeve në sistemin TIMS, rezulton se K. H. ka hyrë në territorin shqiptar në datën 26.3.2016 dhe është larguar përsëri në drejtim të Londrës në datën 2.4.2016.

7.5.4 Personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, vajza K. H., në deklaratën *Vetting* ka deklaruar: “*Të ardhura bruto nga puna në bankën amerikane “***” në Londër, për vitin 2015 në shumën 63,000 GBP dhe për vitin 2016 në shumën 55,000 GBP. Nga të ardhurat e realizuara, një shumë prej 10,471 GBP e kam dërguar në familje si ndihmë për blerjen e automjetit “Audi Q3” dhe konkretisht shumën prej 7,471 GBP e kam transferuar në llogarinë e babait tim në BKT në datën 21.4.2016, ndërsa shumën 3,000 GBP e kam sjellë kur kam ardhur vetë*”.

7.5.5 Subjekti ka depozituar bashkë me deklaratën *Vetting* edhe dokumentin bankar të *Bank of****, *** drejtuar K. H., ku pasqyrohet vlera totale e pagës vjetore për vitin 2015 në shumën 63,000 GBP dhe për vitin 2016 në shumën 55,000 GBP.

⁵⁷ Shkresë e BKT-së nr. *** prot., datë 19.2.2021, drejtuar Komisionit

⁵⁸ Shkresë e BKT-së nr. *** prot., datë 19.2.2021, drejtuar Komisionit.

7.5.6 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka depozituar dokumentacionin e lëshuar nga punëdhënësi banka “***”, pjesë e të cilave janë edhe dy formularë P60⁵⁹ për vitet 2015 – 2016, nga ku rezulton se të ardhurat neto nga paga për vitin 2015 janë në shumën 43,593⁶⁰ GBP dhe për vitin 2016 janë në shumën 62,749⁶¹ GBP. Pas zbritjes së shpenzimeve⁶² jetike rezulton se vajza e subjektit të rivlerësimit ka pasur në dispozicion përkatësisht shumat 32,607 GBP për vitin 2015 dhe 51,688 GBP për vitin 2016.

Këto shuma janë të mjaftueshme për të mbuluar kontributin e dhënë nga vajza K. H. në vitin 2016, në shumën 10,741 GBP, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2016 dhe, për këtë arsye, Komisioni i ka përfshirë ato në analizën financiare për blerjen e automjetit.

7.6 Analiza financiare për blerjen e automjetit në datën 21.6.2016

7.6.1 Siç u konstatua edhe më lart, në llogarinë në euro të bashkëshortit të subjektit në BKT, në datën 10.6.2016 u kredituan përkatësisht shumat 6,859 euro (me burim depozitën 950,000 lekë) dhe 9,505 euro (me burim 7,471 GBP të transferuar nga vajza K. H.).

7.6.2 Nga totali i këtyre dy shumave në vlerën 16,365 euro, janë përdorur për mbylljen përfundimtare të kredisë 2,131 euro dhe pjesa tjetër prej 14,215 euro është tërhequr *cash* në datën 14.6.2016. Në po të njëjtën datë bashkëshorti i subjektit ka depozituar në Raiffeisen Bank⁶³ shumën 22,515 euro. Pasi ka depozituar *cash* në datën 21.6.2016 shumën 1,164 euro, duke krijuar në llogari një gjendje prej 23,677 euro, bashkëshorti i subjektit ka transferuar për llogari të shoqërisë “***” të gjithë shumën, që përfshin paradhënien 23,416.62 euro dhe komisionin e disbursimit prej 260,46 euro.

Tabela nr. 4 – Analiza financiare për blerjen e mjetit në datën 21.6.2016

| Nr. | Përshkrimi | Vlera |
|------------|--|------------------|
| 1 | Të ardhura nga vajza 10,741 GBP | 1,692,352 |
| 2 | Të ardhura nga paga e subjektit, 21.6.2016 | 612,523 |
| 3 | Të ardhura nga paga e bashkëshortit, 21.6.2016 | 507,072 |
| | Totali i të ardhurave | 2,811,947 |
| 1 | Shpenzime jetike | 318,823 |
| 2 | Shpenzime udhëtimi | 82,515 |
| 3 | Shpenzime kredie | 432,612 |
| | Totali i shpenzimeve | 833,950 |
| 1 | Ndryshim likuiditeti | -1,293,398 |
| 2 | Pagesë për makinën në datën 21.6.2016 prej 23,677 euro | 3,202,788 |
| | Totali i pasurive | 1,909,390 |
| | Mundësia për pagesën e shumës 23,677 euro | 68,606 |

⁵⁹ Formulari *** i depozituar tregon të ardhurat totale të përfituara nga punëdhënësi në fjalë për qëllim të taksave.

⁶⁰ Të ardhurat bruto për vitin 2015 janë në shumën 54,986 GBP dhe tatimet e paguara janë në shumën 11,393 GBP.

⁶¹ Të ardhurat bruto për vitin 2016 janë në shumën 86,575 GBP dhe tatimet e paguara janë në shumën 23,826 GBP.

⁶² Për shpenzimet jetike, Komisioni iu referua informacionit të marrë në *Office for National Statistics, UK*, në linkun <https://www.ons.gov.uk/peoplepopulationandcommunity/personalandhouseholdfinances/expenditure/datasets/detailedhouseholdexpenditurebyageofhouseholdreferencepersonuktablea11>. Shpenzimet jetike mesatare në javë për 1 person, në grupmoshën nën 30 vjeç, janë përkatësisht në vlerat 221.38 GBP/javë për vitin 2014, 211.26 GBP/javë për vitin 2015 dhe 212.71 GBP/javë për vitin 2016.

⁶³ Shkresë nr. *** prot., datë 17.2.2021, e Raiffeisen Bank, drejtuar Komisionit.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme për të krijuar këtë pasuri, duke e konsideruar pamundësinë financiare prej -68,606 lekësh të papërfillshme.

8. Depozitë në Credins Bank, me gjendje në datën 18.1.2017 në vlerën 5,076,501 lekë, me pjesë takuese 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat e akumuluar ndër vite (depozita është hapur në datën 31.12.2015, në vlerën 5,000,000 lekë, diferenca janë interesat bankarë).

8.1 Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Krijimi i depozitës në Credins Bank = 5,000,000 lekë. Depozitë e krijuar nga konvertimi i depozitës në dollarë, si dhe nga kursimet gjatë vitit 2015”*.

8.2 Analiza e burimit të krijimit të depozitës

8.2.1 Komisioni, me pyetësin nr. 2, i ka kërkuar subjektit që në lidhje me krijimin e depozitës 5,000,000 lekë në Credins Bank të specifikojë depozitën në USD dhe shumën e konvertuar për krijimin e kësaj shume. Subjekti ka shpjeguar se gjatë vitit 2015 është pakësuar depozita ekzistuese në Credins Bank (gjendja e së cilës në datën 1.1.2015 ka qenë 32,212 USD) me shumën 30,205 USD. Kësaj vlere të konvertuar në monedhën lekë i është shtuar edhe një pjesë e gjendjes *cash* të akumuluar ndër vite (i cili është zvogëluar gjatë vitit 2015), duke krijuar depozitën 5,000,000 lekë në Credins Bank.

8.2.2 Nga veprimet bankare në Credins Bank⁶⁴ rezulton se depozita 32,210 USD, e deklaruar në DIPP-në e vitit 2014 nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, është krijuar nga zvogëlimi i depozitës 52,388 USD, të hapur në datën 9.12.2008, me burim gjendjen *cash* prej 100,000 euro, të deklaruar para fillimit të detyrës.

8.2.3 Gjatë vitit 2015 janë kryer tërheqjet e mëposhtme *cash*: (i) në datën 5.1.2015 shuma 16,000 USD; (ii) në datën 26.1.2015 shuma 10,210 USD; (iii) në datën 13.2.2015 shuma 2,000 USD; (iv) në datën 15.7.2015 shuma 2,000 USD. Në total, shuma e tërhequr prej 32,210 USD (ose 4,079,074 lekë⁶⁵) ka si burim krijimi gjendjen *cash* prej 100,000 euro, të deklaruar para fillimit të detyrës.

8.2.4 Pakësimi i depozitës në dollarë, si dhe të ardhurat e vitit 2015 janë të pamjaftueshme për hapjen e depozitës 5,000,000 lekë në datën 30.12.2015 dhe pagesën e shpenzimeve, pasi nga analiza financiare për vitin 2015 rezulton një balancë negative në shumën 188,944 lekë⁶⁶.

8.2.5 Komisioni gjatë hetimit administrativ ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë mungesë burimesh financiare të ligjshme për hapjen e depozitës prej 5,000,000 lekësh në datën 30.12.2015, pasi:

- nuk provoi burimin e ligjshëm të shumës 32,210 USD (nga zvogëlimi i depozitës 52,388 USD të hapur në datën 9.12.2008, me burim gjendjen *cash* prej 100,000 euro, të deklaruar para fillimit të detyrës);

⁶⁴ Shkresë e Credins Bank nr. *** prot., datë 17.3.2021, drejtuar Komisionit.

⁶⁵ 32,210 USD, konvertuar me kursin e këmbimit 126.64 lekë.

⁶⁶ Shihni analizën financiare për periudhën 2003 – 2016.

- të ardhurat e vitit 2015 janë të pamjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve dhe hapjen e depozitës, pasi për vitin 2015 subjekti rezulton me një balancë negative në shumën 188,944 lekë.

Për konstatimin e mësipërm, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

8.3 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në prapësime, ndër të tjera, se gjatë vitit 2015 janë krijuar dy depozita bankare: një në shumën 5,000,000 lekë në Credins Bank dhe tjetra në shumën 950,000 lekë në BKT, në total 5,950,000 lekë. Për krijimin e këtyre depozitave kanë shërbyer të ardhurat si vijon: (i) 30,205 USD tërhequr nga depozita në Credins Bank, konvertuar në 3,825,161 lekë; (ii) 1,500,000 lekë *cash* ekzistues ndër vite; (iii) 871,201 kursime gjatë vitit 2015. Në analizën financiare të përshkruar subjekti ka analizuar se shuma 100,000 euro është krijuar me të ardhura të ligjshme dhe se balanca e vitit 2015 rezulton vetëm në shumën hipotetike prej -106,907 lekësh.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

8.4 Komisioni vëren se në lidhje me shumën 100,000 euro, të pretenduar të krijuar me të ardhura të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e depozitës në USD, ka analizuar shumën prej 100,000 euro *cash*, më lart në këtë vendim, nga ku ka rezultuar se nuk është krijuar me burime të ligjshme.

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj ndodhen në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e depozitës në Credins Bank, duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

9. Ortak me pjesëmarrje 25% në shoqërinë “**” sh.p.k., me NIPT ***, me kapital 100,000 lekë.** Kjo shoqëri nuk ka krijuar asnjëherë aktivitet, vetëm është regjistruar në QKR.

9.1 Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti, në pozicionin e drejtores së kabinetit në Prokurorinë e Përgjithshme, ka deklaruar që bashkëshorti me 3 ortakë të tjerë kanë themeluar shoqërinë “****” sh.p.k., e regjistruar në QKR, por e paregjistruar në tatime dhe aktiviteti nuk ka filluar ende.

9.2 Qendra Kombëtare e Biznesit (në vijim QKB)⁶⁷ konfirmon shoqërinë “****” sh.p.k., regjistruar në datën 3.11.2008, me administrator O. H. dhe ortakë O. H., G. M., A. H. dhe Sh. K., me nga 25% pjesë kapitali secili.

9.3 Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë⁶⁸ (në vijim DRT) konfirmon se shtetasi O. H. është administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***, kaluar në status pasiv në datën 30.7.2014. Nga verifikimi në sistemin C@TS rezulton se subjekti nuk ka deklaruar të ardhura për periudhën 2008 – 2014. Deri në datën 23.2.2021 ky subjekt ka detyrime të papaguara pranë organit tatimor, në shumën 35,000 lekë. Nga verifikimi në sistemin C@TS, subjekti nuk ka deklaruar dhe paguar

⁶⁷ Përgjigje nr. *** prot., datë 11.2.2021, e QKB-së drejtuar Komisionit.

⁶⁸ DRT Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 25.2.2021, drejtuar Komisionit.

kontribute për sigurimet shoqërore/shëndetësore dhe TAP për periudhën 2008 – 2014, si dhe për këtë periudhë nuk rezultojnë që subjekti të ketë deklaruar dhe paguar tatim në burim.

Nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë deklaram.

10. Të ardhura nga biznesi i vogël bar-restorant, për periudhën 2002 – fund 2004, në shumën 2,400,000 lekë, sipas certifikatës së regjistrimit në organin tatimor, me kod fiskal *.**

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

10.1 Në DPDFD-në e vitit 2008, kur subjekti ka qenë me detyrë drejtoreshë kabinetit në Prokurorinë e Përgjithshme, deklaroi: *“Të ardhura nga lokali në qytetin e *** deri në dhjetor 2007, në vlerën 24 milionë lekë”*.

10.2 Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti bashkë me deklaratën *Vetting*, ka rezultuar se DRT Dibër⁶⁹ nuk konfirmon shtetasin O. H. të regjistruar për ushtrim aktiviteti privat pranë kësaj drejtorie. Sipas certifikatës së regjistrimit të biznesit në rrethin Mat, rezultoi se shtetasi O. H. është i regjistruar në aktivitetin bar-restorant, me kod fiskal *** (për periudhën 1.1.2002 – 31.12.2002), me vendimin e gjykatës nr. ***, datë 1.10.2001. Po kështu, DRSSH Dibër konfirmon se shtetasi O. H. ka paguar detyrimet e sigurimeve shoqërore për vitet 2001 dhe 2003. Një shkresë e Bashkisë ***, e vitit 2003, konfirmon se shtetasi O. H. njoftohet për shlyerje detyrimesh tatimore për biznesin bar-restorant, në shumën 28,800 lekë për vitin 2003 dhe për shumën 31,800 lekë për vitin 2004. Tabelat e llogaritjes për taksën vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për vitet 2003 – 2004, janë me qarkullim të deklaruar, përkatësisht në shumën 2,500,000 lekë dhe 1,875,000 lekë.

10.3 Subjekti ka depozituar gjithashtu mandatpagesat e bëra në Bankën e Kursimeve nga shtetasi O. H., për degën e tatimeve për Taksën Vendore mbi Biznesin e Vogël dhe Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin, si dhe pagesa për sigurimet shoqërore për biznesin e vogël, për periudhën 2002 – 2004⁷⁰.

10.4 QKB-ja⁷¹ konfirmon shtetasin O. M. H., të regjistruar si person fizik me vendimin nr. ***, datë 1.10.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për veprimtarinë private “bar-restorant”, për të cilin nuk mund të identifikohet pajisja me NUIS. Ndërsa, DRT Dibër⁷² nuk konfirmon të regjistruar si tatimpagues shtetasin O. H..

10.5 I pyetur në ILDKPKI në vitin 2009⁷³, për të ardhurat e përfituara nga lokali, personi i lidhur me subjektin, bashkëshorti O. H., ndër të tjera, ka shpjeguar se të ardhurat e përfituara në dhjetor të vitit 2007 janë 2,400,000 lekë. Si burim kjo shumë kishte 1,000,000 lekë neto nga veprimtaria që ai ka drejtuar vetë biznesin deri më 31.3.2004 dhe shumën 1,400,000 lekë neto të ardhura nga marrëdhënia e biznesit me shtetasin H. B., për periudhën 2005 – 2007.

⁶⁹ DRT Dibër, me shkresën nr. *** prot., datë 11.1.2017, depozituar nga subjekti bashkë me deklaratën *Vetting*.

⁷⁰ Shihni dokumentacionin e depozituar nga subjekti në ILDKPKI, së bashku me deklaratën *Vetting*.

⁷¹ QKB-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 11.2.2021, drejtuar Komisionit.

⁷² DRT Dibër, me shkresën nr. *** prot., datë 17.2.2021, e cila është bashkëngjitur tek përgjigjja e DPT-së me nr.***, datë 10.2.2021, drejtuar Komisionit.

⁷³ Sipas procesverbalit të datës 14.9.2009, i përcjellë nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2021.

10.6 Komisioni, për mospërputhjet në deklaram nga bashkëshorti i saj për të ardhurat e përfituara nga lokali (ku në deklaratën *Vetting* ka deklaruar vlerën 2,400,000 lekë, për vitet 2002 – 2004 dhe në ILDKPKI ka deklaruar 1,000,000 lekë për vitet 2002 – 2004 dhe 1,400,000 lekë për vitet 2005 – 2007 nga shtetasi H. B.), i kërkoi subjektit shpjegime me pyetësin nr. 2. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se deklarimi i bërë nga bashkëshorti në deklaratën *Vetting*, lidhur me të ardhurat për periudhën 2002 – fund 2004, është lapsus. Në vitet 2002 – 2004 kanë përfituar rreth 1,000,000 lekë dhe në vitet 2005 – 2007 kanë përfituar rreth 1,400,000 lekë. Këto të ardhura janë saktësuar në deklaramin e dhënë në ILDKPKI në vitin 2009.

10.7 Komisioni, referuar deklarameve të subjektit të rivlerësimit, përgjigjes së DRT-së Dibër dhe dokumentacionit të pagesave të depozituara prej saj në deklaratën *Vetting*, lidhur me shlyerjen e detyrimeve për Taksën Vendore mbi Biznesin e Vogël, Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin, taksat vendore dhe kontributin për sigurimet shoqërore, arriti në përfundimin se subjekti arriti të provojë ushtrimin e aktivitetit nga bashkëshorti për periudhën 2002 – 2004. Në dokumentacionin e depozituar konfirmohet qarkullimi i deklaruar mbi të cilin është përlllogaritur tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, ku qarkullimi për vitet 2003 – 2004 është në vlerën 4,375,000 lekë.

10.7.1 Komisioni vëren se fitimi i deklaruar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në shumën 1,000,000 lekë, për periudhën 2002 – 2004, është një fitim i mundshëm, po të merren në konsideratë vlerat e qarkullimit të deklaruara dhe tatimi i thjeshtuar i llogaritur mbi këto vlera, si dhe kategorinë e industrisë (bar-restorante), ku ka zhvilluar aktivitetin biznesi i drejtuar nga bashkëshorti i subjektit. Këto të ardhura janë përfshirë nga Komisioni në analizën financiare.

10.8 Të ardhurat nga dhënia në përdorim e lokalit shtetasit H. B.

10.8.1 Në DIPP-në e vitit 2008, bashkëshorti i subjektit O. H. ka deklaruar se nga data 31.12.2007 lokali në *** i është dhënë në përdorim vëllait të bashkëshortes, shtetasit H. B., i cili u paguan 100,000 lekë/muaj, shumë që i shtohet gjendjes *cash* të deklaruar dhe vlera totale në vitin 2008 është 1,200,000 lekë. Ndërsa, në DIPP-të e viteve 2009 – 2012, subjekti ka deklaruar të ardhura nga lokali në ***, i lënë në përdorim vëllait, në shumën 1,200,000 lekë.

10.8.2 Së bashku me deklaratën *Vetting* subjekti ka depozituar dokumentacionin në lidhje me aktivitetin privat të shtetasit H. B.⁷⁴, nga ku rezulton se nga DRT-ja Dibër konfirmohet i regjistruar personi fizik “H. B.”, me NIPT ***, me aktivitet në fushën e restoranteve.

10.8.3 Me deklaratën noteriale të datës 14.11.2012⁷⁵, shtetasi H. B., ndër të tjera, ka deklaruar se lokalin e shtetasit O. H. e ka në përdorim që nga data 22.5.2005, duke u dhënë atyre *cash* shumën 4,800,000 lekë, për vitet 2008 – 2011, ku për çdo vit shuma ka qenë 1,200,000 lekë.

10.8.4 Në ILDKPKI⁷⁶, kur subjekti dhe bashkëshorti i saj O. H., me procesverbalin e datës 14.9.2009, janë pyetur për të ardhurat e përfituara nga lokali në B., në shumën 2,400,000 lekë deri në dhjetor të vitit 2007, ky i fundit ka deklaruar se nga veprimtaria që ka drejtuar vetë biznesin

⁷⁴ Përgjigje nr.*** prot., datë 11.1.2017, e DRT-së Dibër, ku konfirmohet se për shtetasin H. B., me NIPT ***, me aktivitet në fushën e restoranteve, me adresë lagjja “****”, B., rezulton se ka detyrime (gjoha dhe kamatëvonesa, në shumën 754,730 lekë); deklaratë noteriale nr. ***, datë 14.11.2012, e shtetasit H. B.

⁷⁵ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 14.11.2012 depozituar nga subjekti në ILDKPKI.

⁷⁶ Dokumentacioni i përcjellë nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2021.

deri më 31.3.2004, ka përfituar rreth 1,000,000 lekë neto/muaj, ndërsa të ardhurat e përfituara nga shtetasi H. B. nga marrëdhënie të biznesit, për periudhën 2005 – 2007, janë rreth 1,400,000 neto.

10.8.5 I pyetur me procesverbalin e datës 14.9.2009 nëse subjekti ka kontratë qiraje me vëllain e saj për ushtrimin e aktivitetit në lokalin e tyre në ***, në përgjigje ajo ka deklaruar se nuk ka asnjë akt të shkruar, meqenëse personi është vëllai i saj H. B.. Ndërsa, me procesverbalin e datës 9.10.2009, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale datë 28.9.2009⁷⁷, ku shtetasi H. B., ndër të tjera, ka deklaruar se nga aktiviteti që ushtron në lokalin e marrë në përdorim i ka dhënë motrës së tij Miranda Bushi shumën 1,400,000 lekë *cash*, për periudhën 2005 – 2007.

10.8.6 Në lidhje me mospërputhjet në deklarambi të ardhurat e përfituara nga lokali, pasi në DIPP-të e viteve 2008 – 2012 subjekti ka deklaruar të ardhura nga përdorimi i lokalit në shumën 1,200,000 lekë, ndërsa në pyetësin standard ka deklaruar se nga fillimi i detyrës, qershor 2012 dhe deri më sot kanë përfituar 700,000 lekë të ardhura nga lënia në përdorim e lokalit vëllait H. B.. Subjekti ka shpjeguar se vlera 700,000 lekë i korrespondon të ardhurave të marra për periudhën 7-mujore, qershor – dhjetor 2012, vlerë e cila është deklaruar edhe në deklaratën e pasurisë për vitin 2012.

10.8.7 Së bashku me pyetësin nr. 2 subjekti ka depozituar kontratën për “përdorim lokal”, e datës 30.12.2007⁷⁸, lidhur ndërmjet shtetasit O. H. (dhënësi në përdorim) dhe shtetasit H. B. (marrësi në përdorim), ku lokali në pronësi të shtetasit O. H., i ndodhur në ***, i jepet në përdorim shtetasit H. B., kundrejt shumës 100,000 lekë/muaj, për një periudhë 5-vjeçare, 1.1.2008 – 31.12.2012. Në kontratë përcaktohet se të gjitha detyrimet me shtetin i merr përsipër marrësi në përdorim.

10.9 Komisioni, lidhur me dokumentin noterial “kontratë për përdorim lokal”, i datës 30.12.2007, të depozituar nga subjekti së bashku me pyetësin nr. 2, me anë të postës elektronike⁷⁹ i ka kërkuar noteres S. C. për të vënë në dispozicion të Komisionit dokumentin noterial nr. ***, datë 30.12.2007, si dhe faqen e regjistrimit ku është pasqyruar ky veprim. Nga ana e noteres S. C., me datë 2.2.2023, është dërguar dokumenti noterial nr. ***, datë 30.12.2007, por dokumenti noterial nuk është “kontratë përdorimi lokal”, por “kontratë qiraje lokal”, si dhe faqja e regjistrimit ku pasqyrohet ky veprim.

10.10 Ka rezultuar se dy dokumentet e përpiluara tek e njëjta notere kanë të njëjtin nr. repertori dhe koleksioni, ***, të njëjtën datë, 30.12.2007, por me emërtim dhe përmbajtje të ndryshme. Subjekti ka depozituar kontratën për përdorim lokal nr. ***, datë 30.12.2007, ku afati i kontratës është 5 vjet, duke filluar me datë 1.1.2008 – 31.12.2012. Shuma që do të jepet për përdorimin e lokalit të jetë në masën 100,000 lekë. Ndërkohë që kontrata e dërguar nga noterja është kontratë “qira lokal” nr. ***, datë 30.12.2007, me palë qiradhënëse O. H. dhe qiramarrës H. B., ku afati i kontratës do të jetë 5 vjet, duke filluar me datë 1.1.2008 – 31.12.2012. Qiraja mujore të jetë 120,000 lekë. Likuidimi i qirasë do të bëhet çdo fillim viti, për të gjithë vitin kalendarik.

⁷⁷ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 28.9.2009, depozituar nga subjekti në ILDKPKI.

⁷⁸ Kontratë për përdorim lokal nr. ***, datë 30.12.2007.

⁷⁹ Korrespondenca është kryer në datën 31.1.2023 nëpërmjet adresës së postës elektronike të noteres S. C.

10.11 Komisioni ka administruar përgjigjen e DRT-së Dibër⁸⁰, e cila konfirmon se H. B. është i regjistruar pranë DRT-së Dibër si person fizik, me aktivitet “restorant”, me datë 22.2.2005 dhe vazhdon të jetë me statusin aktiv. Për periudhën 2005 – 2009 rezulton se në sektorin e kontabilitetit ky tatimpagues nuk ka paguar tatim të mbajtur në burim (tatim qiraje) për këtë periudhë dhe për periudhën 2010 – 2012 nuk ka paguar tatim të mbajtur në burim (tatim qiraje), por ka paguar sigurime shëndetësore/shoqërore⁸¹.

10.12 Komisioni ka administruar edhe përgjigjen e DRT-së Tiranë⁸², e cila konfirmon se shtetasi O. H. është regjistruar në sistemin tatimor si individ me përgjegjësinë tatimore “Tatimi mbi të Ardhurat Individuale” dhe ka dorëzuar Deklaratat Individuale Vjetore të të Ardhurave, DIVA, për vitet 2011, 2020 dhe 2021, të ardhurat e deklaruara sipas deklaratave të dorëzuara dhe tatimet e paguara lidhur me këto të ardhura⁸³. Bashkëlidhur përgjigjes janë depozituar:

- i) formularët e deklaramit të të ardhurave për vitet 2011, 2020 dhe 2021;
- ii) njoftim detyrimi tatimor i datës 15.9.2022, ku detyrimi tatimor rezulton 0 (zero) lekë.

10.13 Komisioni i është drejtuar përsëri me shkresë DRT-së Tiranë, për të konfirmuar pagesën e tatimeve sipas DIVA/2011, nëse vlera e tatimit të paguar gjatë vitit 2011 është kryer apo është vetëm mbi baza vetëdeklarimi. Në përgjigje të saj, kjo drejtori⁸⁴, ndër të tjera, ka informuar se: *“[...] edhe vlera 4,240 lekë e tatimit mbi interesat bankare dhe 120,000 lekë e tatimit për të ardhurat e tjera janë tatime të paguara gjatë vitit sipas vetëdeklarimit në DIVA/2011. Sqarojmë se për verifikimin e këtyre deklaramiteve nuk disponojmë të dhëna analitike”*.

10.14 Me pyetësin nr. 3, subjekti i është kërkuar të shpjegojë nëse për ardhurat e përfituara nga lënia në përdorim e lokalit vëllait të saj H. B., për periudhën 2005 – 2012, është paguar tatim në burim prej saj ose bashkëshortit dhe të provojë me dokumentacion pagesat e kryera. Subjekti ka shpjeguar se të ardhurat e përfituara nga lënia në përdorim e lokalit në *** vëllait H. B., për periudhën 2005 – 2012, janë të ardhura të tatuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga ana e personit tatimpagues, personit fizik me NIPT ***.

10.15 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, ka konstatuar se:

- i) Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaramit të pasaktë në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti tregtar, pasi në deklaramitën *Vetting* ka deklaruar se ka përfitur vlerën 2,400,000 lekë për periudhën 2002 – 2004, ndërsa në pyetësin ka deklaruar se për këtë periudhë ka fituar 1,000,000 lekë.
- ii) Subjekti i rivlerësimit të shpjegojë ekzistencën e dy kontratave me të njëjtat ekstremitete (me të njëjtin nr. repertori dhe koleksioni) dhe të njëjtën datë, me emërtime të ndryshme, duke pasqyruar edhe shumën të ndryshme të përfitimit të të ardhurave nga shtetasi H. B., të dyja dokumente të nënshkruara nga bashkëshorti i subjektit dhe vëllai i saj.

⁸⁰ Përgjigje nr. *** prot., datë 28.9.2022 dhe nr. *** prot., datë 22.9.2022, të DRT-së Dibër, drejtuar Komisionit.

⁸¹ Për detaje, shihni përgjigjen e DRT-së Dibër.

⁸² Shkresë nr. *** prot., datë 19.9.2022, drejtuar Komisionit.

⁸³ Për detaje, shihni përgjigjen e DRT-së Tiranë.

⁸⁴ DRT Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2022, drejtuar Komisionit.

iii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar pagesën e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga lënia në përdorim të lokalit për periudhën 2005 – 2012, të padeklaruar në deklaratën *Vetting*.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

10.16 Subjekti i rivlerësimit, në prapësime, ndër të tjera, ka shpjeguar⁸⁵:

Së pari, të ardhurat nga lokali janë të ndara në dy periudha: 1,000,000 lekë gjatë periudhës kur aktiviteti ka qenë i regjistruar në emër të bashkëshortit dhe 1,400,000 lekë në vitet 2005 – 2007, kur aktiviteti është ushtruar nga vëllai i subjektit H. B.. Vlera nga lënia në përdorim të lokalit për vitet 2005 – 2007 është përlllogaritur 1,400,000 lekë ose 50,000 lekë/muaj, më pas u llogarit në vlerën neto 100,000 lekë/muaj deri në fund të vitit 2012 dhe pas këtij viti subjekti ra dakord që i vëllai nuk do të paguajë më vlerë për përdorim. Subjekti thekson se ka saktësuar se vlera 2,400,000 lekë është përfituar në vitet 2002 – 2007.

Në lidhje me bashkëshortin O. H., ashtu siç ka konstatuar edhe Komisioni në vitet 2002 – 2004, ai ka paguar tatime në vlerë të konsiderueshme. Subjekti, gjithashtu, ka referuar ligjin nr. 8842, datë 11.12.2001, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8313, datë 26.3.1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, ku bazuar në tatimin e thjeshtuar mbi fitimin, taksat mbi biznesin e vogël të paguara prej tij arrihet në konkluzionin se në periudhën 2002 – 2007 e ardhura neto në shumën 2,400,000 lekë duhet të përfshihet në analizën financiare sepse në realitet ajo përfaqëson një vlerë minimale të realizuar nga të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit, si dhe nga lënia në përdorim vëllait. Pavarësisht se me të vëllanë nuk ka një kontratë të shkruar për periudhën 2005 – 2007, është fakt i pakundërshtueshëm se aktiviteti në këto vite është ushtruar në këtë lokal nga shtetasi H. B..

Së dyti, sipas subjektit, me sa kujton bashkëshorti i saj, fillimisht kanë nënshkruar një kontratë të cilën noterja e ka titulluar kontratë qiraje, ku vlera e qirasë është përcaktuar në vlerën bruto 120,000 lekë/muaj. Meqenëse vlera që do të përfitonin duhet të ishte në vlerën neto dhe marrëdhënia me të vëllanë kishte specifika, menduan të zëvendësohej kontrata e parë me të dytën, të cilën ata vendosën ta quanin kontratë përdorimi, vlera e së cilës ishte përcaktuar në vlerën neto 100,000 lekë/muaj ose 1,200,000 lekë/vit. Për këtë arsye, në të njëjtën ditë kanë shkruar noterin dhe kanë përpiluar kontratën e dytë që, siç duket, noterin i ka vendosur të njëjtin numër repertori dhe koleksioni dhe në fakt e ardhura e cituar si nga qiraja në kontratën e parë nuk është gjë tjetër vetëm vlera e përdorimit të sendit. Përcaktimi i emërimit të kontratës nga kontratë qiraje në kontratë përdorimi në të vërtetë nuk ka qenë përcaktues, referuar natyrës së marrëdhënies me vëllain në raport me përdorimin e këtij sendi. Elementi që ka interes në këtë rast është fakti që vëllai të ketë paguar detyrimet tatimore që ta bëjë të vlefshme e të ligjshme edhe përfitimin e subjektit në këtë marrëdhënie. Gjithashtu, vlerat e përshkruara në dy kontratat (atë të qirasë apo të përdorimit) ndryshojnë për shkak të faktit se e para përfaqëson vlerën bruto 120,000 lekë/muaj dhe e dyta

⁸⁵ Për detaje, shihni në dosje prapësimet e subjektit.

vlerën neto të qirasë. Pra, vlerës bruto i është zbritur 10% i tatimit mbi të ardhurat nga qiraja + taksat dhe një shumë e vogël që përfaqëson shpenzimet për mirëmbajtjen e sendit. Gjithashtu, për këto dy kontrata subjekti ka paraqitur edhe një akt ekspertimi grafik, ku në konkluzion të tij rezulton të jenë nënshkruar në të njëjtën ditë, përpara së njëjtës notere dhe të dyja konfirmojnë dhënien në përdorim të lokalit në pronësi të bashkëshortit, vëllait të saj H. B., me qëllim përdorimin e lokalit për ushtrimin e aktivitetit privat, sipas objektit të veprimtarisë së tij.

Së treti, në lidhje me pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga qiraja në jurisprudencën e Kolegjit, është konsoliduar qëndrimi se pagesën e tatimit nga qiraja e paguan qiramarrësi kur ai është i regjistruar si person fizik apo juridik, e përcaktuar kjo në ligjin nr. 8438, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar. Lidhur me këtë fakt, subjekti ka referuar edhe praktikën e Kolegjit, duke iu referuar vendimit nr. 14/2021 ku, ndër të tjera, referuar dispozitave të ligjit nr. 8438, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, citohet: *“Referuar parashikimit të nenit 8 të ligjit për tatimin mbi të ardhurat personale, përbën një burim të tatueshëm të ardhurash, ky parashikim nuk mund të interpretohet se detyrimin për të kryer pagesën e tatimit në buxhetin e shtetit, në masën e përcaktuar nga ligji mbi vlerën bruto të qirasë, e ka qiradhënësi, për sa kohë, referuar kuadrit të sipërcituar ligjor, ky përbën një detyrim ligjor të dy shoqërive qiramarrëse në rastin objekt gjykimi, të cilat ligji i ka përcaktuar si agjentë të mbajtjes së tatimit në burim dhe u ka ngarkuar detyrimin ligjor për të llogaritur në mënyrë të saktë masën e detyrimit tatimor dhe mbajtjen e këtij detyrimi në burim, si dhe pagimin e tij në buxhetin e shtetit në afatin e përcaktuar me ligj”*. Në përfundim të shpjegimeve, subjekti shpjegon se për sa u shpjegua më sipër, rezulton se ajo me bashkëshortin e saj kanë përfitur të ardhura të ligjshme, të cilat duhet të përfshihen në analizën financiare të kryer nga Komisioni.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

10.17 Komisioni, pasi mori në analizë shpjegimet e subjektit, si dhe dokumentacionin e përfitur gjatë hetimit administrativ, arsyeton se:

10.17.1 Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga aktiviteti i lokalit në ***, është i paqartë fakti përse subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë bërë deklarin të pasaktë të këtyre të ardhurave në deklaratën *Vetting* (e plotësuar në vitin 2017), kur këtë pasaktësi e kishin shpjeguar më parë në ILDKPKI në vitin 2009.

10.17.2 Komisioni, bazuar në deklarinimet e subjektit, bashkëshortit të saj O. H., si dhe në dokumentacionin e përfitur gjatë hetimit administrativ, ku u provua kryerja e aktivitetit tregtar nga bashkëshorti, pagimi i taksave dhe tatimeve të asaj kohe, ka marrë në konsideratë dhe ka përfshirë në analizën financiare shumën prej 1,000,000 lekësh, si e ardhur e ligjshme e realizuar prej tij në periudhën 2002 – 2004, nga ushtrimi i aktivitetit si person fizik në lokalin e tij në ***.

10.17.3 Në lidhje me ekzistencën e dy kontratave me të njëjtën datë dhe me të njëjtat ekstremite (nr. rep. dhe nr. kol.), por me emërtim të ndryshëm dhe përmbajtje pjesërisht të ndryshme, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme.

Komisioni, pavarësisht të metave në hartimin e këtyre dy akteve, që vlerësohen të meta me karakter formal, si dhe pavarësisht deklarinimit të subjektit në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën

14.9.2009, ku deklaroi se nuk ka një akt të shkruar me të vëllain e saj, mban në konsideratë faktin se vëllai i subjektit të rivlerësimit, si në pozicionin e qiramarrësit, ashtu edhe në atë të marrësit të sendit në përdorim, për sa kohë që ai figuron i regjistruar në organet tatimore nën statusin e personit fizik apo juridik, në bazë të legjislacionit tatimor, mbart detyrimin ligjor për pagesën e tatimit në burim për çdo shumë monetare të paguar nga ai bashkëshortit të subjektit, si në pozicionin e qiramarrësit, ashtu edhe në atë të dhënësit të sendit në përdorim, duke mos afektuar kështu një përgjegjësi tatimore të bashkëshortit të subjektit që, për rrjedhojë, do të vinte në dyshim ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga bashkëshorti si rezultat i kësaj marrëdhënieje. Fakti që të dyja kontratat janë lidhur me kundërshtëpërblym, si dhe duke qenë se subjekti dhe bashkëshorti i saj i kanë deklaruar të ardhurat e përfituara nga kjo marrëdhënie që në DPFN-në e vitit 2008 e deri në DIPP-në e vitit 2012, krijon bindjen se subjekti dhe bashkëshorti i saj jo vetëm nuk kanë ndërmarrë hapa për të shmangur apo fshehur deklarimin e këtyre të ardhurave, përkundrazi, me deklarimin e tyre kanë qenë të ndërgjegjshëm për ekzistencën e një detyrimi tatimor për t'u paguar, i cili në bazë të legjislacionit tatimor duhej të paguhej nga vëllai i subjektit.

Tendenca për një sjellje korrekte ndaj ligjit nga ana e subjektit dhe bashkëshortit të saj, vërehet edhe në faktin se në DIVA-n për vitin 2011, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar të ardhura nga dhënia në përdorim e lokalit, duke u shënuar në këtë deklaram edhe pagesa e detyrimit përkatës tatimor për të gjitha të ardhurat e tatueshme të realizuara nga ana e bashkëshortit të subjektit për vitin 2011.

10.17.4 Në lidhje me pagimin e detyrimeve tatimore për vlerën e përfituar nga përdorimi i lokalit, Komisioni, bazuar në legjislacionin tatimor, dhe konkretisht në pikën 1, shkronja “ë”, neni 33⁸⁶ i ligjit nr. 8438, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar, si dhe në praktikën e konsoliduar të Kolegjit⁸⁷, vlerësoi se për të ardhurat e përfituara nga lënia në përdorim/dhënia me qira e shtetasit H. B., detyrimin për pagimin e tatimit mbi të ardhura e ka pasur personi fizik “H. B.”, duke prezumuar se këto detyrime janë paguar nga ky i fundit dhe për këtë problematikë nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi subjekti i rivlerësimit, aq më tepër që vëllai i subjektit ka qenë i rregullt në pagesën e detyrimeve të tjera tatimore si rezultat i ushtrimit të aktivitetit tregtar nga ana e tij.

Parashikimi ligjor në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, që konsideron të ligjshme ato të ardhura për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, duhet të vlerësohet në raport me përmbushjen e detyrimeve ligjore përkatëse nga secila prej palëve kontraktuese dhe mbi sjelljen e tyre në raport me ligjin.

Në këto rrethana, Komisioni i konsideroi dhe vendosi të përfshijë në analizën financiare shumë prej 1,400,000 lekë, të përfituar nga shtetasi O. H. për periudhën 2005 – 2007, si të ardhura të ligjshme.

⁸⁶ Neni 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat”: “1. Të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislacioni në fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim në masën 15% nga shuma bruto e pagesave të mëposhtme, që lindin nga një burim në Republikën e Shqipërisë; ë) pagesat për qiratë”.

⁸⁷ Vendimi i Kolegjit nr. 6/2022, i subjektit H. K.; vendimi nr. 15/2021, i subjektit K. S. dhe vendimi nr. 14/2021, i subjektit I. B.

Gjithashtu, me të njëjtin arsyetim, Komisioni vendosi të marrë në konsideratë dhe të përfshijë në analizën financiare edhe shumën 1,200,000 lekë/vit, deklaruar nga subjekti si e ardhur e përfituar nga lënia në përdorim e lokalit H. B. në DIPP-të e viteve 2008 – 2012, që në total përbëjnë shumën 6,000,000 lekë.

Komisioni vlerëson se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë të të ardhurave nga lokali për periudhën e përfitimit, në kundërshtim me shkronjën “a” të pikës 5 të ligjit nr. 84/2016, por që nuk vlerësohet se arrin deri në atë nivel saqë ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, bazuar në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me ekzistencën e dy kontratave të së njëjtës datë dhe me të njëjtët nr. repertori dhe nr. koleksioni, por me emërtime të ndryshme, subjekti i rivlerësimit vlerësohet se ka dhënë shpjegime të mjaftueshme.

Në lidhje me pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga përdorimi i lokalit, Komisioni i konsideroi si të ardhura të ligjshme shumën 1,400,000 lekë për periudhën 2005 – 2007 dhe shumën 6,000,000 lekë për periudhën 2008 – 2012, për të cilën vlerësohet se janë paguar detyrimet tatimore, ku sipas legjislacionit tatimor i përkasin qiramarrësit si person fizik.

PERSONI I LIDHUR ME SUBJEKTIN, VAJZA K. H.

11. Të ardhura nga puna në bankën amerikane “**” në Londër, në shumën 63,000 GBP për vitin 2015 dhe 55,000 GBP për vitin 2016**

11.1 Personi i lidhur, vajza K. H., në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar: “*Nga të ardhurat e realizuara, një shumë prej 10,471 GBP e kam dërguar në familje si ndihmë për blerjen e automjetit Audi Q3, konkretisht shumën prej 7,471 GBP e kam transferuar në llogarinë e babait tim në BKT, në datën 21.4.2016, ndërsa shumën 3,000 GBP e kam sjellë kur kam ardhur vetë*”.

11.2 Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “*Të ardhura nga puna e vajzës në Bankën Amerikane në Londër, në shumën 10,471 GBP, nga të cilat 7,471 GBP i ka transferuar në llogarinë e babait të saj O. H. në BKT, në datën 21.4.2016, ndërsa shumën 3,000 GBP e ka sjellë kur ka ardhur vetë me pushime*”.

11.3 Subjekti, së bashku me deklaratën *Vetting*, ka depozituar dokumentin bankar të *Bank of America*, ***, drejtuar K. H., ku pasqyrohet vlera totale e pagës vjetore për vitin 2015, në shumën 63,000 GBP dhe për vitin 2016 në shumën 55,000 GBP.

11.4 Komisioni, me pyetësin nr. 2, i ka kërkuar subjektit të depozitojë dokumentacionin ligjor për të ardhurat neto (pas pagimit të taksave) të përfituara nga vajza K. H. në Angli gjatë viteve të saj të punësimit, si dhe nxjerrje të llogarive bankare (*statement*) të disponuara prej saj në Angli për të gjithë kohën e saj të qëndrimit (studim dhe punësim).

11.4.1 Subjekti, pas kërkesës së Komisionit, ka depozituar dokumentacionin e lëshuar nga punëdhënësi, banka “****”, gjithsej 8 fletë, në bazë të të cilit vërtetohen të ardhurat e vajzës K. H. gjatë periudhës së rivlerësimit⁸⁸.

Tabela nr. 5 – Të dhënat financiare për K. H.

| Periudha | Të ardhurat bruto në pound | Tatim i paguar | Të ardhurat neto në pound | Shpenzimet jetike ⁸⁹ | Mundësia për kursim |
|-----------|----------------------------|----------------|---------------------------|---------------------------------|---------------------|
| 30.6.2014 | 2,071 | -169 | 1,902 | | 1,902 |
| 31.7.2014 | 3,750 | -841 | 2,909 | | 2,909 |
| 31.8.2014 | 3,550 | -883 | 2,666 | | 2,666 |
| viti 2015 | 54,986 | -11,393 | 43,593 | 10,986 | 32,607 |
| viti 2016 | 86,575 | -23,826 | 62,749 | 11,061 | 51,688 |
| | 150,932 | -37,113 | 113,819 | 22,046 | 91,773 |

11.5 Komisioni, referuar deklarimeve në DIPP dhe pyetësor⁹⁰ të subjektit i të rivlerësimit, nuk e ka përfshirë në analizën financiare të subjektit vajzën K. H. për vitet 2015 – 2016, por e ka analizuar atë në mënyrë individuale, nga ku rezulton se ajo ka pasur mundësi të përballojë shpenzimet jetike dhe shpenzimet e shkollimit të paguara në datën 27.1.2015, në vlerën 7,600 GBP, si dhe ka pasur mundësi që në vitin 2016 të financojë familjen e saj me 10,741 GBP. Gjithashtu, rezulton se edhe për vitin 2014, K. H. ka pasur mundësi të dhurojë në familje shumën prej 1,570 euro.

11.6 Me pyetësorin nr. 3 subjektit i është kërkuar të provojë me dokumentacion ligjor provues pagesat e shkollimit të vajzës K. H., shpenzimet e akomodimit (kontrata/marrëveshje qiraje), si dhe të depozitojë llogaritë bankare të vajzës në Angli (ku janë bërë pagesat e shkollimit, të qirave, llogaritë e ngurtësimit për garancinë në kolegjin “****” apo çdolloj pagese tjetër).

11.6.1 Subjekti, në përgjigje të saj, ka shpjeguar se gjatë qëndrimit në Angli të znj. K. H., gjatë periudhës së rivlerësimit kalimtar ka pasur llogarinë bankare me nr. ***, por nuk ka bashkëlidhur nxjerrje të llogarisë bankare. Subjekti ka vijuar me shpjegimin se për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar nuk mund të gjejë kontratat e qirasë ku ka banuar vajza gjatë kohës së studimit në

⁸⁸ Dokument i datës 22.9.2022, nga punëdhënësi ***, i cili konfirmon punësimin e K. H. për periudhën 15.7.2015 – 12.4.2018, me pagë vjetore 60,000 GBP, si dhe periudhën e punësimit si praktikante 23.6.2014 – 14.7.2015; formulari P60 për vitet 2015 – 2016, i cili tregon të ardhurat totale të përfituara nga punëdhënësi në fjalë për qëllim të taksave; dokument për informacionin e pagave për periudhat qershor – gusht 2014.

⁸⁹ Shpenzimet jetike në Londër për vitin 2014 janë paguar nga të ardhurat e subjektit të rivlerësimit; shpenzimet jetike për vitin 2015 – 2016 janë marrë sipas të dhënave zyrtare në UK.

<https://www.ons.gov.uk/peoplepopulationandcommunity/personalandhouseholdfinances/expenditure/datasets/detailedhouseholdexpenditurebyageofhouseholdreferencepersonuktablea11>

⁹⁰ Në DIPP-në e vitit 2014 nuk ka deklarim të të ardhurave nga punësimi i vajzës; në DIPP-në e vitit 2015 subjekti ka deklaruar: “Të ardhura nga paga nga puna në bankën amerikane ****”, Londër dhe të shpenzuara për shkollim në Universitetin ***, Londër dhe jetesë. Paga derdhet në bankën ****. Shuma 21,883 GBP”; në DIPP-në e vitit 2016 ka deklaruar: “Të ardhura nga puna e vajzës në bankën amerikane në Londër, në shumën 10,471 GBP, nga të cilat 7,471 GBP i ka transferuar në llogarinë e babit të saj O. H. në BKT, në datën 21.4.2016, ndërsa shumën 3,000 GBP e ka sjellë kur ka ardhur vetë me pushime... Të ardhura nga paga nga puna në bankën amerikane ****”, Londër, për vitin 2016. Paga derdhet në bankën ****. Shuma 68,000 GBP”; në pyetësorin standard janë deklaruar shpenzimet e udhëtimeve për vajzën K. H. deri në vitin 2014; në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar se vajza K. H. ka financuar vlerën 1,570 euro për pushimet familjare në ***, Turqi, 30.8.2014 – 8.9.2014.

Universitetin ***, Londër, por deklaroi se kostoja e jetesës për studentët është rreth 940 GBP/muaj, ku përfshihet ushqimi dhe strehimi.

11.6.2 Komisioni, duke marrë në konsideratë kohën e qëndrimit në Angli të vajzës K. H., i ka llogaritur shpenzimet e saj jetike deri në vitin 2014 në Shqipëri vetëm për ditët e qëndrimit dhe për shpenzimet jetike në Angli është bazuar në deklarin e subjektit të rivlerësimit në DIPP-të përkatëse.

Tabela nr. 6 – Koha e qëndrimit të vajzës K. H. në Angli për vitet 2010 – 2016

| Viti | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|---------------------|------|------|------|------|------|------|------|
| Ditë qëndrimi në UK | 110 | 247 | 210 | 249 | 282 | 300 | 324 |
| Ditë qëndrimi në AL | 255 | 118 | 155 | 116 | 83 | 65 | 41 |

11.6.3 Subjekti i rivlerësimit, për periudhën e studimit të vajzës në kolegjin “***”, 2.9.2010 – 2.6.2012, për të provuar deklarinet periodike ka depozituar në pyetësorin nr. 3 komunikimin me *email* (i përkthyer), i cili konfirmon periudhën e studimit, tarifat e paguara, si dhe marrjen e bursës për çdo vit gjatë dy viteve të studimit. Në këto kushte, Komisioni ka marrë në konsideratë si shpenzime shkollimi për periudhën 2.9.2010 – 2.6.2012 vlerat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike.

11.6.4 Për periudhën e studimit në Universitetin ***, Komisioni, referuar vlerës së deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në pyetësor (940 GBP muaj), si dhe periudhës së studimit të vajzës në Universitetin ***, konfirmuar edhe nga lëvizjet në sistemin TIMS, llogariti shpenzimet e jetesës në varësi të ditëve të qëndrimit për periudhën 2012 – 2015⁹¹, në total 23,970 GBP ose 4,225,251 lekë⁹².

11.6.5 Në lidhje me tarifat e shkollimit dhe pagesat e kryera, subjekti ka depozituar si shtesë të pyetësorit nr. 3 kopjet e faturave (të përkthyer), nga ku ka rezultuar se për periudhën tetor 2012 – janar 2015 janë bërë pagesa në total në shumën 43,950 GBP ose 7,724,663 lekë.

11.6.6 Pas përllogaritjes së shpenzimeve jetike dhe të studimit, shpenzimet totale të paguara nga subjekti i rivlerësimit për studimin dhe qëndrimin e vajzës në Universitetin ***, për periudhën 18.9.2012 – 6.7.2015, janë në shumën 11,949,915 lekë⁹³.

11.7 Në deklarinet periodike dhe në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar shpenzime shkollimi për vajzën, ku janë të përfshira edhe shpenzimet për akomodim dhe ushqim, pasqyruar në tabelën si më poshtë:

⁹¹ Shpenzimet jetike mujore për studentët janë 940 GBP.

⁹² Viti 2012 = 88 ditë qëndrimi = 2,757 GBP ose 472,000 lekë; viti 2013 = 249 ditë qëndrimi = 7,802 GBP ose 1,313,779 lekë; viti 2014 = 282 ditë qëndrimi = 8,836 GBP ose 1,585,885 lekë; viti 2015 = 146 ditë qëndrimi = 4,575 GBP ose 853,587 lekë.

⁹³ Viti 2012 = shpenzime jetese 472,000 lekë + shpenzime për tarifë shkollimi 1,198,260 lekë = 1,670,260 lekë; 2013 = shpenzime jetese 1,313,779 lekë + shpenzime për tarifë shkollimi 2,420,606 lekë = 3,734,385 lekë; 2014 = shpenzime jetese 1,585,885 lekë + shpenzime për tarifë shkollimi 2,687,713 lekë = 4,273,598 lekë; 2015 = shpenzime jetese 853,587 lekë + shpenzime për tarifë shkollimi 1,418,084 lekë = 2,271,671 lekë.

Tabela nr. 7

| Viti | Deklarimi periodik/pyetësori standard |
|--------------------|---|
| 2012 ⁹⁴ | Shpenzime për shkollimin e vajzës në Universitetin ***, Londër + shpenzime të ndryshme për të. Shuma 10,000 GBP, nga të cilat 2,500 GBP janë marrë nga depozita e ngurtësuar më parë pranë Barclays Bank PLC. |
| 2013 | Shpenzime për shkollimin e vajzës në Universitetin ***, Londër + shpenzime të ndryshme për të. Shuma 4,000,000 lekë. |
| 2014 | Shpenzime për shkollimin e vajzës në Universitetin ***, Londër + shpenzime të ndryshme për të. Shuma 3,340,000 lekë. |

11.8 Në përfundim, Komisioni përfshiu në analizën financiare shpenzimet totale të vajzës, sipas deklarimit të subjektit në DIPP-të përkatëse, ku nga përllogaritja shpenzimet totale⁹⁵ rezultuan në një vlerë më të vogël se ajo e deklaruar, ndërsa kur ato rezultuan me vlerë më të madhe se ajo e deklaruar u morën në konsideratë shumat e përllogaritura nga Komisioni. Përllogaritja e kryer nga Komisioni për shpenzimet jetike është bërë sipas deklarimit të subjektit se shpenzimi mujor për studentët është rreth 940 GBP/muaj, ndërsa për shpenzimet e shkollimit janë marrë në konsideratë faturat e paguara nga subjekti dhe të dorëzuara në pyetësin nr. 3.

11.9 Në përfundim të hetimit administrativ është konstatuar se *subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzimet e shkollimit për vitin 2014 më të ulëta (në vlerën 3,340,000 lekë) se vlera e llogaritur nga Komisioni prej 4,273,598 lekësh, bazuar në të dhënat e deklaruara nga subjekti.*

Për konstatimin e mësipërm, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit 84/2016, për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

11.10 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e saj ka shpjeguar se në DIPP-në e vitit e 2014 ka deklaruar shpenzime totale shkollimi dhe jetese të vajzës K. H. në Londër, në shumën 3,340,000 lekë, ndërsa nga Komisioni në analizë financiare janë llogaritur 4,273,598 lekë. Subjekti shpjegon se vlera reale e shpenzuar është ajo e deklaruar në DIPP-në e vitit e 2014, ndërsa diferenca prej 933,598 lekësh është paguar nga vetë vajza, pasi ajo ka siguruar të ardhura nga *internship*-i që ka bërë në bankën amerikane “***” në Londër, në muajt qershor – gusht të vitit 2014, sipas vlerave: qershor = 1,902.42 GBP; korrik = 2,908.66 GBP dhe gusht = 2,666.25 GBP. Kjo shumë totale e përllogaritur në monedhën lekë për të 3 muajt është 1,342,031 lekë. Në analizën financiare të vitit 2014 duhet të përllogaritet e ardhura e realizuar në 3 muaj, pasi nga Komisioni është marrë parasysh vetëm muaji qershor. Për këtë pretendim subjekti dërgoi dokumentacionin provues.

Vlerësim i çështjes nga Komisioni

11.11 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme. Në mbështetje të pretendimeve të saj, subjekti ka depozituar si provë një dokument në gjuhën angleze nga Banka e Amerikës në Angli, ku në llogari të K. H. janë hedhur shumat e lartpërmendura për 3 muajt e pretenduar. Komisioni vëren se vërtetohen pagesat që i janë bërë K. H. për 3 muaj, në total

⁹⁴ Pagesa të kryera nga marrja e detyrës qershor – dhjetor 2012.

⁹⁵ Sipas pikës 11.6.6.

në vlerën 7,477.33 GBP, e konvertuar në monedhën lekë në shumën 1,342,031 lekë⁹⁶ dhe vlerëson të marrë në konsideratë në analizë financiare edhe muajt korrik dhe gusht 2014, në shumën 5,574.91 GBP ose 933,598 lekë, duke ia zbritur shumës 4,273,598 lekë së dërguar nga Komisioni me rezultatet e hetimit.

Komisioni, pasi mori në konsideratë deklaratimet e subjektit, si dhe dokumentacionin provues të këtyre të ardhurave, në analizën financiare, nga shuma 4,273,598 lekë të llogaritur, zbriti shumën 1,342,031 lekë dhe e pasqyroi atë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, duke llogaritur si vlerë përfundimtare atë prej 3,340,000 lekësh, vlerë kjo e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2014.

KONSTATIME TË TJERA

12. Në lidhje me depozitën në Credins Bank me afat 6-mujor, në shumën 52,000 USD

12.1 Në DIPP-në e vitit e vitit 2008, subjekti ka deklaruar: *“Depozitë në Credins Bank me afat 6 mujor, në shumën 52,000 USD, në emër të bashkëshortit. Duke pakësuar gjendjen cash deklaruar më parë”*. Në DIPP-në e vitit e 2009, subjekti deklaron: *“Depozitë në Credins Bank me afat 6 mujor, pakësuar 6,000 USD. Gjendje 31.12.2008 = 52,000 USD, gjendje 31.12.2009 = 46,996 USD (përdorur për blerje apartamenti)”*.

12.2 Nga veprimet bankare në Credins Bank⁹⁷, rezulton se në datën 9.12.2008 në llogarinë e bashkëshortit O. H. është xhiruar nga shtetasi P. Gj. shuma 52,338.94 USD, me përshkrimi: *“O... Gj. P. kalim në depozitë 6-mujore”*. Për këtë veprim subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar shpjegime me pyetësorin nr. 2, lidhjen me këtë shtetas dhe arsyen e transferimit të kësaj shume. Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se shtetasi P. Gj. është daja i saj. Kjo shumë është transferuar prej tij në llogari të bashkëshortit, pasi për arsye familjare bashkëshorti O. H., nga gjendja *cash* e të ardhurave të tyre (*cash* i cili është deklaruar edhe në deklaratën fillestare të deklarimit të pasurisë në 20.1.2008) i ka dhënë hua në prill 2008 dajës së saj P. Gj. shumën prej 52,000 USD, shumë e cila është kthyer me transfertën bankare të sipërcituar. Aktualisht shtetasi P. Gj. nuk jeton, pasi ka ndërruar jetë në nëntor 2011.

12.2.1 Subjektit i janë kërkuar shpjegime në lidhje me mospërputhjen e burimit të krijimit të kësaj depozite, deklaruar prej saj në DIPP-në e vitit 2008, nga zvogëlimi i gjendjes *cash*.

Për sa i përket mospërputhjes së burimit të krijimit të kësaj depozite, subjekti shpjegon se nuk ka mospërputhje për sa kërkohet, pasi në DIPP-në e vitit e 2008 ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* të deklaruar në DPFD-në e vitit 2008, por nuk ka dhënë detaje që kjo depozitë në Credins Bank, me vlerë 52,000 USD, është krijuar nga kthimi me transfertë bankare të huas së dhënë. Subjekti nuk ka dhënë detaje për këtë huadhënie në DIPP-në e vitit 2008, për arsye se veprimet janë kryer brenda intervalit kohor nga momenti i deklarimit fillestar deri në dhjetor 2008.

12.2.2 Në pikën 1.6.5 të vendimit është analizuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj për të krijuar me të ardhura të ligjshme kursimet *cash* në shumën 100,000

⁹⁶ Sipas Bankës së Shqipërisë, kursi mesatar i monedhës pound për vitin 2014 është 1 GBP = 179.48 lekë.

⁹⁷ Shkresë e Credins Bank nr. *** prot., datë 17.3.2021, drejtuar Komisionit.

euro, nga ku ata rezultuan me pamundësi financiare për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasuritë (përfshirë edhe gjendjen *cash*) deri në datën 16.1.2008. Në kushtet kur nuk provohet burimi i ligjshëm i shumës 100,000 euro, të deklaruar si kursime *cash* në datën 16.1.2008, ku një pjesë e kësaj shume sipas deklarimit të subjektit është përdorur për hapjen e depozitës 52,388.94 USD, në datën 9.12.2008, nuk provohet as burimi i ligjshëm i depozitës së krijuar nga gjendja *cash*.

12.3 Nga hetimi administrativ u konstatua se në lidhje me depozitën në USD të krijuar në vitin 2008, me burim gjendjen *cash* prej 100,000 euro, për sa nuk u provua burimi i ligjshëm i kësaj shume, nuk provohet edhe burimi i ligjshëm i kësaj depozite prej 52,000 USD, të krijuar nga kjo gjendje *cash*.

Për këtë konstatim, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

12.4 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e saj ka shpjeguar se ashtu siç ka rezultuar nga hetimi, për arsye familjare bashkëshorti O. H. nga gjendja *cash* e të ardhurave të tyre (*cash* i cili është deklaruar edhe në deklaratën fillestare të deklarimit të pasurisë në 20.1.2008) i ka dhënë hua në prill 2008 dajës së saj P. Gj. shumën prej 52,000 USD, shumë e cila është kthyer me transfertë bankare. Koha e afërt e dhënies së huas (muaji prill) vetëm 3 muaj nga momenti i fillimit të detyrës dhe kthimi i kësaj huaje me transaksion bankar kur subjekti nuk ishte subjekt deklarues, vërteton ekzistencën dhe bindjen e subjektit në ligjshmërinë e këtyre të ardhurave në momentin e fillimit të detyrës në janar të vitit 2008.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

12.5 Komisioni vëren se nga hetimi administrativ u konstatua se në lidhje me depozitën në dollarë të krijuar në vitin 2008, me burim gjendjen *cash* prej 100,000 euro, për sa nuk u provua burimi i ligjshëm i kësaj shume, nuk provohet edhe burimi i ligjshëm i kësaj depozite prej 52,000 USD të krijuar nga kjo gjendje *cash*.

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj ndodhen në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e depozitës në Credins Bank, duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

13. Analiza financiare për periudhën 1992 – 2016

13.1 Nga analiza e deklaratës së interesave pasurorë privatë/vjetorë dhe asaj *Vetting*, për periudhën e hetimit 1992 – 2016, të kryer nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme në shumën -37,060,845 lekë për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë, nga ku gjatë ushtrimit të detyrës si prokurore (1992 – 1998 dhe 2012 – 2016) ka rezultuar me balancë negative prej -3,126,598 lekësh.

Për këtë konstatim, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimeve.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

13.2 Subjekti i rivlerësimit në prapësime ka shpjeguar se për analizën financiare deri më 16.1.2008 shpjegimet dhe argumentet janë pasqyruar më lart, nga e cila rezulton se për këtë periudhë nuk konstatohen diferenca. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se mundësia për kursime *cash* për periudhën 1992 – 16.1.2008 është me balancë pozitive, në shumën 666,218 lekë, ndryshe nga rezultati i Komisionit, ku subjekti rezultonte me balancë negative në shumën -30,060,845 lekë.

13.3 Sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, balanca pozitive ka ardhur si rezultat i përfshirjes/korrigjimeve në analizën e paraqitur nga subjekti të:

- Të ardhurave nga emigracioni në shumën 190,000 euro (150,000 euro ose 20,823,000 lekë O. H. dhe 40,000 euro ose 5,592,800 lekë M. Bushi).
- Të ardhurave nga lokali në shumën 2,400,000 lekë deri në datën 16.1.2008 (1,000,000 lekë + 1,400,000 lekë).
- Të ardhurave nga lokali nga H. B. në shumën 6,000,000 lekë, për periudhën 2008 – 2012 (nga 1,200,000 lekë/vit).
- Janë reduktuar shpenzimet jetike deri në vitin 1998, në masën 30% e të ardhurave, sipas vendimit të Kolegjit të vitit 2021, ku subjekti ka llogaritur shumën 2,161,651 lekë nga 3,549,967 lekë të llogaritura nga Komisioni.
- Janë reduktuar shpenzimet jetike në Itali të vitit 2004 (janë llogaritur gjithë vitin, por bashkëshorti është kthyer në shkurt të 2004).
- Janë reduktuar shpenzimet jetike në Itali pasi shpenzimet (qira, banesë, drita, ujë etj.) kanë qenë zero gjatë gjithë kohës, pasi kanë qenë të mbuluara/paguara nga vëllai i bashkëshortit L. H., si dhe nga puna në paneteri e subjektit, ku shpenzimet bazike për ushqim ishin nga paneteria. Të gjitha këto zvogëlojnë në vlerë të konsiderueshme shpenzimet jetike në total të qëndrimit të subjektit në Itali. Subjekti, nga vlera prej 9,905,335 lekësh e llogaritur nga Komisioni, ka përlllogaritur si shpenzime jetike vlerën 8,282,408 lekë.
- Në vitin 1999 shpenzimet jetike të vajzës, për shkak se i gjithë ushqimi dhe veshja e saj përballuhej nga përfaqësuesit e kishës (motrat), siç u shpjegua më sipër, shpenzimet për vajzën në vitin 1999 nuk janë përlllogaritur në analizën financiare.
- Të zbritet vlera prej 530 euro nga analiza financiare e vitit 2005 dhe vlera 430 euro nga analiza e vitit 2006 për udhëtimet e datave 26.6.2005 – 3.7.2005 dhe 13.18.2006, ku subjekti sqaron se nga dokumentacioni i gjetur rezultojnë të jenë bërë udhëtimet, respektivisht udhëtimi i datës 26.6.2005 – 3.7.2005 në L., Britani e Madhe dhe udhëtimi i datës 13.18.2006 në ***. Janë udhëtime pune me të gjitha shpenzimet e paguara nga organizatorët, me sa kujton subjekti nga USAID. Subjekti ka kërkuar urdhrin e daljes jashtë shtetit për këto udhëtime, por nuk i është vënë në dispozicion. Në këto udhëtime ka marrë pjesë edhe znj. A. V., e cila në atë periudhë ka qenë kancelare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Nga sistemi TIMS verifikohet hyrje-dalja e saj, që përkon me udhëtimin e subjektit në këto data. Pavarësisht mungesës së urdhrin për dalje jashtë shtetit, provohet që ky ka qenë udhëtim pune. Si dokument provues subjekti ka depozituar deklaratën noteriale të znj. V., vërtetimin nga sistemi TIMS të hyrje-daljeve të znj. V., si dhe foto që provojnë faktin e të qenit në këtë

udhëtim me kolegë pune në Vjenë). Për këtë arsye, subjekti i kërkon Komisionin që vlera prej 530 euro të zbritet nga analiza financiare e vitit 2005.

- Lidhur me shpenzimet e vendosura në analizën financiare (për mungesë dokumentacioni) për udhëtimin e kryer në datat 24.12.2009 – 4.1.2010, në Londër (në vlerën 2,200 euro) dhe udhëtimin në datat 23 – 28.2.2010 po në Londër (në vlerën 750 euro) të përlllogariten si shpenzime të mbuluara nga familjarët apo të afërm të tjerë sipas vendimit njësuës të Kolegjit, pasi të gjitha shpenzimet janë mbuluar nga nipi i bashkëshortit J. B. Subjekti ka depozituar deklaratën e shtetasit J. B.
- Lidhur me shpenzimet e vendosura në analizën financiare (për mungesë dokumentacioni) për udhëtimin e kryer në datat 24 gusht – 4.9.2010 në Gjermani (në vlerën 1,800 euro), të përlllogariten si shpenzime të mbuluara nga familjarët apo të afërm të tjerë sipas vendimit njësuës të Kolegjit, pasi të gjitha shpenzimet janë mbuluar nga miku i familjes D. A. Subjekti ka depozituar deklaratën e shtetasit D. A.
- Lidhur me shpenzimet e udhëtimit të vajzës K. H. gjatë vitit 2010, të vendosur në analizën e Komisionit në vlerën totale prej 512 euro, e kryer në datat 24.8.2010 – 23.10.2010, 31.10.2010 – 19.12.2010 dhe 4.1.2011 – 9.4.2011, subjekti shpjegon se shpenzimet për këto udhëtime janë të përfshira në shumën 5,200 GBP, deklaruar në DIPP-në e vitit 2010. Nga shuma 5,200 GBP, vetëm 3,868 GBP është pagesë që subjekti i ka bërë kolegjit, në të cilën përfshihen shpenzimet për shkollim, akomodim dhe ushqim. Shuma e mbetur prej 1,332 GBP (ose 215,065 lekë) është shpenzuar për udhëtimet vajtje-ardhje në Britaninë e Madhe në shumën 512 euro ose 70,815 lekë. Pjesa tjetër janë shpenzime të ndryshme dhe, nga subjekti, në shumën e deklaruar si shpenzime shkollimi janë përfshirë edhe shpenzimet e udhëtimit (biletat e avionit). Edhe shpenzimet për biletën e datave 4.1.2011 – 9.4.2011 janë kryer në vitin 2010 dhe përfshihen në shpenzimet e deklaruara për shkollim.
Subjekti kërkon që vlera prej 345 euro të mos llogaritet në shpenzimet e udhëtimit të vajzës në analizën financiare për vitin 2010, si dhe vlera prej 175 euro të mos llogaritet në shpenzimet e udhëtimit për vajzën në analizën financiare të vitit 2011, pasi kjo biletë ishte prerë në vitin 2010.
- Lidhur me shpenzimet e udhëtimit të vajzës K. H. gjatë vitit 2011, të vendosur në analizën e Komisionit në vlerën totale prej 720 euro, e kryer në datat 26.4.2011 – 17.6.2011, 31.8.2011 – 22.10.2011, 30.10.2011 – 17.12.2011 dhe 8.1.2012-15.2.2012, subjekti shpjegon se shpenzimet për këto udhëtime janë të përfshira në shumën 6,000 GBP, deklaruar në DIPP-në e vitit 2011. Nga shuma 6,000 GBP, vetëm 5,167 GBP është pagesë që subjekti i ka bërë kolegjit, në të cilën përfshihen shpenzimet për shkollim, akomodim dhe ushqim. Shuma e mbetur prej 833 GBP (ose 138,211 lekë) është shpenzuar për udhëtimet vajtje-ardhje në Britaninë e Madhe në shumën 720 euro ose 99,576 lekë.
Shpenzimet për biletën e datave 8.1.2012 – 15.2.2012 janë kryer në vitin 2011 dhe përfshihen në shumën e deklaruar si shpenzim për vitin 2011.
Subjekti kërkon që vlera prej 540 euro të mos llogaritet në shpenzimet e udhëtimit të vajzës në analizën financiare për vitin 2011, si dhe vlera prej 180 euro të mos llogaritet në shpenzimet e udhëtimit për vajzën në analizën financiare të vitit 2012. Subjekti ka

bashkëngjitur dokumentacionin mbi pagesat e bëra nga subjekti për vajzën e saj në kolegjin “***”.

- Lidhur me shpenzimet në vlerën 530 euro, të vendosur në analizën financiare për mungesë dokumentacioni për udhëtimin e kryer në datat 18 – 18.3.2012, subjekti shpjegon se në pyetësin standard, tek përgjigjja e pyetjes nr. 12, është deklaruar gabim nga ana e subjektit ky udhëtim, por realisht është kryer në të njëjtat data, por në vitin 2013, pra në datat 11 – 18.3.2013, e cila mund të verifikohet lehtësisht në sistemin TIMS. Për këtë udhëtim, shpenzimet janë paguar nga puna, pasi ka qenë udhëtim pune. Subjekti ka depozituar në pyetësin standard urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm në Prokurorinë e Përgjithshme nr. ***, datë 20.2.2013. Subjekti kërkon që shuma 530 euro të zbritet nga analiza financiare e vitit 2012.
- Subjekti kërkon që në analizën financiare duhet të përfshihet edhe zëri “Të ardhura nga kursi i këmbimit”, pasi, siç rezulton nga hetimi, nga viti 2008 e në vazhdim, siç është konstatuar, subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë pasur llogari bankare/depozitë në monedhat dollarë dhe pound dhe meqenëse Komisioni ka kryer analizën në monedhën lekë, në disa vite subjekti ka rritje të likuiditetit, për shkak të rritjes së kursit të këmbimit dhe një vit ka zvogëlim të likuiditetit, për shkak të kursit të këmbimit (pra e njëjta vlerë në monedhën, për shembull, pound, në vitin 2009, konvertohet në vlera të ndryshme në lekë në këtë vit, krahasuar me vitin 2010, e me radhë). Në tabelën e paraqitur nga subjekti janë bërë korrigjimet përkatëse.
- Lidhur me shpenzimet e shkollimit të vajzës K. H. në Angli, ku në DIPP-në e vitit 2014 janë deklaruar nga subjekti në vlerën 3,340,000 lekë, ndërsa Komisioni i ka llogaritur ato në shumën 4,273,598 lekë, subjekti ka pretenduar se vlera reale e shpenzuar është ajo e deklaruar, siguruar të ardhura nga *internship*-i që ka bërë në bankën amerikane “***” në Londër, në muajt qershor = 1,902.42 GBP, korrik = 2,908.66 GBP dhe gusht = 2,666.25 GBP, e përllogaritur në lekë 1,342,031 lekë, pasi nga Komisioni është marrë parasysh vetëm muaji qershor. Subjekti ka depozituar në cilësinë e provës dokument të bankës amerikane “***”, ku janë të bashkëngjitur listëpagesa, ku në llogari të K. H. janë bërë pagesat e lartpërmendura.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

13.4 Komisioni, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në shpjegimet e tij dhe analizoi provat e përfituara gjatë hetimit administrativ, vendosi të mos marrë në konsideratë/të mos përfshijë në analizën financiare:

a) Të ardhurat e përfituara nga emigracioni në shumën 188,301 euro (nga 190,000⁹⁸ vetëm 1,699 euro janë përfshirë në analizën financiare, pasi janë provuar me dokumentacion ligjor), pasi subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshorti O. H., nuk provuan me dokumentacion ligjor realizimin e këtyre të ardhurave në periudhën 1997 – 2004, si dhe plotësimin e kriterit të ligjshmërisë së tyre, në përputhje me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 86/2014. Këto të ardhura janë analizuar gjerësisht në pikat 1.8-1.12 të vendimit.

⁹⁸ 150,000 euro ose 20,823,000 lekë O. H. dhe 40,000 euro ose 5,592,800 lekë, Miranda Bushi.

b) Vlerën prej 8,282,408 lekësh, të llogaritur nga subjekti si reduktim i shpenzimeve jetike në Itali për vitet 1998 – 2004, me pretendimin se kanë qenë shpenzime minimale, pasi qira, ujë drita etj. janë paguar nga vëllai i bashkëshortit dhe se produktet bazike janë siguruar nga subjekti nga puna e saj në paneteri. Komisioni vlerëson se ky pretendim është deklarativ dhe i pambshtetur në prova dhe vendosi që shpenzimet jetike të rillogariten në shumën 8,788,345 lekë, pas prapësimeve të subjektit.

c) Uljen e shpenzimeve jetike për vitin 1999, për vajzën K. H., se shpenzimet e jetesës së saj, përballuar nga kisha, Komisioni nuk e mori në konsideratë, pasi ky pretendim i subjektit është thjesht deklarativ dhe i pambshtetur në prova.

d) Zërin të ardhura nga kursi i këmbimit nga viti 2008 e në vijim, në lidhje llogaritë/depozitat në euro/pound, të konvertuara në lekë, ku ka pasur ulje dhe rritje të likuiditetit. Komisioni, në llogaritjet e depozitave/llogarive sipas valutave të huaja të konvertuara në monedhën lekë, është bazuar në kurset e këmbimit të publikuara në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë www.bankofalbania.org, sipas periudhave të caktuara.

e) Reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit të K. H. në shumën 512 euro, në datat 24.8.2010 – 23.10.2010, 31.10.2010 – 19.12.2010 dhe 4.1.2011 – 9.4.2011, me pretendimin se janë të përfshira në shumën 5,200 GBP, të deklaruar në DIPP-në e vitit 2010. Komisioni vlerëson se ky pretendim nuk qëndron, pasi subjekti në DIPP-në e vitit 2010 ka deklaruar shprehimisht: *“Paguar për shkollimin e vajzës në kolegjin ***, Britani e Madhe, shuma 5,200 GBP”*. Subjekti ka depozituar si provë një *email*, që pretendohet i dërguar nga banka, pasi nuk del e qartë, personi që ka kthyer përgjigje për shkollimin e K. H. ka shënuar shumën 3,868 GBP për vitin 2010, si kontribut i prindërve. Pretendimi i subjektit se diferenca prej 1,332 GBP është shpenzuar për udhëtimet e datave të mësipërme, mbetet vetëm deklarativ, i pambshtetur në dokumentacion provues ligjor.

f) Reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit të K. H. në shumën 720 euro, në datat 26.4.2011 – 17.6.2011, 31.8.2011 – 22.10.2011, 30.10.2011 – 17.12.2011 dhe 8.1.2012 – 15.2.2012, me pretendimin se janë të përfshira në shumën 6,000 GBP, deklaruar në DIPP-në e vitit 2011. Komisioni vlerëson se ky pretendim nuk qëndron, pasi subjekti, në DIPP-në e vitit 2011, ka deklaruar shprehimisht: *“Shpenzime për shkollimin e vajzës në kolegjin ***, Britani e Madhe, shuma 6,000 GBP”*. Subjekti ka depozituar si provë një *email*, që pretendohet i dërguar nga banka, pasi nuk del e qartë, personi që ka kthyer përgjigje për shkollimin e K. H. ka shënuar shumën 5,167 GBP për vitin 2011, si kontribut i prindërve. Pretendimi i subjektit se diferenca prej 833 GBP është shpenzuar për udhëtimet e datave të mësipërme, mbetet vetëm deklarativ, i pambshtetur në dokumentacion provues ligjor.

13.4.1 Komisioni vendosi të marrë në konsideratë dhe përfshiu në analizën financiare:

a) Të ardhurat nga lokali në shumën 2,400,000 lekë, deri në datën 16.1.2008 (1,000,000 lekë + 1,400,000 lekë), si dhe të ardhurat nga përdorimi i lokalit nga shtetasi H. B., në shumën 6,000,000 lekë, për periudhën 2008 – 2012 (1,200,000 lekë/vit), Komisioni, shumën prej 1,000,000 lekësh si të ardhura të realizuara nga bashkëshorti O. H. për periudhën 2002 – 2004, i kishte

përfshirë që në fillim në analizën financiare, ndërsa për shumat 1,400,000 lekë dhe 6,000,000 lekë, pasi i analizoi ato gjerësisht në pikën 10.8, i mori në konsideratë dhe i përfshiu në analizën financiare, me arsyetimin se ato plotësojnë kriterin e të ardhurave të ligjshme, sipas legjislacionit tatumor.

b) Reduktimit të shpenzimeve jetike në Shqipëri, në masën 30% deri në vitin 1998. Komisioni, bazuar në praktikën e Kolegjit, sipas vendimit nr. 15/2021, të subjektit K. S., ka llogaritur dhe përfshirë në analizën për periudhën 1992 – 1998 shpenzimet jetike në masën 30%, në shumën 456,005 lekë, nga 1,003,212 lekë të llogaritura në fillim nga Komisioni para rezultateve të hetimit.

c) Reduktimin e shpenzimeve jetike në Itali për bashkëshortin, për vitin 2004, duke i llogaritur ato vetëm për 2 muaj (janar – shkurt 2004), pasi Komisioni i kishte llogaritur për të gjithë vitin, sipas deklaramin të subjektit në deklaratën *Vetting*. Komisioni vendosi që nga shuma 6,624 euro, e llogaritur në fillim, të konsiderojë në analizën financiare shumën e rillogaritur prej 1,104 euro.

d) Zbritjen nga shpenzimet e udhëtimit të vlerës 530 euro, në datat 26.6.2005 – 3.7.2005, në Londër dhe 430 euro në datat 13.18.2006, në Vjenë, duke i konsideruar ato udhëtime pune, të vërtetuar këto nga deklaramin e shtetases A. V.⁹⁹, si dhe nga sistemi TIMS, ku hyrje-daljet e saj përkojnë me udhëtimin e subjektit në këto data.

e) Zbritjen e shpenzimeve të udhëtimit për datat 24.12.2009 – 4.1.2010 dhe 23 – 28.2.2010, për dy udhëtimet në Londër, pasi këto shpenzime janë mbuluar nga shtetasi J. B. (djali i motrës së O. H.). Subjekti në prapësime ka depozituar një deklaratë të këtij shtetasi, i cili deklaroi se për dy udhëtimet e O. H., bashkëshortes dhe dy fëmijëve, ata kanë qëndruar në shtëpinë e tij dhe të gjitha shpenzimet e akomodimit dhe jetesës janë mbuluar prej tij, si shpenzime të mbuluar nga familjarët, sipas vendimit të Kolegjit. Komisioni, bazuar në praktikën e Kolegjit¹⁰⁰ në lidhje me udhëtimet e mësipërme që mbulohej nga personat e tretë, ka zbritur shumën 2,080 euro, nga 2,920 euro si shpenzimi i ngarkuar subjektit përpara rezultateve të hetimit, si dhe ka zbritur shumën 404 euro, nga 2,080 euro si shpenzim i ngarkuar subjektit përpara rezultateve të hetimit.

f) Zbritjen e shpenzimeve të udhëtimit për datat 24 gusht – 4.9.2010, në Gjermani, pasi këto shpenzime janë mbuluar nga shtetasi D. A., mik i familjes. Subjekti në prapësime ka depozituar një deklaratë të këtij shtetasi, i cili deklaroi se për udhëtimin O. H., bashkëshortes dhe dy fëmijët, ata kanë qëndruar në shtëpinë e tij dhe të gjitha shpenzimet e akomodimit dhe jetesës janë mbuluar prej tij. Komisioni, bazuar në praktikën e Kolegjit në lidhje me udhëtimet e mësipërme që mbulohej nga personat e tretë, ka zbritur shumën 1,590 euro, nga 2428 euro si shpenzim i ngarkuar subjektit përpara rezultateve të hetimit.

⁹⁹ Subjekti me prapësimet ka depozituar deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.5.2023, të shtetases A. V., që konfirmon udhëtimin në të njëjtat data me subjektin për arsye pune, si dhe përgjigje të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, që konfirmon lëvizjet nga sistemi TIMS në këto data.

¹⁰⁰ Vendimi i Kolegjit nr. 11/22.5.2019, për subjektin E. I., në pikën 27.7, tek “Shpenzimet e qëndrimit” paragrafi II: “Në rastet kur nga subjekti i rivlerësimit provohet se shpenzimet e qëndrimit për të dhe/ose personat e lidhur me të janë mbuluar nga persona të tretë, atij/atyre do t’u llogariten vetëm sasia e të hollave të xhepit prej 5 eurosh/dollarësh amerikanë”.

g) Zbritjen e shpenzimit të udhëtimit prej 530 euro në datat 11 – 18.3.2012, pa dokumentacion, pasi subjekti gabimisht e ka deklaruar këtë udhëtim në vitin 2012, por realisht ky udhëtim është kryer në po njëjtat data, por në vitin 2013, çka rezulton edhe nga verifikimi i sistemit TIMS dhe që është udhëtim pune dhe është mbuluar nga Prokuroria e Përgjithshme¹⁰¹. Komisioni e ka sistemuar këtë shpenzim në analizën financiare si udhëtim pune, pasi subjekti ka depozituar urdhrin e Prokurorisë së Përgjithshme, ku të gjitha shpenzimet mbulohen nga kjo e fundit.

h) Përfshirjen e shpenzimeve të shkollimit të vajzës K. H., në shumën 3,340,000 lekë, deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2014 dhe jo të shumës 4,273,598 lekë, dërguar nga Komisioni me rezultatet e hetimit, pasi nga kjo shumë duhej zbritur diferenca prej 933,598 lekësh, që vjen si pasojë e pagesës së përfituar nga K. H. nga banka amerikane “***” për një *internship* të bërë pranë saj.

Komisioni, nga rezultati financiar i dërguar me rezultatet e hetimit, nga ku subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshorti O. H., rezultuan me pamundësi financiare, pasi nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme në shumën - 37,060,845 lekë, nga të cilat -3,126,598 lekë janë gjatë ushtrimit të detyrës së prokurores në periudhat 1992 – 1998 dhe 2012 – 2016, pas sistemimeve dhe rillogaritjes së zërave financiarë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshorti i saj, rezultuan me një balancë negative totale në shumën -28,209,341 lekë për periudhën 1992 – 2016, prej të cilave shuma -452,853 lekë rezulton gjatë periudhës së rifillimit të detyrës prej subjektit, përkatësisht vitit 2012 e në vijim, të fragmentizuar në periudha kohore sipas tabelës së mëposhtme:

¹⁰¹ Urdhri i Prokurorisë së Përgjithshme nr. ***, datë 20.3.2013.

| Periudha | 1992-1998 | 1999-2007 | deri 16.1.2008 | pas 16.1.2008 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|---|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|------------------|------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|------------------|
| PASURI | 0 | 27,520,927 | -104,657 | -2,068,076 | -2,172,733 | 2,369,865 | 2,284,019 | 1,720,994 | 376,027 | -3,254,531 | -2,541,567 | 1,061,062 | 3,954,301 |
| Apartament banimi në O*** | | | | | | 4,800,950 | | | | | | | |
| Autoveturë tip G*** me targë T***, 8.000 Euro/ 18.11.2008 | | | | 985,460 | 985,460 | | | | | | | | |
| Autoveturë tip A*** me targë A*** | | | | | | | | | | | | | 5,180,841 |
| Apartament banimi 118m2, K*** | | 7,926,320 | | | | | | | | | | | |
| Njësi shërbimi 390m2 blerë në 2001 | | 7,300,000 | | | | | | | | | | | |
| DIFERENCE LIKUIDITETI (LIK. AKTUAL - LIKUIDITETE VITI PARAAAR) | 12,294,607 | -104,657 | -3,053,536 | -3,158,193 | -2,431,085 | 2,284,019 | 1,720,994 | 376,027 | -3,254,531 | -2,541,567 | 1,061,062 | -1,226,540 | |
| DETYRIME | 0 | 1,934,560 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1,809,887 |
| P*** - Kontratë leasing me nr.***rep, nr.*** kol, datë 21.6.2016 | | | | | | | | | | | | | 1,809,887 |
| Kredi bankare B*** 16,000 Euro 23.4.2007 | | 1,934,560 | | | | | | | | | | | |
| PASURI NETO (PASURI - DETYRIME) | 0 | 25,586,367 | -104,657 | -2,068,076 | -2,172,733 | 2,369,865 | 2,284,019 | 1,720,994 | 376,027 | -3,254,531 | -2,541,567 | 1,061,062 | 2,144,414 |
| TE ARDHURA dokumentuar | 1,520,018 | 8,945,311 | 0 | 2,178,092 | 3,378,092 | 3,966,353 | 3,725,976 | 3,630,026 | 3,187,987 | 2,216,990 | 2,662,079 | 2,369,770 | 4,042,729 |
| Të ardhura nga puna si prok.në Prok.M*** (12.1992-9.1998) | 1,194,781 | | | | | | | | | | | | |
| Të ardhura nga puna si kancelare Gj*** (2.2004-1.2008) | | 5,057,044 | | | | | | | | | | | |
| Të ardhura nga puna si Drejtore Kabineti P*** (16.1.2008-5.6.2012) | | | 1,367,165 | 1,367,165 | 1,419,824 | 1,514,876 | 1,513,584 | 552,015 | | | | | |
| Të ardhura nga puna si Prokurore në T*** (5.6.2012-31.12.2016) | | | | | | | | 575,868 | 1,006,554 | 1,228,114 | 1,195,403 | 1,152,711 | |
| Të ardhura nga biznesi | | 1,000,000 | | | | | | | | | | | |
| Të ardhura nga lokalitë në përdorim H*** | | 1,400,000 | | | 1,200,000 | 1,200,000 | 1,200,000 | 1,200,000 | 1,200,000 | | | | |
| Të ardhura nga paga si mësues M*** 1992-1997 | 325,237 | | | | | | | | | | | | |
| Të ardhura nga emigracioni O*** 1997-2004 | | 221,344 | | | | | | | | | | | |
| Të ardhura nga paga si mësues T*** 9/2004-10/2006 | | 612,197 | | | | | | | | | | | |
| Të ardhura nga pag e b/sh A*** 10/2006-31.12.2016 | | 654,726 | | 668,727 | 668,727 | 699,831 | 691,748 | 816,746 | 738,097 | 1,121,979 | 1,030,518 | 1,124,341 | 1,012,180 |
| Të ardhura nga pag e b/sh M*** | | | | 86,400 | 86,400 | 50,400 | 180,900 | | | | | | |
| Të ardhura nga pag e b/sh K*** në U*** 2008-2009 sipas bankës | | | | 55,800 | 55,800 | 259,200 | | | | | | | |
| Të ardhura nga pag e b/sh U*** 2009 sipas vërtetimit | | | | | | 219,472 | | | | | | | |
| Të ardhura nga pag e b/sh UT_F*** | | | | | | | | 49,680 | 52,920 | 118,101 | 49,109 | 108,919 | |
| Të ardhura nga paga e vajzës | | | | | | | | | | 219,973 | | 1,692,352 | |
| Të ardhura nga inetersat | | | | | 117,626 | 108,452 | 94,696 | 72,327 | 35,537 | 65,374 | 917 | 76,567 | |
| Të ardhura nga emigracioni MB 1998-2003 | | 0 | | | | | | | | | | | |
| Të ardhura për K***, shkolla P***, sipas C*** Bank | | | | | | 30,000 | 5,000 | | | | | | |
| SHPENZIME | 1,570,722 | 10,316,679 | 48,826 | 4,515,177 | 4,564,003 | 1,091,541 | 1,901,214 | 1,957,962 | 3,011,844 | 5,535,545 | 5,071,831 | 1,497,652 | 1,401,037 |
| Shpenzime jetike | 456,005 | 2,601,020 | 23,955 | 522,525 | 546,480 | 546,480 | 409,957 | 409,905 | 423,131 | 423,117 | 660,026 | 672,828 | 705,276 |
| Shpenzime jetike IT 1998-2004 | 1,114,717 | 7,673,628 | | | | | | | | | | | |
| Shpenzime udhëtimi | | 42,031 | 0 | 17,861 | 17,861 | 203,012 | 314,006 | 230,546 | 233,752 | 395,252 | 386,844 | 234,831 | 181,987 |
| Shpenzime mobilimi | | | | 3,695,475 | 3,695,475 | | | | | | | | |
| Shpenzime shkollimi për vajzën | | | | | | | 839,592 | 995,520 | 1,711,800 | 4,000,000 | 3,340,000 | | |
| Shpenzime shkollimi për djalin | | | | | | | | | 115,600 | 285,600 | 370,000 | 228,000 | 81,162 |
| Shpenzime leasing kësti (principal+interes) | | | 24,871 | 279,316 | 304,187 | 342,050 | 337,659 | 321,991 | 329,039 | 327,884 | 314,962 | 307,798 | 432,612 |
| Shpenzim për taksë kalimi pronësie | | | | | | | | | | 103,693 | | | |
| Shpenzime për vizë U*** | | | | | | | | | 198,522 | | | 54,195 | |
| Shpenzim tatimi | | | | | | | | 0 | | | | | |
| LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT | 0 | 12,294,607 | 12,189,950 | 9,136,414 | 9,136,414 | 6,705,329 | 8,989,347 | 10,710,342 | 11,086,369 | 7,831,838 | 5,290,271 | 6,351,333 | 5,124,793 |
| Analiza dokumentuar | -50,704 | -26,957,735 | 55,831 | -269,009 | 986,822 | 504,947 | -459,257 | -48,931 | -199,885 | -64,025 | 131,815 | -188,944 | 497,278 |

B. KONTROLLI I FIGURËS

14. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK), pas kërkesës së Komisionit për rishikim dhe deklasifikim të raportit fillestar, me shkresën nr. *** prot., datë 30.11.2022, ka përcjellë pranë Komisionit raportin mbi kontrollin e figurës, me nr. *** prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, znj. Miranda Bushi, i deklasifikuar plotësisht (me vendimin nr. ***, datë 18.11.2022, të KDZH-së) dhe nga Grupi i Punës informohet se:

- *Formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë, në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016.*
- *Për subjektin e rivlerësimit, znj. Miranda Bushi, nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.*

Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Bushi.

Komisioni konstaton se nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës e, për rrjedhojë, konfirmon përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Bushi.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

15. Rivlerësimi profesional, sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është i bazuar në raportin e përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), si organi ndihmës për vlerësimin profesional dhe kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit. Ky organ ka hartuar raportin vlerësues nr. *** prot., datë 10.11.2022, për subjektin e rivlerësimit, znj. Miranda Bushi.

15.1 Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga KLP-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

15.2 Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se formulari i vetëdeklarimit paraqitet i plotë dhe i plotësuar sipas shtojcës 4 të ligjit.

15.3 Të dhëna nga burime arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme

Sipas të dhënave nga Prokuroria e Përgjithshme, subjekti Miranda Bushi është vlerësuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet 2014, 2015 dhe 2016, “shumë mirë”.

15.4 Tri dokumentet ligjore të paraqitura për vlerësim nga subjekti i rivlerësimit

Nga ana e KLP-së në raportin profesional janë analizuar tri dokumentet ligjore të paraqitura për vlerësim nga subjekti i rivlerësimit, konkretisht:

- i.** Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. ***, në ngarkim të të pandehurve E. N., L. D. dhe A. N., të akuzuar për veprën penale “vjedhje me dhunë”, të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 139 dhe 25 të Kodit Penal.
- ii.** Ankim kundër vendimit gjyqësor nr. ***, datë 1.11.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për çështjen penale referuar veprës penale “falsifikim të letërnjoftimeve etj.”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 189/2 i Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit A. R.
- iii.** Kërkesë për vleftësimin e arrestit, caktimin e masës së sigurimit dhe gjykimin e drejtpërdrejtë të procedimit penal nr. ***, në ngarkim të shtetasit A. R., i akuzuar për veprën penale “vjedhje”, të parashikuar nga neni 251/2 i Kodit të Procedurës Penale.

Pas analizimit të këtyre tri dokumenteve ligjore si nga Grupi i Punës në KLP, ashtu edhe nga ana e Komisionit, nuk u konstatuan problematika në lidhje me kriterin profesional.

15.5 Pesë dokumentet ligjore të përzgjedhura në mënyrë rastësore nëpërmjet procedurës së shortimit

KLP-ja në raportin profesional ka analizuar pesë dokumente ligjore të përzgjedhura me short, konkretisht:

- i.** “Vendim për mosfillimin e procedimit penal”, datë 3.7.2014, që i përket kallëzimit penal nr. *** të bërë nga shtetasja M. K., e cila ka kallëzuar se është shqetësuar disa herë nga një numër i paidentifikuar.
- ii.** “Vendim për pushimin e procedimit”, referuar procedimit penal nr. ***, për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal.
- iii.** “Kërkesë për gjykimin e çështjes”, referuar procedimit penal nr. ***, me të pandehur shtetasin J. N., akuzuar për veprën penale “dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130/a/4 i Kodit Penal.
- iv.** Kërkesë për gjykimin e çështjes të procedimit penal nr. ***, në ngarkim të të pandehurit E. P., akuzuar për veprën penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal.

Pas analizimit të këtyre dokumenteve ligjore si nga Grupi i Punës në KLP, ashtu edhe nga Komisioni, për dosjet 1, 3, 4 dhe 5 nuk u konstatuan problematika në lidhje me kriterin profesional.

15.5.1 Dosja nr. 2 – “Vendim për pushimin e procedimit penal nr. *”,** që i përket procedimit penal për veprën penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, që i referohet kallëzimit të bërë nga Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave (në vijim QKKB) në Prokurorinë e Rrethit Tiranë, duke pasqyruar faktet se subjekti farmaceutik “****” ka kryer veprime të paligjshme të hedhjes në treg dhe tregtimit me shumicë të barnave të bllokuara, pasi nuk është bërë i mundur sekuestrimi i tyre, për shkak se ato nuk janë gjetur fizikisht në depo sipas sasive të përshkruara në akt-kontrollet e mëparshme. Pra, në ambientet e shoqërisë nuk rezulton më e njëjta sasi barnash, pasi këto barna janë konstatuar në disa farmaci të qytetit në maj të vitit 2014. Mbi këto baza është pretenduar se nga subjekti dhe përfaqësuesit e tyre është kryer vepra penale “vjedhje”, pasi personi ka pasur detyrimin të ruajë nga cenimi i sekuestros

mallin që gjendet në mjediset e tij, e ka shitur jashtë kushteve teknike, për moszbatimin e të cilave ishte ndëshkuar më parë. Nga këto veprime ka ardhur një dëm prej 198,059,965 lekësh.

15.5.2 Në përfundim të hetimeve, subjekti i rivlerësimit Miranda Bushi ka vijuar në datën 11.12.2014 me “Vendimin e pushimit të çështjes”. Subjekti në vendimin e marrë ka arsyetuar se vepra penale “vjedhje”, e parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, kërkon si element të domosdoshëm hedhjen në dorë në mënyrë të kundërligjshme të pasurisë së tjetrit, me qëllim përfitimin material dhe moskthimin e tyre. Në rastin konkret, pasuria, pra barnat, objekti material, ka qenë ende në pronësi të subjektit farmaceutik dhe hedhja në dorë e tyre nga ana e subjektit nuk ka qenë e kundërligjshme. Për sa i përket të drejtës së disponimit, kuptohet që ajo duhej të ishte realizuar sipas rregullave që përcakton ligji për hedhjen në treg të këtyre barnave. Hedhja në treg e barnave pa autorizimin përkatës dhe ndryshimi në formën farmaceutike, pa pullë kontrolli, çmim shitjeje, si dhe shkelje të tjera të përcaktuara në nenin 57 të ligjit nr. 9323/2004, përbëjnë kundërvajtje administrative. Në këto kushte, procedimi penal duhet të pushohet, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

15.5.3 Komisioni, pasi ka analizuar aktet e fashikullit penal, ka konstatuar se:

a) *Kallëzimi penal i paraqitur nga QKKB-ja në datën 26.5.2014 është mbajtur pa u regjistruar si procedim penal për një kohë rreth 3 muaj, duke e regjistruar si procedim penal në datën 29.8.2014.*

b) *Subjekti i rivlerësimit nuk ka vepruar në përputhje me nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon “Funksionet e prokurorit”.*

Për këtë konstatim, subjektit të rivlerësimit i është kaluar barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

15.6 Subjekti i rivlerësimit në prapësime ka shpjeguar se në momentin e marrjes së kallëzimit në dorëzim e ka regjistruar atë menjëherë. Kallëzimi rezulton i regjistruar në datën 10.6.2014. Pasi është regjistruar dhe është verifikuar dokumentacioni bashkëngjitur kallëzimit, nuk gjendej i bashkëngjitur vendimi i gjykatës përkatëse, të cituar në kallëzim penal. Për këtë arsye i është kërkuar oficerit të policisë gjyqësore (në vijim OPGJ) që të administronte vendimin e gjykatës, që citohej në kallëzim. Pasi vendimi është marrë nga gjykata, gjatë kësaj kohe i është marrë deklaram edhe përfaqësueses së QKKB-së për këto rrethana. Në nenin 50 të ligjit nr. 8737/2001 përcaktohet se: *“Prokurori gëzon të drejtën e një leje vjetore të pagueshme prej 30 ditësh dhe si rregull bëhet në gusht”*. Me mbarimin e lejes vjetore, pasi subjekti ka analizuar të gjitha faktet, përfshirë edhe ato të rezultuara gjatë verifikimeve, ka marrë vendimin përkatës për ta regjistruar si procedim penal në datën 29.8.2014 dhe ka urdhëruar me shkrim detyrat përkatëse. Për sa i përket afatit se sa kohë mund të mbahej një kallëzim penal për verifikim, në Kodin e Procedurës Penale të kohës nuk parashikohej një afat konkret. Një situatë e tillë rregullohej vetëm me udhëzimin nr. ***, datë 19.6.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm, ku parashikohej se: *“Afati për verifikimin në lidhje me rrethanat që lejojnë ose nuk lejojnë fillimin e procedimit penal, ishte 30 ditë”*. Në rastin konkret, duhet të mbahet parasysh fakti që në tejkalimin e afatit kanë ndikuar jo vetëm verifikimet e domosdoshme, leja vjetore, por edhe ngarkesa si prokuror.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

15.7 Komisioni vëren se nga dokumentacioni i ndodhur në fashikullin penal rezulton që kallëzimi i është caktuar për t'u regjistruar dhe ndjekur nga zëvendës drejtuesi i prokurorisë në datën 3.6.2014 prokurores Miranda Bushi. Në datën 26.6.2014, nga drejtuesi i Prokurorisë P. F. i është drejtuar një shkresë gjykatës administrative, për të vënë në dispozicion vendimin e gjykatës që përmendej në kallëzim.

Pasi nga OPGJ-ja E. B., në datën 3.7.2014, janë marrë të dhëna nga person që kishte dijeni për çështjen dhe në datën 10.7.2014 nga gjykata administrative u dërgua vendimi që përmendej në kallëzim, më pas, në datën 29.8.2014, subjekti i rivlerësimit Miranda Bushi ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal.

Në bazë të udhëzimit nr. ***, datë 19.6.2012, pika 2.2, të Prokurorit të Përgjithshëm, *afati i verifikimit të kallëzimit penal dhe/ose njoftimit të veprës penale të marrë me iniciativën e tij, përcaktohet të ishte në maksimumin deri në 30 ditë*, periudhë gjatë së cilës prokurori kryente vetëm verifikime në lidhje me rrethanat që lejojnë ose nuk lejojnë fillimin e procedimit penal. Referuar këtij udhëzimi, afati për të kryer këto verifikime përfundonte në datën 10.7.2014, kur duhej të vendosej mosfillimi ose regjistrimi i procedimit penal. Dy veprime verifikuese janë kryer në datat 3.7.2014 dhe 10.7.2014, ndërkohë që regjistrimi i procedimit penal nuk është bërë deri në datën 29.8.2014, me një vonesë prej afërsisht 3 muajsh.

Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka vepruar në përputhje me nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale “Funksionet e prokurorit” në hetimin e kësaj çështjeje.

16. NË LIDHJE ME ANKESAT/MASAT DISIPLINORE DHE KALLËZIMET

16.1 Prokuroria e Përgjithshme¹⁰² ka përcjellë informacionin për subjektin e rivlerësimit Miranda Bushi, të ardhur nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, strukturat pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (në vijim PPKKKO).

16.2 Prokuroritë e rretheve gjyqësore¹⁰³ dhe PPKKKO-ja¹⁰⁴ konfirmojnë se nuk rezulton që ndaj subjektit Miranda Bushi të jenë regjistruar *indicie*, kallëzime apo procedime penale në ngarkim të saj.

16.3 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë¹⁰⁵ konfirmon se pranë kësaj prokurorie ka depozituar kallëzim penal shtetasi D. G. në ngarkim të subjektit Miranda Bushi, akuzuar për veprën penale “shpërdorim detyre”. Në përfundim të hetimit, nga prokurori i çështjes E. K. është marrë

¹⁰² Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. ***, datë 30.3.2021.

¹⁰³ Prokuroritë e rretheve gjyqësore: Krujë, me shkresën nr. *** prot., datë 5.3.2021; Përmet, me shkresën nr. *** prot., datë 17.2.2021; Kavajë, me shkresën nr. *** prot., datë 10.3.2021; Dibër, me shkresën nr. *** prot., datë 23.2.2021; Lezhë, me shkresën nr. *** prot., datë 23.2.2021; Fier, me shkresën nr. *** prot., datë 23.2.2021; Lushnjë, me shkresën nr. *** prot., datë 23.2.2021; Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 24.2.2021; Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 1.3.2021; Pogradec, me shkresën nr. *** prot., datë 24.2.2021; Shkodër, me shkresën nr. *** prot., datë 24.2.2021; Korçë, me shkresën nr. *** prot., datë 26.2.2021; Sarandë, me shkresën nr. *** prot., datë 23.2.2021; Tropojë, me shkresën nr. *** prot., datë 17.2.2021; Pukë, me shkresën nr. *** prot., datë 18.2.2021; Berat, me shkresën nr. *** prot., datë 18.2.2021; Mat, me shkresën nr. *** prot., datë 18.2.2021; Gjirokastrë, me shkresën nr. *** prot., datë 18.2.2021; Kukës, me shkresën nr. *** prot., datë 18.2.2021; Kurbin, me shkresën nr. *** prot., datë 18.2.2021; Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 18.2.2021.

¹⁰⁴ PPKKKO-ja, me shkresën nr.***, datë 30.6.2020, përgjigjja që i është kthyer KLP-së dhe që ndodhet tek dosja profesionale.

¹⁰⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 10.7.2020, e dërguar nga Prokuroria e Rrethit Kavajë, ndodhet tek dosja profesionale dërguar KLP-së.

vendimi i “Mosfillimit të procedimit penal nr. ***”, pasi nuk ndodhemi përpara elementeve të figurës së veprës penale, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

16.4 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës¹⁰⁶ ka konfirmuar se ndaj subjektit Miranda Bushi është regjistruar procedimi penal, me kallëzues V. Ç., për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Pas kryerjes së veprimeve hetimore nga prokurori i çështjes O.Ç. është vendosur pushimi i procedimit penal nr. ***, pasi në veprimet e kryera nga prokurorja Miranda Bushi nuk vërehet asnjë element i figurës së veprës penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

16.5 Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit¹⁰⁷ konfirmon se për subjektin e rivlerësimit Miranda Bushi nuk ka ankesa dhe nuk rezulton të ketë masa disiplinore.

16.6 Sektori i Protokoll - Arkivit¹⁰⁸ konfirmon se ndaj subjektit Miranda Bushi për periudhën 2006 – 2020 është depozituar ankesa nr. ***, viti 2016, e shtetasit A. K., drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, pasi ka bërë kallëzim në Prokurorinë e Rrethit Tiranë për veprën penale “përdorim me keqdashje i thirrjeve telefonike”, vepër e parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal. Pasi i është kërkuar informacion Prokurorisë së Rrethit Tiranë, kjo e fundit ka dërguar vendimin e pushimit datë 12.4.2015, i marrë nga subjekti Miranda Bushi, pasi gjatë hetimit kallëzuesi A. K. ka deklaruar përpara Policisë Gjyqësore se heq dorë nga kallëzimi.

17. DENONCIMET/ANKESAT E PUBLIKUT

Ndaj subjektit të rivlerësimit janë depozituar 4 denoncime/ankesa nga publiku

17.1 Denoncim nr. * prot., datë 4.1.2018, i shtetasit J. N.,** i cili ngre pretendime për subjektin e rivlerësimit për vendim të padrejtë, duke e shpallur fajtor dhe si rezultat ka kërkuar dënimin e tij. Denoncuesi i ka bashkëngjitur denoncimit vendimet e gjykatës së “zgjdhjes së martesës” dhe “dhunës në familje”, por nuk ka bashkëngjitur konkluzione apo vendim të subjektit të rivlerësimit. Komisioni ka administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁰⁹ dosjen gjyqësore të çështjes së hetuar nga subjekti Miranda Bushi, në ngarkim të shtetasit J. N., për veprën penale “dhunë në familje”, nga ku rezultoi se Gjykata në vendimin e saj ka pranuar kërkesën e prokurorisë për deklarimin fajtor të denoncuesit, duke e dënuar atë. Denoncuesi e ka ankimuar këtë vendim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin e saj¹¹⁰ ka vendosur mospranimin e ankimit.

Ky procedim ka qenë dhe një nga dosjet e përzgjedhura me short dhe konkretisht dosja nr. 4 nga e cila nuk rezultoi të kishte problematika.

Komisioni vëren se pretendimi i denoncuesit për vendim të padrejtë lidhet me themelin e çështjes/vendimmarrjen e subjektit, për të cilën Komisioni mban parasysh nenin 73 të ligjit nr. 96/2016.

17.2 Denoncim nr. * prot., datë 12.10.2021, i shtetas S. T.,** e cila pretendon se nga prokurorja Miranda Bushi, e cila ka në hetim një dosje të saj dhe ka kërkuar fotokopje të dosjes penale, por që nuk i është vënë në dispozicion nga prokurorja. Pretendon se prokurorja po e

¹⁰⁶ Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës nr. *** prot., datë 3.7.2020, shkresë e ndodhur në dosjen profesionale, dërguar KLP-së.

¹⁰⁷ Drejtoria e menaxhimit të dokumentacionit me nr. *** prot., datë 7.7.2020 dhe nr. *** prot., datë 7.7.2020, shkresa të ndodhura në dosjen profesionale të KLP-së.

¹⁰⁸ Shkresë nr.***, datë 21.7.2020, e ndodhur në dosjen profesionale të përcjellë nga KLP-ja.

¹⁰⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 26.10.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹¹⁰ Vendimi nr. ***, datë 13.10.2015, i Gjykatës së Apelit Tiranë.

zvarrit çështjen. Komisioni ka administruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹¹¹ fashikullin e procedimit penal nr. ***, me kallëzuese shtetasen S. T..

Nga aktet e dosjes hetimore rezulton se ka një procesverbal të datës 3.8.2021 mbi këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve, ku shtetasit T. K. (nipi i kallëzueses S.T. dhe njëkohësisht përfaqësues me prokurë i të gjithë trashëgimtarëve të tjerë, përfshirë edhe shtetasen S. T.) i janë vënë në dispozicion aktet e fashikullit penal dhe kopje të tyre në prani të OPGJ-së.

Komisioni vëren se pretendimet e denoncueses nuk qëndrojnë, për sa kohë vërtetohet që përfaqësuesi me prokurë prej saj dhe prej trashëgimtarëve të tjerë është njohur me aktet e dosjes penale të kallëzimit të bërë nga denoncuesja. Vendimi i mosfillimit i është njoftuar edhe nga ana e prokurorisë.

17.3 Dokumenti kallëzim me nr. * prot., datë 27.12.2022, i shtetasit O. S.,** dërguar për dijëni ILD-së, Komisionit, Kolegjit, Komisionerit Publik dhe ONM-së. Shtetasi O. S. ka kallëzuar subjektin Miranda Bushi për veprat penale “falsifikim i dokumenteve”, “shpërdorim detyre” dhe “veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës”. Kallëzuesi ngre problematika procedurale gjatë procesit gjyqësor në drejtim të organit procedues, pasi, sipas pretendimeve të tij, ka mangësi procedurale në drejtim të hetimit të bërë nga prokuroria (përfaqësuar nga subjekti Miranda Bushi, e cila ka hetuar edhe çështjen e tij).

Referuar dokumentacionit të bashkëngjitur nga kallëzuesi, rezulton që referuar pretendimeve për probleme procedurale, gjykata, gjatë gjykimit, me vendim të ndërmjetëm ka kërkuar nga prokuroria që të bëjë disa hetime shtesë. Pas bërjes së tyre nga organi procedues është kërkuar *dërgimi për gjykim të procedimit penal nr. ***, datë 27.2.2022, për veprën penale “marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, parashikuar nga neni 100/1 i Kodit Penal në ngarkim të të pandehurit O. S.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e datës 9.11.2022, pasi shqyrtoi të gjitha faktet dhe provat e paraqitura nga prokuroria dhe nga i pandehuri, vendosi “Të pranohet kërkesën e prokurorisë për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***, datë 27.2.2022, për veprën penale “marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, parashikuar nga neni 100/1 i Kodit Penal në ngarkim të të pandehurit O. S.”.

Komisioni vëren se për sa kohë mangësitë procedurale të konstatuara nga gjykata janë plotësuar nga ana e subjektit të rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes dhe, më pas, gjykata me vendimin e saj ka pranuar kërkesën e prokurorisë për dërgimin në gjyq të çështjes me të pandehur shtetasin O. S., nuk ka vend për ngarkimin me përgjegjësi disiplinore të subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë çështje për kriterin profesional.

17.4 Denoncim nr. * prot., datë 11.4.2018, paraqitur në formën e “kallëzimit penal” nga shtetasi D. G.,** drejtuar Prokurorisë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe për dijëni Komisionit dhe disa institucioneve të tjera kundër prokurores Miranda Bushi, për veprën penale “shpërdorim detyre”. Kallëzuesi pretendon se nga ana e subjektit nuk është kryer detyra në hetimin e çështjes së kallëzuar prej tij. Ka kërkuar informacion për ecurinë e hetimeve, por prokurorja nuk e ka pritur dhe sqaruar.

¹¹¹ Përgjigje nr. *** prot., datë 21.10.2022, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, drejtuar Komisionit.

Komisioni ka administruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹¹² fashikullin e procedimit penal nr. ***.

Nga aktet e dosjes penale rezulton se në datën 30.1.2017 pranë Komisarariatit të Policisë Nr. *** ka paraqitur kallëzim penal shtetasi D. G., në ngarkim të shtetasve F. e Sh. B., për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal.

Komisariati i Policisë ka përcjellë materialin hetimor pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 1.2.2017.

Në datën 27.2.2017, kallëzimi penal me urdhër të zëvendës drejtuesit të Prokurorisë iu caktua për t’u ndjekur prokurores Miranda Bushi, si dhe u ngarkua OPGJ-ja E. T. të kryejë veprimet hetimore.

Në datën 6.4.2017, prokurorja Miranda Bushi përpilon urdhrin për regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, duke ngarkuar për kryerjen e veprimeve hetimore OPGJ-në E. T.

Në datën 21.9.2017, nga ana e drejtuesit të Prokurorisë është vendosur zëvendësimi i prokurores Miranda Bushi me prokuroren A. Z., për shkak se kjo e fundit është larguar me leje të papaguar deri në datën 31.12.2017.

Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se:

a) *Nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është kryer asnjë veprim hetimor për një periudhë 5-mujore (nga data 27.2.2017, kur iu caktua për trajtim kallëzimi dhe deri në datën 21.9.2017, kur u zëvendësua me një prokurore tjetër). Subjekti i rivlerësimit nuk ka vepruar në përputhje me nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale “Funksionet e prokurorit”.*

b) *Nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk rezulton të jetë marrë vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve në përputhje me nenin 324 të Kodit të Procedurës Penale¹¹³.*

Për këtë konstatim, subjektit të rivlerësimit i është kaluar barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

17.5 Në prapësime, subjekti i rivlerësimit¹¹⁴ ka shpjeguar, ndër të tjera, se me marrjen në dorëzim të kallëzimit në datën 27.2.2017, ai i është dhënë dorazi OPGJ-së E. T., për të kryer verifikimet e nevojshme, duke e orientuar verbalisht në lidhje me verifikimet që duhej të bënte. Në aktet e përcjella nga Komisarati referohej vepra penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, ku për të përcaktuar kategorinë e dëmtimeve të kallëzuesit, ishte marrë vendim për kryerje ekspertimi mjekoligjor. Në rastin konkret duhej verifikuar nëse akti i ekspertimit ishte paraqitur në prokurori nga Mjekësia Ligjore.

Nga akti i ekspertimit i mjekoligjor është përcaktuar se dëmtimet e konstatuara tek i plagosuri përfshihen në kategorinë e dëmtimeve, që kanë shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se 9 ditë. Në nenin 89 të Kodit Penal, parashikohet se: “Plagosja e kryer me dashje, që

¹¹² Përgjigje nr. *** prot., datë 21.10.2022, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹¹³ Neni 324 “Zgjatja e afatit”: “1. Prokurori mund ta zgjasë afatin e hetimeve për një kohë deri në tre muaj. 3. Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve u njoftohet të pandehurit dhe të dëmtuarit. 4. Veprimet hetimore të kryera pas mbarimit të afatit nuk mund të përdoren”.

¹¹⁴ Shihni me detaje prapësimet në dosje.

ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se 9 ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”.

Duke qenë se kjo veprë penale mbi bazën e nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale ndiqet me ankimin e të dëmtuarit dhe jo kryesisht, nuk mund të kryhej regjistrimi i veprës penale, pasi ka qenë e domosdoshme marrja e ankimit të dëmtuarit, sipas neneve 284 e 285 të Kodit të Procedurës Penale. Ky detyrim lind edhe nga neni 24/6 i Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet se: *“Kur nuk është i nevojshëm ankimi i viktimës, ndjekja penale ushtrohet kryesisht”.*

Për këtë arsye është kërkuar të paraqitet i dëmtuari, duke u dërguar urdhri për paraqitjen e tij nëpërmjet Komisarariatit të Policisë Nr. *** Tiranë, me shkresën e datës 24.3.2017. Në datën 6.4.2017, ai është paraqitur duke u njohur me aktin e ekspertimit (shënim i cili është bërë prej tij). Me marrjen e ankimit në formën e duhur, menjëherë është regjistruar procedimi penal, datë 6.4.2017. Në momentin e regjistrimit të procedimit penal në gjendjen që ishin aktet, nuk mund të procedohej me regjistrimin e emrit të personit, pasi nuk mjaftonte vetëm kallëzimi i personit, por duhej të kryheshin një sërë veprimesh të tjera për identifikimin e personave sipas gjeneraliteteve të tyre, gjetja dhe pyetja e personave të pretenduar nga kallëzuesi që e kishin goditur, si dhe pyetja e personave të tjerë që kishin parë ngjarjen.

Me regjistrimin e procedimit penal, i është kërkuar oficerit të kryejë veprimet për të identifikuar personat e dyshuar apo persona që kishin dijeni për ngjarjen dhe t’i njoftonte ata që të paraqiteshin për t’u pyetur në lidhje me pretendimet apo konfliktin. Më pas, subjekti është trajtuar me leje të papaguar dhe, për këtë arsye, në datën 21.9.2017 është zëvendësuar, duke u caktuar një prokuror tjetër. Duke qenë se veprimet janë kryer nga oficeri kryesisht përgjatë muajit korrik, marrë parasysh dhe lejet përkatëse, faktin që procedimi penal ishte pa emër personi të regjistruar dhe ngarkesën që subjekti ka pasur, nga ana e saj nuk është mundur të konkludohet brenda muajit korrik në lidhje me këtë çështje. Vendimmarrjet e mëpasshme të prokurorëve janë mbështetur pikërisht në veprimet që janë kryer gjatë kohës që subjekti ka pasur çështjen në hetim dhe nuk kanë kryer veprime të tjera, por vetëm kanë konkluduar.

Procedimi penal është regjistruar pa emër të personit, duke mos qëndruar kështu konkluzioni i arritur nga ana e Komisionit se nuk rezulton të jetë marrë vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve në përputhje me nenin 324 të Kodit të Procedurës Penale. Afatet e hetimit fillojnë dhe ecin vetëm kur është regjistruar emri i personit, emër i cili është regjistruar në datën 23.9.2017, pasi ishin identifikuar dhe pyetur personat sipas gjeneraliteteve të tyre përkatëse.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

17.6 Komisioni vëren se me marrjen në dorëzim të kallëzimit në datën 27.2.2017 subjekti ka deklaruar se ka udhëzuar verbalisht OPGJ-në për kryerjen e verifikimeve të nevojshme për çështjen, ndërkohë që duhet të procedonte me urdhër të shkruar në respektim të nenit 294, pika 2 dhe nenit 304 të Kodit të Procedurës Penale.

Nga aktet në dosje rezulton se akti i ekspertimit mjekoligjor është depozituar në prokurori, në datën 7.2.2017 dhe në atë moment nga prokuroria duhej të ishte bërë njoftimi i kallëzuesit D. G. dhe jo pas gati 2 muajsh.

Në datën 6.4.2017, subjekti Miranda Bushi ka përpiluar urdhrin e regjistrimit të procedimit penal për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, ku në këtë urdhër nga vetë subjekti është cituar se *ka pasur një konflikt ndërmjet shtetasit D. G.*

dhe shtetasve Sh. dhe F. B., për shkak të një huaje të pashlyer. Shtetasit Sh. dhe F. B. në konflikt e sipër e kanë goditur në kokë dhe pjesë të tjera të trupit shtetasin D. G., por u vlerësua elementi i bashkëpunimit nga ana e subjektit.

Nga data 6.4.2017 deri më 21.9.2017, kur subjekti u zëvendësua nga prokurorja tjetër A. Z., nuk është kryer asnjë veprim tjetër hetimor.

Pasi subjekti në këtë çështje u zëvendësua nga prokurorja tjetër A. Z., kjo e fundit në datën 23.9.2017 përpiloi urdhrin e regjistrimit të emrit të personit, që i atribuohet vepra penale “plagosje e lehtë me dashje”, e kryer në bashkëpunim, shtetasve Sh. dhe F. B., parashikuar nga nenet 89 dhe 25 të Kodit Penal.

Bazuar në nenin 24, pika 1 dhe nenin 304, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale: “Prokurori drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor...”. Afati i hetimeve paraprake përcaktohet në nenet 323 e 324 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet se ai fillon nga dita që emri i personit që i atribuohet vepra penale, është regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale. Në procedimin penal të mësipërm nuk ka pasur afate procedurale për shkak të zhvillimit të hetimeve pa emër personi të cilit i atribuohet vepra penale, por në veprimtarinë e prokurorit ka shkelje të neneve 24/1 e 304/1 të Kodit të Procedurës Penale, si rezultat i mosveprimit për të kontrolluar hetimet paraprake dhe përfunduar ato brenda afateve të arsyeshme. Nga prokurorja nuk janë përmbushur në mënyrë korrekte funksionet e saj gjatë hetimit, duke sjellë vonesa të pajustificuara të veprimeve hetimore e akteve procedurale.

Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka vepruar në përputhje me nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale “Funksionet e prokurorit” në hetimin e kësaj çështjeje.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreut IV dhe nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit Miranda Bushi:

a) Lidhur me kriterin e pasurisë ka kryer deklarime të pamjaftueshme, si dhe nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurive të saj dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Këto konstatime kualifikohen në parashikimet e shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e krijimit dhe deklaramit të pasurisë dhe, nisur nga sa më sipër, në këtë rast duhet të aplikohet pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

a/1) Nga analiza financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të/bashkëshorti ka pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në momentin e krijimit të pasurive në shumën totale prej **-28,209,341 lekë** për periudhën 1992 – 2016.

b) Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Miranda Bushi ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

c) Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, edhe pse subjektit iu konstatuan problematika në një dosje profesionale dhe një denoncim, por marrë për bazë edhe faktin se nga ana e subjektit janë kryer veprime të caktuara hetimore të shtrira në kohë, subjekti i rivlerësimit vlerësohet se është “e aftë”, duke arritur nivel të besueshëm, kualifikues, në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, por një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Bushi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 25.5.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE
Kryesuese

Olsi KOMICI
Relator

Firdes SHULI
Anëtare (kundër)

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj